



REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
MINISTRI PËR INOVACIONIN  
DHE ADMINISTRATEN PUBLIKE



Ky projekt financohet nga BE



REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
MINISTRI PËR INOVACIONIN  
DHE ADMINISTRATEN PUBLIKE



This project is financed by  
the EUROPEAN UNION

# CODE OF ADMINISTRATIVE PROCEDURES

ASPAs TRAINING CATALOGUE

# KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE

KATALOGU I TRAJNIMIT TË ASPA-s



# KATALOGU I TRAJNIMIT PËR KODIN E PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE (KPA)

KATALOG TRAJNIMI  
SHKOLLA SHQIPTARE E ADMINISTRATËS PUBLIKE

TIRANË, SHQIPËRI  
Qershor 2017

"Ky publikim është prodhuar me ndihmën e Bashkimit Evropian. Përbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e autoriteteve zbatuese dhe në asnjë rast nuk pasqyron pikëpamjet e Bashkimit Evropian."



Autorët e këtij katalogu janë nëpunës civilë nga administratat publike franceze, italiane, rumune, polake dhe bullgare, të cilët morën pjesë si ekspertë në projektin evropian të binjakëzimit Mbështetje për Reformën në Shërbimin Civil Shqiptar, të zbatuar nga Shkolla Kombëtare Franceze e Administratës Publike (ENA), Shkolla Kombëtare Italiane e Administratës Publike (SNA) dhe Departamenti Shqiptar i Administratës Publike (DAP):

- **Z. *Timothée PARIS*, gjyqtar apeli, Këshilli i Shtetit, Francë**

Me kontributin e:

- Z. *Yve Doutriaux*, gjyqtar administrativ, Këshilli i Shtetit, Francë
- Z. *Stephane Dewailly*, gjyqtar administrativ, Gjykata Administrative Paris, Francë
- Z. *Dacian Dragos*, Universiteti Babes Bolyai, Rumani
- Z. *Ugo de Luca*, avokat i së drejtës administrative, Itali
- Zj. *Urszulla Kulisiewicz*, Ministria e Brendshme, Poloni
- Z. *Mladen Mladenov*, gjyqtar administrative, Bullgari

Prodhimi i këtij katalogu financohet nga Bashkimi Evropian përmes projektit të binjakëzimit Mbështetje për reformën në shërbimin civil Shqiptar.

Informacionet mbi Bashkimin evropian mund të gjenden në faqen: <http://ec.europa.eu>.

## PËRMBAJTJA

<b>Modulet Bazë (B) të KPA-së .....</b>	<b>8</b>
B1 Njohje me kodin .....	8
B2 Njohje me risitë kryesore të kodit .....	10
B3: Përpunimi i aktit administrativ .....	14
<b>Modulet e Avancuara (A) të KPA-së .....</b>	<b>15</b>
A1 Jurisdiksioni, kompetenca dhe delegimi .....	16
A2 Procesi i vendimmarrjes .....	18
A3 Të përballësh me kohën .....	20
A4 Kontratat administrative .....	21
<b>Modulet për Nivelin e Mesëm dhe të Lartë Drejtues (C) të KPA-së .....</b>	<b>23</b>
C1 Zhvillimet e fundit dhe jurisprudenca mbi KPA .....	24
C2 Garantimi i paanshmërisë së administratës publike .....	25
C3 Ankimi .....	26
<b>Shtojcat .....</b>	<b>25</b>
<b>Shtojca 1: Vështrim i përgjithëm i Kodit të Procedurave Administrative .....</b>	<b>28</b>
<i>Dokumenti 1: Prezantimi me Administratën Publike" (Niveli fillestar) .....</i>	<i>28</i>
<i>Te dhenat personale - Legjislacioni .....</i>	<i>28</i>
<i>Dokumenti 2: Përkufizimet (Fillestar/i thelluar) .....</i>	<i>39</i>
<i>Dokumenti 3: Aktet administrative (98-118- fillestar) .....</i>	<i>43</i>
<b>Shtojca 2: Tema të veçanta .....</b>	<b>46</b>
Parimet e procedurës administrative .....	46
<i>Dokumenti 1: Parimet e procedurës administrative (nivei fillestar/i thelluar) .....</i>	<i>46</i>
Delegimi i kompetencës/Njësia përgjegjëse .....	51
<i>Dokumenti 1: udhëzuesi i delegimit të kompetencave për organet publike .....</i>	<i>51</i>
Shtojca 1: 3 shembuj delegimi kompetencash .....	57
<i>Shembulli 2: delegimi i nënshkrimit nga Prefekti .....</i>	<i>57</i>
<i>Shembulli 3: delegimi i kompetencave tek një organ publik tjetër .....</i>	<i>57</i>

<i>Dokumenti 2: Materiale shpjeguese për nenin 43 Të Kodit të Procedurave Administrative</i> .....	58
<b>Përgatitja e akteve administrative</b> .....	<b>63</b>
<i>Dokumenti 1: Të drejtat e palëve gjatë procedurës administrative (nivel fillestar/ i avancuar)</i> .....	63
<i>Dokumenti 2: Parimi i pjesëmarrjes</i> .....	65
<i>Dokumenti 3: Ekzekutimi i akteve administrative (niveli i thelluar)</i> .....	68
<b>AFATET</b> .....	<b>76</b>
<i>Rihapja e procedurave administrative</i> .....	76
<i>Dokumenti 1: Ankimet administrative dhe forma të tjera të ADR (nivei i thelluar)</i> .....	89
<b>Shtojca 3: Materiale ndihmë për të përgatitur shembuj dhe raste studimi</b> .....	<b>99</b>
<b>METODOLOGJIA PËR KRAHASIMIN E KPA</b> .....	99
<i>Dokumenti 1: METODOLOGJIA PËR KRAHASIMIN E KPA (niveli avancuar/për menaxherët)</i> .....	99
<b>Formularë tip për komunikimin me administratën</b> .....	<b>106</b>
<i>Dokumenti 1: Shembuj për formën e vendimit administrativ</i> .....	106
<i>Document 2: njoftimi mbi njohjen me dosjen dhe mbi të drejtën për t'u dëgjuar</i> .....	107
<i>Document 3: forma e njoftimit për dokumentet shitesë</i> .....	109
<b>Tani që keni lexuar gjithë materialin, përshëndesni Laman Joe</b> .....	<b>110</b>

## Konteksti dhe problemet

Më 30 prill 2015, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, me shumicë të cilësuar, miratoi Kodin e ri të procedurave administrative. Ky kod është në përputhje me legjislacionin e BE-së, me kërkesat e parimeve të Administrimit të Mirë, si dhe me standardet ndërkombëtare të praktikës së mirë administrative. Kodi hyri në fuqi në maj të vitit 2016. Tashmë Kodi është *ratio legis* për çdo procedurë administrative në Shqipëri.

Revolucioni kryesor i kodit është tek qëllimi për t'u dhënë qytetarëve shërbimin më të mirë të mundshëm: organet administrative nuk funksionojnë më për vete, por me të vërtetë për njerëzit. Ndryshimi nuk është vetëm një ndryshim kozmetik, ai duhet dhe do të jetë ndryshim kulturor.

Për të ruajtur këtë ndryshim kulturor në organizimin dhe funksionimin e organeve administrative, siç përcaktohet në aktin nënligjor që shoqëron zbatimin e Ligjit të ri për Shërbimin Civil, Shkollës Shqiptare e Administratës Publike (ASPA) i është besuar përgjegjësia për të hartimin, zhvillimin dhe zbatimin e një programi trajnimi enkas për Kodin e Procedurave Administrative (KPA).

Ky program bazohet në metoda moderne trajnimi, duke u mbështetur në shkëmbimin dhe ndërveprimin ndërmjet trajnerëve dhe të trajnuarve. Ai ndahet në tre nivele kryesore. Pas trajnimeve në disa nivele, nëpunësit civilë do të kenë marrë certifikatat dhe besimin e njerëzve.

Niveli i parë është niveli Bazë (B). Ky nivel përmban gjërat më të rëndësishme që duhet të dijë çdo nëpunës civil për Kodin e Procedurave Administrative. Trajnerët do të shqyrtojnë aspektet kryesore të Kodit, veçanërisht risitë që përmban Kodi në krahasim me atë të mëparshmin. Gjithashtu pjesëmarrësit do të mësojnë praktikisht se si shkruhet një vendim administrativ. Modulet e Avancuara (A) synojnë të forcojnë

aftësitë tuaja mbi Kodin. Ato janë hartuar për juristë, drejtues të nivelit të mesëm dhe për të gjithë nëpunësit civilë që përdorin kodin në punën e përditshme. Këto module përqendrohen në çështjet specifike të kodit si juridiksioni, kompetenca dhe delegimi, afatet kohore ose kontratat administrative me anë të mjeteve si prezantimet, loja e roleve, mësimi praktik dhe shkëmbimet.

"Mësim i shpejtë dhe i thellë i çështjeve më të spikatura të Kodit për personat që e kanë kohën të zënë" është motoja e moduleve të Përforuara (C). Këto module do t'u japin mundësinë, sidomos drejtuesve të lartë, që të kenë shkëmbime mes tyre dhe trajnuesve të nivelit të lartë (gjyqtarë, përfaqësues të institucioneve ndërkombëtare ose të huaja) mbi temat më të nxehta të kodit: paanshmëria e administratës publike, jurisprudenca më e freskët mbi procedurat administrative dhe apelimet.

U urojmë të gjithë nëpunësve civilë trajnim të frytshëm dhe sukses në rrugëtimin e karrierës.

**Z. Fatmir Damperi,  
Drejtor i ASPA-s**

## Lista e shkurtimeve

<b>ASPA</b>	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike	<b>PDP</b>	Pyetje me Disa Përgjigje
<b>KPA</b>	Kodi i Procedurave Administrative	<b>SHA</b>	Shtet Anëtar
<b>GJEDNJ</b>	Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut	<b>LOB</b>	Ligji Organik i Buxhetit
<b>LSHC</b>	Ligji për Shërbimin Civil	<b>OECD</b>	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
<b>VKM</b>	Vendim i Këshillit të Ministrave	<b>OSBE</b>	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
<b>DAP</b>	Departamenti i Administratës Publike	<b>RAP</b>	Reforma në Administratën Publike
<b>BE</b>	Bashkimi Evropian	<b>FP</b>	Financat Publike
<b>GJED</b>	Gjykata Evropiane e Drejtësisë	<b>MFP</b>	Menaxhimi i Financave Publike
<b>BNJ</b>	Burimet Njerëzore	<b>SIGMA</b>	Mbështetje në Përmirësimin e Qeverisjes dhe Menaxhimit
<b>MBNJ</b>	Menaxhimi i Burimeve Njerëzore	<b>EA</b>	Ekspert Afatshkurtër
<b>AB</b>	Auditi i Brendshëm	<b>VNT</b>	Vlerësimi i Nevojave për Trajnim
<b>ONP</b>	Organizata Ndërkombëtare e Punës	<b>TND</b>	Trupa e Nivelit të Lartë Drejtues
<b>FMN</b>	Fondi Monetar Ndërkombëtar	<b>TiT</b>	Trajnimi i Trajnerëve
<b>INTOSAI</b>	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve të Larta të Auditimit	<b>OKB</b>	Organizata e Kombeve të Bashkuara
<b>IT</b>	Teknologjia e Informacionit	<b>UNDP</b>	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
<b>PVP</b>	Përshkrimi i Vendit të Punës		



## KATALOG TRAJNIMI

### Modulet Bazë (B) të KPA-së

#### Gjërat më të rëndësishme që duhet të dini për Kodin e Procedurave Administrative

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi Kodin i ri të procedurave në vitin 2015 (me ligjin nr. 44/2015) i cili hyri në fuqi në maj 2016.

Kodi është projektuar dhe miratuar me ndihmën e specialistëve ligjorë evropiane si përmbledhje e të gjitha praktikave më të mira evropiane në fushën e së drejtës administrative. Nuk është revolucion sepse kodi i mëparshëm i procedurës administrative i përmbante disa prej këtyre praktikave. Megjithatë është revolucion i rreptë sepse kodi sistematizon të gjitha aspektet e procedurës administrative dhe vë në zbatim mjaft risi.

Miratimi i kodit të ri të procedurave administrative ishte një domosdoshmëri sepse:

- siguron procedurë administrative të shpejtë, efektive dhe transparente;
- u garanton qytetarëve mjetet e nevojshme për t'u mbrojtur dhe për të kërkuar të drejtat e tyre;
- vendos parimet për një proces të rregullt ligjor, i cili jep siguri ligjore;
- krijon një mjedis më të qëndrueshëm për biznesin dhe është parakusht për investime në kapitale dhe zhvillim ekonomik;
- përmbush standardet e Bashkimit Evropian si: standardizimi i procedurave në të gjitha organet administrative, bashkëpunimi ndërmjet administratës dhe qytetarëve dhe thjeshtimi.

KPA u miratua si ligj me shumicë të cilësuar. Prandaj është ligj themelor horizontal për proceset administrative (pavarësisht nga natyra e tyre). Për këtë arsye kodi duhet të zbatohet nga të gjithë nëpunësit civilë në veprimtarinë e tyre. Kështu ata do të kontribuojnë ditë pas dite në zbatimin e ligjit në Shqipëri. Juristët e shërbimit civil duhet të marrin në konsideratë KPA-në në procesin e hartimit të ligjeve të reja ose të rishikimit të legjislacionit ekzistues pasi dispozitat ligjore mbi procedurat e çdo ligji

të posaçëm ose çdo akti nënligjor, duhet të hartohen në përputhje me dispozitat e KPA-së.

Plani i Veprimit për Trajnim të vazhdueshëm i ASPA-s shpalos një plan mësimor ambicioz trajnimi mbi aspektet më të rëndësishme të Kodit të Procedurave Administrative.

#### Grupi i synuar:

- nëpunësit civilë të kategorive II, III dhe IV pa njohuri paraprake mbi Kodin;
- nëpunësit civilë dhe nëpunësit publikë që janë në kontakt me publikun;
- nëpunësit civilë dhe nëpunësit publikë të cilët përgatitin dhe hartojnë vendime administrative;
- nëpunësit civilë dhe nëpunësit publikë të institucioneve të qeverisjes vendore;
- nëpunësit civilë dhe nëpunësit publikë të institucioneve të specializuara.

Qëllimi është që nëpunësit civilë dhe ata publikë të cilët ende nuk e njohin kodin ose që kanë pyetje për kuptimin ose funksionimin e risive kryesore të kodit të jenë të vetëdijshëm për këto aspekte, me qëllim që të forcojnë punën e tyre të përditshme me qytetarët.

Ky modul, si dhe çdo modul trajnimi i ASPA-s është trajnim profesional. Nuk ka për qëllim të jetë kurs teorik, por shumë praktik në të cilin trajnuarit pritet të marrin pjesë dhe të ngrënë pyetje. Pra, në çdo rast: mos kini turp !!

#### Vështrim i Përgjithshëm

<b>B1</b>	Njohje me kodin (3 orë)
<b>B2</b>	Njohje me risitë kryesore të kodit (3 orë)
<b>B3</b>	Përpunimi i një akti administrativ (3 orë)

## B1 Njohje me kodin Prezantimi dhe objektivat

KPA është ligji themelor horizontal për çdo proces administrativ. Krahasuar me kodin e mëparshëm dhe me ligjet për procedurat administrative, qëllimi i tij i përgjithshëm ka ndryshuar rrënjësisht. Kodi i ri i procedurave administrative është hartuar me qëllimin e veçantë për të garantuar të drejtat e qytetarëve dhe për të siguruar efikasitetin dhe transparencë në procedurat administrative.

Në këtë aspekt, çdo nëpunës civil ka për detyrë të zbatojë plotësisht procedurat e parashikuara nga ky kod duke e ditur se moszbatimi i tij jo vetëm që mund të çojë në anulimin e aktit nga gjyqtari administrativ, por edhe mund të pengojë respektimin e të drejtave themelore të qytetarëve dhe të shkaktojë shkelje të ligjit.

Në të vërtetë, procedura administrative është një nga aspektet thelbësore të parimit të ligjshmërisë së veprimeve të administratës publike, që rrjedh nga parimi i përgjegjësisë së pushtetit ekzekutiv të parashikuar në nenin 95 të Kushtetutës. Ky parim nënkupton se administrata publike është e lidhur me kushtetutën, ligjet statutorë dhe legjislacinin dytësor; se çdo veprim administrativ duhet të jetë në përputhje me ligjin; se kërkon proces të rregullt dhe të drejtë dhe se qytetari mund të mbështetet në administratën publike dhe të parashikojë veprimet e mundshme administrative që e prekin atë.

Ky modul do t'i japë mundësinë çdo nëpunësi civil që njohë ekzistencën, objektivat e përgjithshme dhe përdorimin e KPA-së dhe do t'u mundësojë pjesëmarrësve të zbulojnë kuadrin e përgjithshëm të kodit dhe futjen e tij në rendin e brendshëm juridik.

Ai do të shpjegojë dobinë dhe objektivat e procedurave administrative, përparësitë dhe qëllimin e kodit të ri. Nëpunësve civilë do t'u jepet gjithashtu një shpjegim i qartë i futjes së kodit në rendin ligjor shqiptar (ligj me shumicë të cilësuar, lidhja me ligjet e posaçme) që ata të jenë të vetëdijshëm për nevojën për t'u referuar kodit sa herë që do të kenë të

bëjnë me një procedurë dhe të zbatojnë plotësisht dispozitat e tij.

Do të prezantohet kuadri i përgjithshëm i kodit (krerët kryesorë dhe titujt) dhe do të shpjegohet përmbajtja e tyre e përgjithshme.

Moduli do të përqendrohet gjithashtu tek përkufizimet (çfarë është akti administrativ, cili është dallimi midis aktit administrativ individual dhe kolektiv?)

Do të shqyrtohen në detaje parimet themelore të funksionimit dhe organizimit të administratës publike. Parime të tilla si ai ushtrimi të ligjshëm të diskrecionit dhe parimi i proporcionalitetit, parimi i ligjshmërisë, transparencës, konfliktit të interesit etj., në të vërtetë janë thelbi i funksionimit të shërbimit civil në një regjim demokratik. Një theks i veçantë i duhet dhënë zgjidhjes së konfliktit të interesit dhe parimit të paanshmërisë së administratës publike.

### Temat kryesore

1.	Pse kishim nevojë për një kod të ri të procedurave administrative? Çfarë është ky kod? Është kod që synon nevojat dhe të drejtat e qytetarëve dhe të aktorëve ekonomikë.
2.	Shpjegim i kuadrit të përgjithshëm të kodit.
3.	Përkufizime: çfarë është akti administrativ?
4.	Parimet themelore të funksionimit dhe organizimit të administratës publike (në detaj).

### Metodologjia

Të gjitha aspektet e modulit do të trajtohen përmes një modeli interaktiv dhe praktik: të trajnuarit janë të ftuar të ngrënë pyetje dhe të ndajnë përvojën e tyre personale me procedurat administrative. Për të ilustruar dhe shpjeguar nocionet teorike, trajneri do të përdorë shembuj shumë të thjeshtë dhe konkretë të marrë nga aktiviteti administrativ.

## B2 Njohje me risitë kryesore të kodit Prezantimi dhe objektivat

Moduli B2 synon të rrisë njohuritë e nëpunësve civilë, përsëri përmes një qasjeje shumë praktike mbi çështjet më të ndjeshme të kodit, veçanërisht mbi risitë e Kodit të ri të procedurave administrative, të cilat mund të ngrenë probleme në zbatimin e tyre të përditshëm nga nëpunësit civilë:

Kompetencat / delegimi dhe zëvendësimi: cilat kompetenca mund të delegohen dhe kujt? Si mund të ushtroj kompetencat e mia në rast delegimi? Si duhet të shkruhen aktet e delegimit të kompetencave? Cili është dallimi midis delegimit të nënshkrimit dhe delegimit të kompetencave?

Fillimi i procedurave administrative me kërkesë dhe komunikimi me publikun: a mund t'i drejtohesha gojarisht administratës? A është e-maili i vlefshëm? A duhet t'i përgjigjem çdo komunikimi të bërë nga qytetarët? Cilat janë pasojat e përgjigjeve / mospërgjigjeve të mia?

Njohje me miratimin në heshtje: çfarë është? Si funksionon? Si duhet të reagojë një nëpunës civil në procedurat ku zbatohet miratimi në heshtje?

Kërkesat formale për aktet administrative dhe njoftimin tyre: detyrimi për t'i njoftuar aktin administrativ palës të cilës i drejtohet dhe palës së prekur nga akti; detyrimi për shpjegime me shkrim për arsyetimin dhe për mjetet juridike, përkatësisht mjetet administrative apo gjyqësore.

Afatet kohore: çfarë do të thotë afat kohor? Cilat janë pasojat? Ku i gjeni afatet e zbatueshme kohore?

### Temat kryesore

1.	Kompetencat, delegimi dhe zëvendësimi i kompetencave.
2.	Fillimi i procedurës administrative me kërkesë.
3.	Miratimi në heshtje.
4.	Kërkesat formale të akteve administrative dhe të njoftimit të tyre.
5.	Afatet kohore

### Metodologjia

I gjithë moduli duhet të bazohet në raste praktike dhe shpjegime të thjeshta/të kuptueshme. Të trajnuarve duhet t'u jepet një material jo më shumë se 10 faqe ku të jenë të përmbledhura aspektet kryesore për secilën temë (njësoj si materiali i përgatitur për publikun)

Për shembull:

- Për kompetencat dhe delegimin, të trajnuarit mund të ftohen për të komentuar së bashku dy shembuj të delegimit të nënshkrimit (të përgatitura nga trajneri dhe që përmbajnë dispozita të diskutueshme).
- Për kërkesat formale, të trajnuarit mund të komentojnë dy shembuj vendimesh administrative që përmbajnë dispozita të diskutueshme ose mungojnë elementet e kërkuara nga kodi. Trajneri do të shfrytëzojë secilën përgjigje për të shpjeguar aspektin përkatës, nënkuptimet e tij dhe pasojat e moszbatimit ...
- Për afatet kohore, trajnerët mund të vizatojnë në tabelë një vijë të gjatë dhe t'u kërkojnë pjesëmarrësve ta përfundojnë atë (trajneri do të shtojë informacionin e nevojshëm në tabelë sa herë që përgjigja do të jetë e saktë).

## B3: Përpunimi i aktit administrativ

### Prezantimi dhe objektivat

Ky modul ka për qëllim të jetë zbatimi praktik i njohurive teknike të dy moduleve të tjera B. Qëllimi i tij nuk është të zhvillojë aftësi apo njohuri të reja, por t'i ndihmojë të trajnuarit të integrojnë plotësisht këto aftësi dhe, nëse është e nevojshme, të ngrenë pyetje për aspekte që nuk janë kuptuar plotësisht dhe saktësisht. Trajneri mund të sjellë edhe saktësime shtesë.

#### Temat kryesore

Temat janë po ato të sesioneve të tjera të kategorisë B:

1.	Pse kishim nevojë për një kod të ri të procedurave administrative? Çfarë është ky kod? Është kod që synon nevojat dhe të drejtat e qytetarëve dhe të aktorëve ekonomikë.
2.	Shpjegim i kuadrit të përgjithshëm të kodit.
3.	Përkufizime: çfarë është akti administrativ?
4.	Parimet themelore të funksionimit dhe organizimit të administratës publike (në detaj).
5.	Kompetencat, delegimi dhe zëvendësimi i kompetencave.
6.	Fillimi i procedurës administrative me kërkesë.
7.	Miratimi në heshtje.
8.	Kërkesat formale të akteve administrative dhe të njoftimit të tyre.
9.	Afatet kohore.

#### Metodologjia

Trajneri ndan klasën në dy grupe dhe secili grup ftohet të përgatisin një sesion simulimi me role të frymëzuara nga raste ligjore. Rastet dhe rolet që mund të përdoren mund të jenë psh ( secilit grup i jepet një rast i ndryshëm): një person (rol 1) paraqitet para administratës për të marrë një leje ndërtimi. Ai / ajo i bën një kërkesë me gojë nëpunësit civil (rol 2). Ky menjëherë e mohon kërkesën sepse ishte formuluar me gojë. Qytetari shkruan një kërkesë formale për lejen e ndërtimit (kjo kërkesë duhet të shkruhet nga të trajnuarit). Nëpunësi civil që e merr atë (rol 3) fillon procedurat dhe kërkesat për evidentimin e fakteve të pretenduara. Pas pranimit, ai e transferon projekt-vendimin tek autoriteti i cili ka për detyrë ta marrë këtë vendim (rol 4). Ky autoritet merr delegim të kompetencës (teksti i delegimit duhet të shkruhet). Vendimi (refuzim) përgatitet, nënshkruhet dhe njoftohet. Qytetari pastaj ankimon kundër vendimit para organit të ankimeve (rol 5). Organi për ankimet merr një vendim. (Çdo rol, sidomos qytetari mund të luhet nga 2 apo edhe 3 persona nëse është e nevojshme - të gjitha faktet dhe procedurat mund të ndryshohen / përshtaten nga trajneri).

Pas përgatitjes, grupi i parë duhet të luajë rolet para grupit tjetër, duke shpjeguar të gjitha hapat. Grupit tjetër, nën mbikëqyrjen e trajnerit, i kërkohet të vlerësojë grupin e parë duke bërë pyetje dhe duke kritikuar.

## Modulet e Avancuara (A) të KPA-së

### Përforconi aftësitë tuaja mbi Kodin e Procedurave Administrative.

Kodi i ri i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë, ndonëse është hartuar për t'iu përshtatur nevojave të qytetarëve dhe për të zbatuar të drejtat e tyre, përmban dispozita teknike me të cilat duhet të merren juristët dhe drejtuesit, përfshirë drejtuesit e nivelit të lartë. Përveç kësaj, zbatimi efikas i Kodit të Procedurave Administrative nuk është vetëm çështje njohurish dhe aftësish ligjore, por mbështetet edhe në aftësi të fuqishme organizative dhe drejtuese që u mundësojnë drejtuesve të të gjitha niveleve të përfshijnë bashkërisht njësitë e tyre në zbatimin sa më të mirë të parimeve dhe dispozitave të Kodit.

Grupi i synuar:

- juristë;
- drejtues të nivelit të lartë;
- drejtues të niveleve të tjera;
- nëpunës publikë të kualifikuar që duan të ecin në karrierë

Të trajnuarit do të analizojnë në thellësi çështjet më të ndjeshme të Kodit dhe do të fitojnë dhe/ose do të forcojnë aftësitë e nevojshme për zbatimin e duhur të tyre. Modulet përfshijnë diskutime mbi aspektet teorike, ushtrime praktike dhe shkëmbime mbi praktikat më të mira midis pjesëmarrësve. Temat e këtyre moduleve do të rishikohen çdo vit për të marrë parasysh ndjeshmërinë e çështjeve brenda organeve administrative.

### Pamje e përgjithshme

<b>A1</b>	Jurisdiksioni, kompetenca dhe delegimi (1 ditë)
<b>A2</b>	Procesi i vendimmarrjes për AKTET ADMINISTRATIVE (1 ditë)
<b>A3</b>	Të përballshme me kohën (1 ditë)
<b>A4</b>	Kontratat administrative (1/2 ditë)

## A1 Jurisdiksioni, kompetenca dhe delegimi Prezantimi dhe objektivat

Kodi i ri i procedurave administrative vendos çështjen e juridiksionit të organit administrativ dhe të nëpunësit në zemrën e parimit të ligjshmërisë. Kompetenca ligjore e një organi ose autoriteti administrativ përcaktohet me ligj. Ajo ravijëzon shtrirjen e kompetencave të tij për trajtimin dhe vendimmarrjen e një çështje ose politike të caktuar. Kompetenca ose juridiksioni i autoriteteve administrative rrjedh nga parimi i ndarjes së pushteteve. Gjithashtu është bazë e parimit të administrimit të mirë, sepse autoriteti administrativ nuk mund të refuzojë të ushrojë kompetencën e tij ose të heqë dorë prej saj, edhe nëse mund të ketë ndonjë dyshim nëse autoriteti ka apo nuk ka juridiksion mbi një çështje të caktuar. Në këto raste, autoriteti duhet të veprojë edhe nëse një palë e tretë kundërshton juridiksionin (qoftë ai individ apo autoritet tjetër administrativ). Legjislacioni parashikon mekanizma për zgjidhjen e konflikteve: "konflikti i kompetencave funksionale" midis autoriteteve administrative ose shqyrtim gjyqësor nëse kundërshtuesi është një palë e tretë.

Kompetenca nuk është vetëm çështje e administrimit të mirë apo ndarjes së pushteteve. Është edhe çështje organizimi ndërmjet dhe brenda organeve publike: autoriteti administrativ që ka kompetencën (ministri për shembull) nuk mund ta ushrojë vetëm kompetencën e tij dhe i duhet ta delegojë atë tek vartësit e tij në mënyrë të tillë që jo vetëm të organizojë punën në mënyrë efektive por edhe t'i paraprijë shumicës së situatave (mungesa, situata krize ...). Ai duhet kontrolluar në mënyrë të vazhdueshme ushtrimin e kompetencave të deleguara pa dëmtuar lirinë e veprimt të nëpunësve të mirë.

Pavarësisht karakterit thelbësor të kompetencës, kodi i ri i procedurave administrative ende ngre pyetje për zbatimin e vetë kompetencës dhe atë të delegimit të saj: deri në ç'masë është i mundshëm delegimi? A duhet të përcaktohet me ligj statutor apo mjafton legjislacioni dytësor? A janë të mundshme nëndelegimet? Si shkruhet delegimi i kompetencës? Cili është ndryshimi midis delegimit të pushtetit dhe delegimit të nënshkrimit? A ka ndonjë ndryshim ndërmjet delegimit dhe zëvendësimit të kompetencave?

Trajneri, drejtues i nivelit të lartë dhe jurist shumë i kualifikuar, do t'u mundësojë pjesëmarrësve të jenë të vetëdijshëm për ndjeshmërinë e çështjes së kompetencës. Do të arrihet në interpretimin më të mirë të mundshëm të neneve të kodit që lidhen me këto tema me anë të shkëmbimit ndërmjet drejtuesve të niveleve të ndryshme, drejtuesve të nivelit të lartë dhe juristëve që do të marrin pjesë, duke përdorur raste konkrete ligjore nga jurisprudenca e vendit, praktikat më të mira nga vendet e tjera dhe mendimin praktik.

Në këtë mënyrë, trajneri do të tërheqë vëmendjen e të trajnuarve mbi nevojën e drejtuesve të të gjitha niveleve që jo vetëm të merren me aspektet ligjore të kompetencës, por edhe të organizojnë njësinë e tyre në mënyrë efektive: çfarë duhet të merrni parasysh kur organizoni ekipin tuaj? Si organizohet ekipi në raste urgjente dhe kriza? Si të organizoni ekipin gjatë pushimeve? etj,

### Temat kryesore

1.	Vendi qendror i nocionit të kompetencës / juridiksionit në kodin e procedurave administrative. Pasojat e përkufizimit të juridiksionit dhe të mosrespektimit të kompetencave.
2.	Delegimi dhe zëvendësimi i kompetencave: interpretimi i kodit përmes jurisprudencës, krahasimit të ligjeve dhe mendimit praktik.
3.	Shkrimi i delegimit të kompetencave.
4.	Organizimi i ekipit për aktivitetin e përditshëm.
5.	Organizimi i ekipit në situata të veçanta raste urgjente, kriza, pushime)

### Metodologjia

Ndërsa interpretimi i kodit në këtë fushë ende ngre pikëpyetje dhe ndërsa publiku përbëhet nga drejtues të të gjitha niveleve, përfshirë dhe ata të nivelit të lartë, trajneri do të mbështetet kryesisht tek shkëmbimet midis pjesëmarrësve, por do të përpiqet që këto shkëmbime të arrijnë një përfundim të përbashkët që përputhet si me dispozitat e kodit dhe me mendimin praktik. Aspektet e ndryshme të lidhura me aftësitë drejtuese dhe organizative mund të trajtohen duke prezantuar lloje të ndryshme organizatash të mira dhe përmes shkëmbimeve dhe/ose lojës me role midis pjesëmarrësve.

## Mbështetje për Reformën e Shërbimit Civil në Shqipëri

Një projekt i financuar nga Bashkimi European



Projekti zbatohet nga  
**Franca (partner Senior)** dhe  
**Italia (partner Junior)**



### A2 Procesi i vendimarrjes Prezantimi dhe objektivat

Kodi i ri i procedurave administrative bazohet ndër të tjera në parimet e efikasitetit, deburokratizimit, transparencës dhe, mbi të gjitha, atë të ndihmës aktive, të cilët duhet të pasqyrohen në organizimin dhe efektivitetin e procesit të vendimarrjes brenda organeve administrative. Prandaj, KPA ngre procedura ku qytetarëve u jepet një gamë e gjerë mundësish për t'i drejtuar kërkesa administratës dhe eventualisht për të kundërshtuar vendimet e saj. Nga ana tjetër, organet administrative dhe nëpunësit civilë janë të detyruar ligjërisht të ndihmojnë çdo qytetar në kërkesën e tij, duke marrë parasysh njohuritë e kufizuara të qytetarit mbi ligjin dhe mbi funksionimin e organeve administrative. Kësisoj, Kodi i imponon shumë detyrime administratës si p.sh të ndihmojë personat të korrigjojnë kërkesat e tyre, të kërkojë kryesisht të gjitha faktet e lidhura në baza objektive, të sigurohet se personat janë informuar ashtu siç duhet për të drejtat e tyre brenda procedurave administrative etj. Gjithashtu, Kodi jep arsyet specifike për pavlefshmërinë absolute të akteve administrative kur akti është i vesuar me paligjshmëri të dukshme.



Ky modul synon së pari përvetësimin dhe/ose përforcimin e kuptimit të plotë të atmosferës së përgjithshme në të cilën bazohet procesi vendimarrës i akteve administrative. Përmes shkëmbimeve dhe diskutimeve të vazhdueshme, trajneri do të mbledhë njohuritë tashmë ekzistuese të të trajnuarve për secilën temë (fillimi i procedurave administrative, komunikimi me palët, hetimi administrativ), do ta përforcojë atë dhe do të japë saktësimet e nevojshme, ndërkohë që vazhdimisht do të theksojë se të gjitha aspektet ligjore të procesit të vendimarrjes bazohen në parimin e përgjithshëm se qëllimi i administratës nuk është të administrojë, por t'i shërbejë qytetarëve.

Dhe për shkak se zbatimi i parimeve të efikasitetit, deburokratizimit, transparencës dhe ndihmës aktive nuk lidhet vetëm me njohuritë ligjore, por me transformimin e kulturës së organeve administrative, moduli do të përfshijë gjithashtu disa aspekte mbi aftësitë drejtuese, të cilat janë thelbi i zbatimit të asaj kulture të re. Përmes roleve të luajtur në çifte nën vëzhgimin e pjesës tjetër të grupit, drejtuesit e të gjitha niveleve përfshirë ata të nivelit të lartë që marrin pjesë në modul, do të vlerësojnë aftësitë e tyre drejtuese dhe do t'i përsosin ato me synimin se si duhet të jetë një drejtues i mirë dhe se si udhëzimet dhe zhvillimet e kulturës së shërbimit u komunikohen më mirë bashkëpunëtorëve.

#### Temat kryesore

1.	Fillimi i procedurës administrative.
2.	Komunikimi me palët.
3.	Hetimi administrativ.
4.	Pavlefshmëria absolute e akteve administrative.
5.	Ç'lloj drejtuesi je? Testo aftësitë e tua drejtuese dhe mëso teknika dhe aftësi drejtimi.
6.	Si të përshtatni më mirë kulturën tuaj të shërbimit me zbatimin e parimeve të KPA-së. Zbatimi i KPA-së nuk është thjesht punë zbatimi rregullash, është edhe të krijosh kulturën e shërbimit me synimin për të kënaqur qytetarët, prandaj përfshihen aspekte të drejtimit organizativ dhe të personelit në organet publike.

## Metodologjia

Në aspektin teorik (5 temat e para), trajneri do të mbështetet në njohuritë ekzistuese të të trajnuarve me anë të pyetjeve, diskutimeve dhe shkëmbimeve. Qëllimi i tij / saj do të jetë vetëm të korrigjojë njohuritë nëse është e nevojshme, për t'i aktësuar dhe përforcuar ato. Në asnjë rast, aspektet teorike nuk duhet të mësohen në mënyrë akademike statike. Sesioni mund të fillojë, përshembull, me një pyetje të thjeshtë: "ju si drejtues, si e filloni procedurën administrative?". Trajneri pastaj mund të mbledhë të gjitha përgjigjet duke i shkruar ato në një vijë të vizatuar në tabelë. Trajneri mund të bëjë pyetje për aspekte të patrajtuara ose të krahasojë përgjigjet e kundërta që të trajnuarit të korrigjojnë veten dhe të arrihet përgjigja më e mirë nëpërmjet shkëmbimeve. Vetëm në fund, trajneri përmbledh shkurtimisht të gjithë temën në mënyrë çdo aspekt i temës të jetë trajtuar dhe të shtojë saktësime. Aspektet teorike duhet të jenë të bashkë ose të ndara nga sesione praktike për administrimin, ku 2 grupeve të trajnuarish do t'u jepen role (p.sh: jepni urdhra/udhëzime, motivoni...). Çdo çift të trajnuarish duhet të luajë rolin para pjesës tjetër të grupit. Pastaj të gjithë do të diskutojnë për të mirat dhe të këqijat e asaj që sapo është bërë. Trajnerët në fund duhet të përpiqen të japin praktikatat më të mira të mundshme në administrim.

## A3 Të përballësh me kohën Prezantimi dhe objektivat

Sigurisht që "të përballësh me kohën" ka të bëjë me afatet kohore të përcaktuara në kodin e procedurave administrative : Cilat janë këto afate kohore ? Si llogariten ? Cili është ndikimi i afateve kohore ? Deri në ç'masë mund të zgjatet afati kohor ? Si rivendosen afatet kohore dhe nën cilat kushte ? Prandaj, moduli përmban një kujtesë për dispozitat e kodit dhe interpretimin e tyre, duke pasur formën e një shkëmbimi ndërmjet të trajnuarve dhe trajnerit dhe vetë trajnerëve midis tyre. Trajneri do të flasë për jurisprudencën më të fundit mbi këto çështje (nga legjislati kombëtar ose ai i gjykatave evropiane si GJEDNJ) duke nënvizuar problematikat kryesore mbi të cilat ngrihen çështjet e afateve kohore (p.sh nevoja për të pajtuar sigurinë juridike me të drejtën për ankim të

personave).

Por "të përballësh me kohën" për një drejtues të të gjitha niveleve, përfshirë ata të nivelit të lartë, ka të bëjë edhe me organizimin e kohës së tij dhe të ekipit të tij në mënyrë që të jetë në gjendje të përballojë afatet kohore të vendosura nga KPA dhe ligjet e tjera. Moduli do të paraqesë gjithashtu teknikat më të fundit të drejtimit dhe kleçkat e menaxhimit të ngarkesës së punës si për vete dhe për të tjerët.

### Temat kryesore

1.	Çfarë janë afatet kohore?
2.	Llogaritja e afateve kohore.
3.	Pasojat e skandencës së afateve kohore.
4.	Shtyrja dhe rivendosja e afatit.
5.	Organizimi i ngarkesës së punës për të qenë më efikas, sepse respektimi i afateve kohore është edhe çështje organizimi personal në punë.
6.	Drejtimi i njerëzve dhe organizimi i njësisë për të respektuar afatet kohore, sepse respektimi i afateve kohore në organet administrative mbështetet edhe në organizimin e duhur të personelit dhe në teknikat e drejtimit.

### Metodologjia

Trajneri do të sjellë aspektet teorike përmes diskutimeve dhe shkëmbimeve me grupin e të trajnuarve. Ky diskutim për tema / çështje të ndryshme do të jetë një mundësi për të dhënë interpretime të reja, raste të reja ligjore, saktësime dhe për të rritur njohuritë e të trajnuarve pa bërë mësim tipik. Aspektet teorike do të ndërthuren me mjetet e drejtimit/administrimit nëpërmjet lojës në role, ndarjes së përvojave dhe/ose përmes ndihmës së faqeve në internet që u krijojnë mundësinë pjesëmarrësve të vlerësojnë kapacitetet e tyre për t'u përballur me kohën dhe japin sugjerime të dobishme për këtë temë (<http://persolog.com/portfolio/time-management/> por edhe shumë të tjerë si webinarë/libra/MOOCs (Kurse të Hapura Masive Online) but a lot of other webinars/books/MOOCs exit).



## A4 Kontratat administrative

### Prezantimi dhe objektivat

Megjithëse akti administrativ i njëanshëm është instrumenti themelor i veprimit administrativ, përdorimi i kontratave nga administratat publike konsiderohet sot në disa fusha si të nevojshme për bashkëpunimin demokratik midis autoriteteve publike dhe qytetarëve. Kontratat administrative janë, për shembull, një instrument i mirë për ushtrimin e funksioneve komplekse administrative si ato që kërkojnë partneritet midis enteve publike dhe private apo edhe midis disa organeve publike.

Në të vërtetë kontrata administrative, që e ka origjinën nga e drejta civile, bazohet në synimin e përbashkët të disa palëve (mes të cilave një organ publik) për të vënë midis tyre rregulla ligjore pas një procesi negociatash. Dallimi kryesor me kontratën private është se marrëdhënia juridike e krijuar midis palëve rregullohet me ligj publik për shkak ose të qëllimit të palëve ose të natyrës së kontratës që rrjedh nga qëllimi i saj. Për shkak të kësaj natyre publike, kontrata administrative duhet t'u bindet rregullave të caktuara të përgjithshme të rendit publik, si për lidhjen ashtu edhe për ekzekutimin e saj. Për shembull, kontrata mund të lidhet vetëm në fusha ku njësisë publike u jepet një hapësirë e caktuar vlerësimi, ajo shpesh lidhet pas procedurave të prokurimit publik, nuk mund të merret me çështje të caktuara (siguri, rend publik ...) etj.

Qëllimi i sesionit të trajnimit është të merret me rregullat e përgjithshme të KPA-së që përcaktojnë dhe rregullojnë kontratat administrative; të shqyrtojë kategoritë kryesore të kontratave administrative (prokurimet publike, partneritetet publike-private ...) si dhe rregullat specifike më të spikatura që zbatohen për ato kategori (rregullat e prokurimit publik ...). Do të rrisë numrin e fushave të administratës publike në të cilat mund të përdoren kontratat administrative dhe do të nxisë përdorimin e këtij instrumenti ligjor.

### Temat kryesore

1.	Nevoja dhe dobia e kontratave administrative (shembuj konkretë, krahasime ndërkombëtare).
2.	Përkufizimi i kontratës administrative.
3.	Nënshkrimi dhe ekzekutimi i kontratave administrative (rregulla të përgjithshme).
4.	Prokurimet publike: përkufizimi, përdorimi, rregulla specifike.
5.	Partneriteti-Publik-Privat: përkufizimi, përdorimi, rregulla specifike.
6.	Kontratat midis enteve publike.

### Metodologjia

Do të sillen aspekte teorike përmes diskutimeve dhe shkëmbimeve ndërmjet trajnerit dhe të trajnuarve, bazuar në shembuj aktualë kontratash të lidhura nga subjektet administrative. Përmes këtyre diskutimeve, trajneri do të nënvizojë përkufizimin e përgjithshëm të kontratës administrative dhe dallimet midis formave të ndryshme të kontratave. Një pjesë e rëndësishme e trajnimit do të merret me vënien në pah të dobisë së kontratave administrative dhe të domosdoshmërinë së rregullave të njoftimit dhe tenderimit konkurrues. Mund të organizohet edhe lojë rolësh duke i ndarë të trajnuarit në grupe të vogla, në situatën e kryerjes së një procedure prokurimi publik: një ose dy grupe mund të përfaqësojnë organin administrativ dhe të tjerët shoqëri të ndryshme private që dëshirojnë të fitojnë tenderin. Secili grup do të përgatisë dokumentet dhe argumentet kryesore që kërkohen në këtë situatë (njoftimi i konkurrimit për tender publik, ofertat në përgjigje të njoftimit, argumentet për zgjedhjen e fituesit ...)

## Modulet për Nivelin e Mesëm dhe të Lartë Drejtues (C) të KPA-së

### Zotërimi i Kodit të procedurës administrative

Drejtimesit e nivelit të lartë apo edhe i niveleve të tjera e kanë kohën të zënë. Atyre u nevojiten njohuri të sakta për aspekte të veçanta të kodit që do t'i ndihmojnë ata të marrin vendimin e duhur për çështjet procedurale në njësinë që drejtojnë.

Grupi i synuar:

- Drejtues të lartë;
- Drejtues të nivelit të lartë;
- Juristë të nivelit të lartë;
- Nëpunës civilë që kanë aftësi të nivelit të lartë për KPA-në.

Moduli C janë krijuar për ta, si dhe për ata që tashmë zotërojnë aspektet kryesore të kodit dhe janë të gatshëm ose të shkojnë më thellë në çështje specifike ose të informohen për risitë e fundit të procedurave administrative. Në një kohë të shkurtër dhe në një mënyrë shumë interaktive, këto module do të ndihmojnë të gjithë këta persona që të jenë në kontakt me temat e nxehta dhe jurisprudencën më të fundit mbi KPA si dhe të diskutojnë këto tema me specialistë shumë të kualifikuar (si gjyqtarët administrativë); t'i drejtojnë në zbatimin efektiv të parimeve më të rëndësishme të administratës moderne demokratike (paanshmëria për shembull) dhe t'u mundësojnë atyre të shohin aspektet më komplekse organizative të procedurës administrative si apelimi. Temat e këtyre moduleve do të rishikohen çdo vit për të marrë parasysh çështjet më të ndjeshme të administratës publike.

### Pamje e përgjithshme

<b>C1</b>	Zhvillimet e fundit dhe jurisprudenca mbi KPA-në (gjysmë dite)
<b>C2</b>	Garantimi i paanshmërisë së administratës publike (gjysmë dite)
<b>C3</b>	Ankimi (gjysmë dite)

## C1 Zhvillimet e fundit dhe jurisprudenca mbi KPA

### Prezantimi dhe objektivat

Qëllimi i këtij sesioni është të diskutohet me një gjyqtar administrativ mbi risitë dhe zhvillimet kryesore në fushën e procedurave administrative, sidomos në praktikën gjyqësore të gjykatës administrative dhe gjykatave të tjera për KPA.

### Temat kryesore

<b>1.</b>	Rastet më të fundit të praktikës gjyqësore të gjykatës administrative dhe gjykatave të tjera për KPA-në.
<b>2.</b>	Pyetjet kryesore që dalin brenda organeve administrative për interpretimin e KPA-së.
<b>3.</b>	Evolucioni i praktikës gjyqësore të gjykatave të huaja dhe atyre evropiane në fushën e procedurave administrative.

### Metodologjia

Trajneri, i cili duhet të jetë gjyqtar administrativ, do të prezantojë në mënyrë interaktive praktikën gjyqësore më të fundit dhe më të spikatur të gjykatave kombëtare, të huaja dhe evropiane në fushën e procedurave administrative. Trajneri duhet të zgjedhë vetëm disa raste, të cilat do të lexohen nga të trajnuarit dhe të diskutojë me ta si ka qenë çështja, opsionet e ndryshme që mund të merreshin parasysh dhe të shpjegojë pse u përdor në fund ajo zgjidhje specifike. Përveç kësaj, trajneri, me ndihmën e ASPA-s, duhet të mbledhë para trajnimit pyetjet e ndryshme që mund të ngrihen nga pjesëmarrësit në lidhje me interpretimin e kodit (çështjet në rritje që dalin nga praktika brenda organeve administrative) dhe, brenda mundësive, të përgatisë diskutime midis të gjithë pjesëmarrësve në këto tema duke sjellë edhe materiale (praktikë gjyqësore vendase, të huaj ose ndërkombëtare, komentari i Sigma për KPA-në) që mund të ndihmojnë në zgjidhjen paraprake të këtyre pyetjeve.

## C2 Garantimi i paanshmërisë së administratës publike

Paanshmëria e administratës publike është thelbi i shtetit demokratik dhe sundimit të ligjit. Në këtë parim mbështetet besimi i njerëzve në organet administrative dhe tek pushteti ekzekutiv. Paanshmëria në administratë do të thotë se çdo vendim administrativ do të jetë vetëm zbatim i ligjit pas një analize të thellë të fakteve dhe veprimeve dhe jo rezultat i gjykimeve të njëanshme që vijnë për shembull nga korrupsioni, konfliktet e interesit, gjykimet ideologjike ose fetare ... Paanshmëria nuk është thjesht parim teorik: ajo duhet të sigurohet çdo ditë, nëpërmjet mënyrës së organizimit dhe funksionimit të organeve administrative dhe me vëmendjen e vazhdueshme të drejtuesve të të gjitha niveleve dhe të gjithë nëpunësve civilë në mënyrën se si kryejnë detyrat.

Qëllimi i këtij sesioni nuk është vetëm rikujtojë ose jo parimin e përgjithshëm të paanshmërisë por të studiojë, diskutojë dhe përmirësojë zbatimin praktik të këtyre parimeve në organet administrative dhe të kontribuojë në krijimin e një kulture të vërtetë të paanshmërisë tek drejtuesit e lartë dhe si rrjedhojë në të gjithë shërbimit civil.

### The main themes

1.	Parandalimi dhe lufta ndaj korrupsionit në organet administrative.
2.	Të merresh me konfliktin e interesave.
3.	Po interesat ideologjike dhe fetare? Edhe këto mund të çojnë në vendime të njëanshme administrative, por menaxhimi i tyre ndryshon nga konfliktet e interesit ekonomik.
4.	Organizimi i organeve publike për të siguruar vendim të paanshëm, sepse për të siguruar paanshërinë e çdo vendimi administrativ drejtuesit e të gjitha niveleve, përfshirë ata të nivelit të lartë, duhet të sigurojnë se i gjithë procesi i vendimarrjes dhe të gjithë njerëzit e përfshirë janë të organizuar dhe përzgjedhur për të shmangur konfliktet e interesave. Shmangia e konflikteve të interesave është gjithashtu një çështje drejtimi.

### Metodologjia

Teorikisht, trajneri duhet të jetë përfaqësues i organizatave ndërkombëtare ose OJF-ve të specializuara në fushën e trajtimit të konflikteve të interesave (si OECD, Këshilli i Evropës, Transparency International etj.). Ai / ajo nuk duhet të bëjë ndonjë prezantim teorik, por t'i mundësojë çdo pjesëmarrësi të përshkruajë masat e ndryshme të marra në administratën e tij / saj për të rritur transparencën dhe paanshmërinë. Çdo prezantim duhet të pasohet nga një diskutim midis të gjithë pjesëmarrësve dhe trajnerit: ky i fundit duhet ta marrë këtë si mundësi për të treguar praktikatat më të mira dhe pse jo për të sugjeruar praktika të reja ose forma të reja organizimi.

## C3 Ankimi

Ankimet në fushën e procedurave administrative nuk janë vetëm një mundësi tjetër që u jepet qytetarëve për rishikim të vendimit të parë administrativ nga një organ epror. Në të vërtetë, ankimi ka për qëllim edhe të ndihmojë organet administrative në korrigjimin e gabimeve dhe në përmirësimin e organizimit dhe procedurave të tyre. Ai ul numrin e proceseve gjyqësore para gjykatave administrative dhe ndihmon që rastet e sjella para tyre të përqëndrohen në aspektet më të rëndësishme ligjore që duhet të trajtohen. Sidoqoftë, për të kryer këto funksione, për të qenë realisht i dobishëm dhe të mos kthehet vetëm barrë shtesë për qytetarët dhe nëpunësit civilë, ankimi duhet të organizohet dhe organizohet në tërësi.

Sesioni ka për qëllim t'u japë një dorë drejtuesve të të gjitha niveleve në organizimin dhe drejtimin e organeve të nevojshme të ankimit dhe t'i ndihmojë ata të marrin më të mirën e vendimeve të marra nga këto organe gjatë funksionimit të tyre normal.

### Temat kryesore:

1. Përse na duhen organet e ankimit?
2. Organizimi dhe veprimtaria e organeve të ankimit.
3. Marrja në konsideratë e vendimeve të organeve të ankimit në veprimtarinë e organeve administrative.
4. Pasojat e ekzistencës së organeve të ankimit në proceset gjyqësore para Gjykatave.

## Metodologjia

Trajnuesi (idealisht një drejtues i lartë në një organ ankimi) do të përmirësojë aspektet praktike të funksionimit të organeve të ankimit përmes diskutimeve me pjesëmarrësit, krahasimit ndërkombëtar, analizave të komenteve të Sigma mbi KPA-në dhe përvojës personale. Duke marrë parasysh vëzhgimet e të trajnuarve si drejtues në organet e tjera publike, trajneri do të nxjerrë në pah edhe aspektet e dobisë së ekzistencës së organeve të ankimit dhe vendimet që marrin.

# Shtojcat

## Shtojca 1:

# Vështrim i përgjithëm i Kodit të Procedurave Administrative .

## Dokumenti 1: Prezantimi me Administratën Publike" (Niveli fillestar)

Emri i ekspertit: Prof. Dr. Eralda (Methasani) Çani

### Sesioni I - Kuadri rregullator për procedurat administrative

*Analizë e rasteve konkrete të marrëdhënies mes ligjeve të ndryshme rregullatore të proceseve administrative*

### C'kuptojmë me procedure administrative?

*Procedurë administrative është:*

- *veprimtaria e një organi publik*
- *me qëllim përgatitjen dhe miratimin e*
- *veprimeve konkrete administrative*
- *ekzekutimin e tyre dhe*
- *rishikimin e tyre me mjete ligjore administrative*

4

*Prof. Dr. Eralda (Methasani) Çani*

### Kodifikimi i proceseve administrative

#### Funksionimi/proceset administrative:

- realizimi konkret i qellimeve te organeve publike
- Shfaqja e vullnetit:
  - Aktet nenligjore
  - Aktet administrative
  - Kontratat administrative

### • Elemente bazë të procesit administrativ




Organe Publike / organet e administratës publike

Subjektet të së drejtës

### • Kuadri rregullator normativ i proceseve administrative

- *Kushtetuta*
- *Marreveshje/ Konventat Nderkombetare te ratifikuara*
- *Ligje: 3/5 dhe të thjeshta*
  - Aktet Normative me Fuqine e Ligjit
- *Aktet normative të Keshillit të Ministrave*
  - Vendime
  - Udhëzime
- *Individuale administrative:*
  - Vendime
  - Urdhra
- *Të ministrave / institucioneve qendrore*
- *Të qeverisjes vendore*



## Kuadri rregullator i procedurave administrative

Kodi i Procedurave Administrative – ligj horizontal me shumice te cilesuar (3/5) ne RSH

Ligje të tjera me shtrirje horizontale, që rregullojnë aspekte procedurale me karakter lendor te caktuar:

- E drejta e informimit (ligji 119/2014)
- Konsultimi (Ligji 146/2014)
- Konflikti i interesave (LIGJ Nr. 9367, datë 7.4.2005, i ndryshuar)
- Rregullat procedurale per organet kolegjiale (ligji 8490, datë 27.5.1999), etj.

Ligje të posacme që përmbajnë rregulla specifike procedurale për një cëshje apo organ të caktuar: lex specialis

Diskutim: Ndërveprimi mes këtyre ligjeve!!!

## Seksioni 2 - Kodi i ri i Procedurave Administrative (KPA)

*Ligj bazë (i unifikuar) horizontal për proceset administrative (pavarësisht nga natyra e tyre)*

### Avantazhet dhe qellimet e nje ligji mbi proceduren administrative – zhvillimet

#### Avantazhet e Procedimit Administrativ- kendveshtrime te avancuara

- qartësi e zhvillimit të procedurës administrative
- njohje e normave juridike të administratës
- vendos vendimmarrjet nën procesin e rregullt
- mbrojtje e të drejtave e interesave të subjekteve
- ekonomizim i veprimtarisë administrative, etj..

#### Qëllimi i një ligji mbi proceduren administrative – kendveshtrime te avancuara

- garanci formale për të drejtat e individëve / parimi i ligjshmërisë
- garanci formale e interesit publik / transparencë publike në vendim-marrje
- kushte për investime kapitale dhe zhvillim ekonomik/ garanci juridike për parashikueshmëri të vendimmarrjeve

## Pse një KPA e re?

- Procedurë administrative e shpejtë dhe efektive për AP
- Garantim i mjeteve të duhura e të nevojshme për qytetarët për të mbrojtur dhe kërkuar të drejtat e tyre: parimi i procesit të rregullt ligjor
- Garanci për një mjedis të qëndrueshëm për biznesin
- Plotësim i standardeve të BE: standardizim, bashkëpunim, thejshim,
- A ishte e nevojshme të miratohej një ligj i ri horizontal për procedurat administrative?

## Risite

- pikënisje për një proces dinamik të unifikimit të procedurave administrative.
- rregullime ligjore të reja lidhur me *komunikimin elektronik* si dhe pikat e *shërbimit me një ndalesë*.
- Ndërveprim më intensiv i organeve publike/ *ndihmë administrative një organi tjetër publik*.
- *Parimi i dhënies së ndihmës aktive të organit publik ndaj qytetarit*.
- alternative e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve - **koncepti i pajtimit të palëve**
- rregulla për *njoftimin e veprimeve administrative* që rrjedhin direkt nga parimi i sundimit të ligjit: elektronik, prezanton konceptin e **personit përgjegjës për njoftimet**.

### Shpejtësi e informimit

*Delegimi: delegime për shkak të mbingarkimit*

### Hetimi: ex-officio përforcohet

**Mjetet e kërkimit të provës, kuptimin e tyre, vlerësimin si dhe paraqitjen e provave para një organi tjetër**

**Kontakt i vetëm: kërkesat e ndërlihdura – paraqitje në një njësi të vetme**

**E-governance: komunikim elektronik, vendimmarrje elektronike**

**Veprimet administrative dhe mbrojtja ligjore**

**Pëlqimi në heshtje, etj**

## **KPA - cfare perfshin?**

### **Pjesa e parë -dispozita te pergjithshme.**

- hyrje: qëllimi, fusha e zbatimit dhe përkufizime
- parime te procedimit administrativ.

### **Pjesa e dytë - juridiksioni, kompetenca, delegimi dhe zëvendësimi**

### **Pjesa e tretë - garantimi i paanshmërisë së administratës publike**

#### **Pjesa e katërt - procedura administrative**

- rregullime të pjesëmarrjes në procedurën administrative (Kreu I)
- parashikime të përgjithshme mbi procedurën administrative (Kreu II)
- të drejtat e palëve gjatë procedurës administrative (Kreu III)
- njësimi i dokumenteve dhe vërtetimi i nënshkrimit (Kreu IV)
- afatet (Kreu V)
- kërkesa dhe paraqitja e saj (Kreu VI)
- çështjet paraprake dhe vendimet e ndërmjetme (Kreu VII)
- vendimmarrja e përbashkët dhe ndihma ndërmjet organeve publike (Kreu VIII)
- pikat e shërbimit me një ndalesë (Kreu IX)
- kryerja e hetimit administrativ (Kreu X)
- përfundimi i procedurës administrative (Kreu XI).

#### **Pjesa e pestë - veprimtaria administrative,**

- Kreu i - akti administrativ (kërkesat formale të aktit administrativ, pasojat juridike të aktit administrativ, ligjshmërinë, pavlefshmërinë dhe korrigjimin e aktit administrativ, anulimin dhe shfuqizimin e aktit administrativ)
- Kreu ii - kontrata administrative
- Kreu iii - veprimet e tjera administrative nën regjimin e së drejtës administrative
- Kreu iii - veprimet e tjera administrative nën regjimin e së drejtës administrative
- Kreu iv - kryerja e tërthortë e shërbimeve publike.

#### **Pjesa e gjashtë, mjetet ligjore administrative**

- ankimi administrativ ndaj aktit administrativ
- kërkesat formale të ankimit administrativ ndaj aktit administrativ
- kundërshtimi administrativ
- rishikimi

### **Pjesa e shtatë - njoftimi**

#### **Pjesa e tetë - ekzekutimi i aktit administrativ**

- Kreu i - dispozita të përgjithshme
- Kreu ii - ekzekutimi vullnetar i aktit administrativ
- Kreu iii - ekzekutimi i detyrueshëm i aktit administrativ
- Kreu iv - pezullimi, pushimi dhe ankimimi i ekzekutimit

### **Pjesa e nëntë, është pjesa e dispozitave kalimtare dhe të fundit**

## **Seksioni 3 - Parimet themelore të organizimit dhe funksionimit të administratës publike**

Diskutim i shembujve të ndryshëm

### **Cilet jane parimet dhe cilat ligje i sanksionojne?**

- **Kushtetuta e RSH**
- **Marreveshjet**
- **Ligjet**

- KPA , Kreu II , nenet 4-21
- ligje te tjera

### **Parimet - qëllimi:**

- shmangie e gabimeve konceptuale
- njehsimin me praktikatat më të mira

### **KPA: parimet (ndryshimet)**



**KPA - 1999**

- ligjshmëria;
- balanca e interesave
- barazia e proporcionaliteti
- paanshmëria
- bashkëpunimi
- përgjegjësia
- marrja e vendimeve
- eficensa e deburokratizimi
- mospagimi i shërbimit
- transparenca
- konfidencialiteti
- Kontrolli

<b>Ligjshmëri</b>
<b>Transparencë</b>
<b>Informimit</b>
<b>Mbrojtje e sekretit shtetëror dhe konfidencialiteti si dhembrojtje e të dhënave</b>
<b>Dhënie e ndihmës aktive</b>
<b>Ushtrimi i ligjshëm të diskrecionit</b>
<b>Proporcionalitetit</b>
<b>Drejtësisë dhe i paanësisë</b>
<b>Objektivitetit</b>
<b>Përgjegjësisë</b>
<b>Marrjes së vendimeve</b>
<b>Barazisë dhe i mosdiskriminimit</b>
<b>Deburokratizimi dhe eficensa</b>
<b>Mospagimit në procedurat administrative</b>
<b>Gjuha dhe përkthimi në procedurën administrative</b>
<b>Kontrolli</b>

**Parimi i Ligjshmërisë (Neni 9 KPA)****• Parimi i ligjshmërisë**

- Neni 4 i Kushtetutes: "e drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit"

*e drejta = tërësi normash, pra edhe ligji, edhe marrëveshjet, edhe të gjitha burimet e saj, sipas hierarkisë*

- Neni 5 - 6 etj,
- N. 4 i KPA-se



- mbështetja kushtetuese: e drejta dhe hierarkia e normave
- të mbështetet veprimtaria administrative në ligje (marrëveshje, kushtetutë): në bazë e për zbatim të ligjit
- të mos shkelet/cenohet ligji
- të zbatohet ligji i kohës
- veprimtaria e organeve të jetë në përputhje me kompetencat e parashikuara në ligj
- qëllimi i veprimtarisë së tyre të jetë në përputhje me qëllimin e ligjit
- aktet juridike të jenë nxjerrë në përputhje me rregullat materiale dhe procedurale (revokim e shfuqizim)
- aktet juridike të jenë në përputhje me ligjet
- kompetenca / diskrecionaliteti
- Procesi i rregullt ligjor!

**Parimet: Nenet 5 - 9**

- Transparenca (n.5)
- Informimi (n.6): - ligji 119/2014
  - Transparenca (n.5)
  - Informimi (n.6): - ligji 119/2014
- Sekretit shtetëror (n.7): Ligji **Nr. 8457 "Për informacionin e klasifikuar 'sekret shtetëror'" dt. 11.2.1999**
  - Nese pergjate proceseve administrative - detyrim per mosperhapje

- Konfidencialiteti (n.8):
  - Ruajtje e te dhenave personale apo konfidenciale
- Te dhenat personale (n.9): Ligji
  - Mbrojtje, ruajtje, mosperhapje, konfidencialitet

### Disa rregullime ne KPA - E drejta e Informimit

- Pjesa 4 /Kreu 3** - Të drejtat e palëve gjatë procedurës administrative
- të njihen me dokumentet e dosjes së kësaj procedure, si dhe të marrin kopje të tyre (brenda 5 ditëve nga paraqitja e kërkesës)
  - kur kane të dhëna personale, tregtare ose profesionale, mund të merren ose përdoren nga të tretët vetëm me pëlqimin e individit, të cilit i përkasin këto të dhëna, me perjashtim kur dokumentet do të përdoren për qëllime të parashikuara në ligj ose akte nënligjore
  - kurdokumentacioni administrohet në formë elektronike, sigurohen mjetet e nevojshme teknike per t'u njohur
  - Kopjet e dokumenteve me pagese

### Pjesa e 7 - Njoftimi

- Organi publik komunikon veprimin administrativ ose veprimin procedural me anë të njoftimit
  - Verbalisht
  - dokumenti i shkruar të njoftohet me postë, mjete elektronike, faks apo njoftim formal

### Ligje te posacme parashikime specifike per te drjten per informim Nr. 119/2014

#### PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike.

Pa qenë nevoja të vërtetojë se ka një interes personal

Detyrueshmërinë e organit për të dhënë informacion përveç rasteve të parashikuara në ligj (shih n. 17)

Realizimi i të drejtës:

- *Sa me shpejt: jo me vone se 10 dite pune (ose shtyhet per shkaqet ne ligj..) ose 15 kur organi eshte i ndryshem nga ai ku u depozitua kerkesa. (shih n. 15)*
- Pa u diskriminuar
- Me mjete të efektshme
- Pa pagese: kosto shërbimi / ndihma juridike

### Te dhenat personale - Legjislacioni

- Kushtetuta
- Aktet Ndërkombëtare
- Ligji për mbrojtjen e te dhënave Personale: Ligji Nr. 9887, 10.3.2008, i ndryshuar
- Kodi i Procedurave Administrative - Ligji nr. 44/2015 nga data 28 maj 2016
- Ligji për Kundërvajtjet Administrative
- Akte nenligjore te Komisionerit

Ndihma aktive - n. 10

- Mos dija - jo perkeqesuese e interesave
- Informon palët mbi:
  - të drejtat dhe detyrimet e tyre
  - informacionin e lidhur me procedurën
  - Paralajmëron për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre
  - Akses elektronik - jo e deyrueshme

### Ushtrimi i ligjshëm i diskrecionit

\*N.11 - Diskrecioni ushtrohet ligjërisht kur:

- është i parashikuar me ligj
- nuk tejkalon kufijtë e ligjit
- zgjedhja e organit vetëm për të arritur objektivin për të cilin është
- lejuar diskrecioni dhe është në përputhje me parimet e KPA
- zgjedhja nuk përbën një shmangie të pajustificuar nga vendimet e mëparshme të marra nga i njëjti organ në raste të njëjta apo të ngjashme

*Shihni dallimin nga kuptimi i KPA te vitit 1999!*

### Parimi i proporcionalitetit - Neni 12

- Kufizimet e të drejtave individuale, ose cenimet e interesave legjitimë - proporcionale

- Kujtojmë n. 17 të Kushtetutes!
- Proporcional kur :
  - i nevojshëm për të arritur qëllimin e përcaktuar me ligj dhe e arrin atë me mjetet dhe masat që cenojnë më pak të drejtat apo interesat legjitimë të palës;
  - i përshatshëm për të arritur qëllimin e parashikuar në ligj; dhe
  - në përpjesëtim të drejtë me nevojën që e ka diktuar atë.

### Parimi i drejtësisë dhe paanësisë - Neni 13

- të gjitha subjektet trajtohen në mënyrë të ndershme dhe të paanshme
- kërkon vleresim teresor të situatave dhe trajtim të ndershem të tyre
- jo preferenca ndaj njerit apo tjetrit grup të interesuar
- garantohet paanshmeri edhe me tej nga KPrA
- Pjesa e tretë – Garantimi i paanshmërisë / N. 37 – 42 i KPAsë
- Ligji nr. 9049, datë 10.4.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë" (i ndryshuar);
- Ligji nr. 9131, datë 8.9.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike";
- Ligji nr. 9367, datë 7.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" (i ndryshuar);
- Ligjet e posacme!

### Konflikti i interesave:

- për shkak vendimmarrje
  - faktit, i mundshëm, në dukje
  - rast për rast, i vazhdueshëm
- për raste të vecanta (absolut!)

### Ligji PKI: hapat metodologjikë (\*ILDKPKI)

- Llojet e konfliktit të interesit:
  - Faktik, i mundshëm dhe i dukshëm
  - rast për rast dhe i vazhdueshëm
  - ndalime absolute

### • Hapat metodologjike:

- Cilat janë detyrat dhe kompetencat konkrete e të detajuara të zyrtarit në fjalë?
- A ka ai kompetencë thelbësore e përcaktuese në vendimmarrjen për nxjerrjen e akteve normative dhe/ose individuale konkrete?
- Cila është sfera (hapësira, fusha) e ndikimit të këtij akti?
- Sa i fortë është ndikimi i këtij akti në këtë sferë?
- Cilat janë interesat private të zyrtarit në fjalë?
- Çfarë mundësisë ka që akti të ndikojë interesat private të këtij zyrtari në favor të tij?
- Çfarë mundësisë ka që interesat private të zyrtarit të ndikojnë negativisht rolin e tij në vendimmarrjen për këtë akt?
- A ka një lidhje të fortë shkak-pasojë ndërmjet interesave dhe aktit, e tillë që vendimmarrja publike të mund të jetë, për këtë shkak dhe vetem për të, një vendimmarrje e padrejtë?

### Parimi i objektivitetit - n. 14

- organet publike marrin në konsideratë dhe i japin rëndësinë e duhur
  - të gjitha kushteve
  - të gjitha të dhënave
  - të gjitha provave, që
- lidhen me procedurën administrative

### Parimi i përgjegjësisë, - Neni 15 dhe Ligji Nr. 8510, date 15. 7. 1999

- mbajnë përgjegjësi për dëmet që u shkaktojnë palëve, në përputhje me legjisllacionin përkatës
  - Masat disiplinore
  - Vepra penale
  - Përgjegësia jashtëkontraktore

Përgjegësia jashtëkontraktore: Ligji Nr. 8510, dt 15.7.1999:

- kryejnë veprime a mosveprime të kundershmë;
- kryejnë veprime a mosveprime të ligjshme, por sjellin demtimin e interesave të ligjshme të personave fizike a juridike private;
- megjithëse kryejnë veprime a mosveprime të ligjshme, u shkaktojnë

nje dem te pabarabarte subjekteve te cileve u drejtohet ky veprim a mosveprim;

- per shkak te mosfunksionimit te mjeteve teknike me te cilat organet e administrates shtetereore ushtrone veprimtarine e tyre, persona fizike a juridike private cenohen ne interesat e tyre te ligjshme;
- shkaktojne nje rrezik te vazhdueshem personave fizike a juridike private.
- **Cili mban pergjegjesi?** Institucioni
- **Po individi vendimmarres?**  
**Parimi:** kur demi vjen si rezultat i ushtrimit te funksionit shtetedor nuk mbajne pergjegjesi, por
  - Ne rast se provohet se kane vepruar me keqbesim, po
  - Ne rast se po, organi duhet te paguaje personin e demtuar dhe me pas ta kerkoje shperblimin e demit nga punonjesi zyrtar.

## Llojet e shperblimit të demit

- **Llojet e demit**
  - Demi pasuror
  - Dem jo pasuror:
- **Llojet e shperblimit te demit**
  - Zhdukja e shkaqeve
  - Kthim
  - Shperblimi
  - Demi moral: gjithmone shperblehet me te holla
- **Faji i te demtuarit!**
- **Afati:**
  - brenda 3 vjetesh nga çasti kur i demtuari merr dijani per demin dhe organin qe e ka shkaktuar ate

## Përgjashtimi nga përgjegjesia

- AP nuk pergjigjet per demin e shkaktuar kur:
  - demi nuk do te mund te shmangej edhe nese do te ishte treguar **kujdesi i duhur gjate ushtrimit te funksioneve shtetereore, ne pajtim me rrethanat.**
  - Kjo nuk zbatohet ne rastin e **mosfunksionimit te mjeteve teknike.**

## Parimi i marrjes së vendimeve - Neni 16

DETYRIMI per vendimmarrje!

1. Organet administrative marrin vendime për :
  - për të gjitha çështjet e ngritura nga një palë
2. Afati i marrjes së vendimeve: sa me pare, sipas nje afati te caktuar nga vete ligji i posacem apo vete organi !

## Parimi i barazise dhe proporcionalitetit - Neni 17

- origjine kushtetuese - barazi e subjekteve para ligjit (n. 18 i Kushtetutës)
  - jo diskriminim - Kushtetuta, KEDNJ
  - Interpretim:
    - dy raste individuale objektivisht të njëjta, trajtohen njesoj nga administrata
    - dy raste objektivisht të ndryshëm, trajtohen ndryshe nga administrata
    - Praktika e meparshme e organeve te administrates respektohen, me perjashtim te rasteve kur ekzistojne arsye të forta një praktikë e paligjshme s' mund të justifikohet me këtë parim trajtimi i ndryshëm i çështjeve mund edhe të justifikohet pa shkelur parimin nese rrethanat e kerkojne kete
- \*Diskutime rastesh!*

## Parimi i efëncës dhe deburokratizimit - Neni 18

- jo ndonje forme e caktuar e procedures administartive.
- zhvillohet sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se afati kohor i parashikuar me ligj për të.
- procedura me sa më pak kosto për organin publik dhe për palët.

## Parimi i mospagimit të shërbimit - Neni 19

- nuk paguhen shërbimet e administrates
  - perjashtim: kur ligji parashikon tarife:
    - Jo me e madhe se kosto e shërbimit.
  - jo pagesën e tarifave edhe kur parashikohet me ligj, kur palët janë në pamundësi për të paguar.
    - N. 96i KPAsë parashikon perfundimin e procedimit (pra mosofrimin e shërbimit) kur parashikohet pagesë për procedim dhe ajo nuk është kryer sipas ligjit dyfishin e shumës brenda 10 ditëve
- \* Shembuj edhe nga ligji 119/2014*

## Gjuha dhe përkthimi në procedurën administrative n. 20

- Procedura në gjuhën dhe shkrimin shqip
  - Nëse kërkesa në gjuhë të huaj - kërket shqip
1. Afati i paraqitjes së kërkesës i rrespektuar
  2. Lihet një afat për depozitimin në shqip: nëse respektohet, 1 i plotësuar
  3. Organit publik i rrejdhet afati pas marrjes në shqip të kërkesës
  4. Nëse nuk i lihet një afat për depozitimin në shqip - kërkesa quhet e pranuar

## Parimi i Kontrollit administrativ, gjyqësor dhe tjetër - neni 21KPA

**Qëllimi:** të mbrohen të drejtat kushtetuese dhe ligjore të personave privatë nga veprimaria administrative

### • Legjislacioni:

### • Kushtetuta

- KPrA - Pjesa e gjashtë - mjetet ligjore administrative, n. 128 - 146
- ankimi administrativ
  - Ankimi administrativ ndaj aktit administrativ ose mosveprimit të organit publik
  - kundërshtimi administrativ ndaj një veprimi tjetër administrativ nën regjimin e së drejtës administrative
- Rishikimi

- ! Pala nuk ka të drejtë të ushtrojë për së dyti mjetet ligjore administrative për të njëjtën çështje.

## Ligji 49/2012 - Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative

- Në parim pas shterimit të ankimit administrativ
- Shqyrton çdo veprim e mosveprim administrativ
- Shqyrtimi për paligjshmeri e rregullsi
- Kontrollon sa akte individuale aq ato me karakter të përgjithshëm
- Barra e provës: në një pjesë të rasteve tek organi administrativ!

## Dokumenti 2: Përkufizimet (Fillestar/i thelluar) Nga Z. Yves DOUTRIAUX

Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian



Projekt Binjakëzimi AL 12 IB OT 01



**"Mbështje për Reformën e Shërbimit Civil"**

Aktiviteti 1.2: Zbatimi i Ligjit për Procedurat Administrative

**Përkufizimet**  
**22-26 Shtator 2016, Tiranë**



### Veprimi administrativ

"Veprimi administrativ" është

- "Akti administrativ"
- "Kontrata administrative"
- "Çdo veprim tjetër administrativ"

"Veprimtaria administrative" është tërësia e veprimeve dhe akteve që përbëjnë dhe shprehin vullnetin e administratës publike si dhe ekzekutimin e vullnetit

### Akti administrativ individual /kolektiv

- Një akt administrativ individual apo kolektiv krijon, ndryshon apo shuan një marrëdhënie juridike konkrete, në favor apo kundër një subjekti individual apo subjekteve kolektive të ligjit (persona fizikë apo juridikë). KPA përshkruan format (për shembull çështjet ku duhet arsyetuar akti administrativ - Neni 100), kushtet për hyrjen në fuqi -104, të ligshmërisë së tij - 107, anulimin apo shfuqizimin e tij - 113-119.
- Një akt kolektiv përbëhet nga akte të ndryshme individuale: shembuj: një listë me nëpunës civilë të ngritur në përgjegjësi, që kanë të njëjtën gradë dhe anëtarë të të njëjtës trupë.

### Akt garancie

- "Akt garancie" (Neni 103): një akt nëpërmjet të cilit një organ publik mund të sigurojë se ai do të nxjerrë ose nuk do të nxjerrë një akt të caktuar administrativ në një datë të mëvonshme. Kjo mundësi, e cila u jep garanci ligjore subjekteve të ligjit, duhet të parashikohet në ligj të veçantë. Një akt garancie rrit përgjegjësinë e administratës.
- Për shembull (Fr) një "certifikate ndërtimi" e një pushteti vendor pas kërkesës së një pronari të një prone të paluajtshe është garanci që aktet nëligjore që kufizojnë të drejtat mbi pronësinë si dhe taksat e ndërtimit nuk do të ndryshojnë gjatë 18 muajve pas lëshimit të kësaj certifikate. Në këtë mënyrë, ky pronar mund të planifikojë në mënyrë të sigurt kërkesën e tij për një leje ndërtimi.
- Pa një ligj të posaçëm, akti i garancisë nuk mund të detyrojë administratën, pasi qytetarët nuk kanë të drejta që ndalojnë ndryshimin e legjislacionit, gjë që është gjithmonë e mundshme (vendimarrja i përket organit publik) dhe në disa raste mund të jetë edhe i nevojshëm (ndryshojnë rrethanat, vullneti i njerëzve, zgjedhje) ...).

## Akti normativ nënligjor

- “Akti normativ nënligjor” : rregull i përgjithshëm, i vendosur nga një organ publik kompetent. Sipas Nenit 2 pika 3 te KAP, kodi aplikohet për qa sa është e mundur edhe me aktet normative nënligjore. Një rregull i përgjithshëm nuk është specifik për një person individ të caktuar; ai duhet të botohet në një fletore zyrtare dhe nuk mund tu komunikohet individëve me postë apo mjete të tjera.
- Shembuj:
- Një plan rregullimi qyteti i miratuar nga një këshill bashkie (një leje ndërtimi është një akt administrativ individual i cili bazohet në akte ligjore e nënligjore – plani i qytetit – i cili duhet të përputhet me dispozitat ligjore dhe hierarkinë e ligjeve dhe akteve normative).
- Aktet nënligjore të qeverisë (dekretet normative) për të vënë në zbatim dispozita specifike të një ligji (të deleguara Qeverisë nga Parlamenti, ish KPA 59.7 – kërkesa me mjete elektronike – ose 76.3-shërbimi me një ndalesë/sportel).

## Diskrecioni i një organi publik

- “Diskrecion” (hapësira e vlerësimit) e një organi publik: kur një dispozitë ligjore përdor foljen “mund” kur i delegon qeverisë detyrën për të precizuar veprimet e miratuara nga Parlamenti, ky i fundit ia lë diskrecionin qeverisë, duke i dhënë hapësirë për të manovruar, në përzgjedhjen e mënyrës konkrete për arritjen e synimeve të ligjit. Qeveria madje mund të jetë e lirë të mos miratojë një dekret (akt nënligjor). Në rastin e kundërt, nëse ligji thotë që Qeveria miraton – ose do të miratojë – një dekret, ajo nuk ka diskrecion dhe do të ishte e paligjshme të mos e miratonte pas një vonese të caktuar (çështja Conseil d’Etat: më shumë se 18 muaj, me përjashtim të rasteve kur ka vështirësi teknike, që Qeveria duhet të provojë përpara sesa gjykata administrative apo qeveria të ndryshojnë pas zgjedhjeve të përgjithshme). Shembuj:
- Një këshill bashkiak mund të miratojë me diskrecionin e tij një plan qyteti me densitet të lartë urban, ose në të kundërt të stabilizojë densitetin. Por një ligj mund ta detyrojë pushtetin vendor të ndërtojë me një raport të caktuar mes ndërtimeve të reja dhe ndërtimeve

sociale. Në rastin e dytë, pushteti vendor nuk ka diskrecion.

- Kontrolli i gjyqësorit mbi një akt administrativ është më i fortë në rastin e “kompetencave të kufizuara” sesa kur organi publik ka diskrecion. Në rastin e dytë, gjykata do ta kufizonte kontrollin e saj mbi organin publik.

## Kontratat Administrative

Kontratat Administrative (Nenet 120-126): marrëveshje mes dy apo më shumë personave, ku të paktën një prej palëve kontraktuese është një organ publik. Shembuj:

- Një kontratë ndërtimi me një kompani private ndërtimi, të përzgjedhur pas një tenderi publik për ndërtimin e një ndërtese/infrastruktura publike
- Kontratë për rekrutimin e një punonjësi administrativ (kur ky punonjës nuk rekrutohet nëpërmjet një provimi dhe nuk është nëpunës civil karriere)
- Delegim i kontraktuar nga një organ publik tek një kompani private apo organ tjetër publik, që ky i fundit të ofrojë një shërbim publik (psh. mensa e një shkolle publike)
- Partneritet privat-publik ku një kompani private do të ndërtojë, financojë dhe mirëmbajë një pajisje publike përkundërt një pagese qiraje të organit publik për një numër të caktuar vitesh (një burg; në Paris: Ministria e re e mbrojtjes; gjykata e shkallës së parë...). Shtetet që kanë borxhe janë të detyruar të lidhin PPP nëse duan të financojnë infrastrukturën e tyre të nevojshme.
- Kontratë mes qeverisë qendrore dhe një qeverie rajonale me detyrime të përbashkëta financiare, për të ngritur pajisje/infrastruktura publike.
- Ekzistojnë kontrata administrative “false”: qeveria mund të firmosë me një sektor ekonomik të caktuar angazhime të përgjithshme për krijimin e vendeve të punës apo investime. Një kontratë e tillë është dokument politik dhe nuk mund të anulohet nga një gjykatë apo të përdoret nga një gjykatë për të angazhuar përgjegjësinë financiare të organit publik.

## Kompetenca Administrative (Nenet 22-29)

Në një shtet të së drejtës, organet publike mund të vendosin vetëm nëse janë kompetente apo jo për lëndën e caktuar në kohën dhe vendin e caktuar (ratione materiae, temporis et loci) (territoret në nivel kombëtar, rajonal dhe vendor). Kufizimet e kompetencave vendosen nga:

- Kushtetuta: Kuvendi vs. Qeveria, Presidenti vs. Këshilli i Ministrave, pushteti qendror vs. Pushteti vendor, në një shtet federal;
- Aktet ligjore dhe nënligjore.
- Gjykatat kontrollojnë nëse një akt i kundërshtuar është vendosur nga një organ kompetent: nëse jo, akti shfuqizohet.
- Kompetenca dhe firma mund të delegohen nëse një akt ligjor apo nënligjor i botuar e lejon këtë. Ushtrimi i kompetencës është i detyrueshëm. Në parim, nuk lejohet nën-delegimi.

## Organet Publike

Organi publik është një njësi ligjore e cila ofron shërbime publike në interesin e përgjithshëm të qytetarëve. Administrata publike, pushteti vendor, njësitë publike ligjore autonome nën kontrollin e tyre, të cilat ofrojnë shërbime publike specifike (arsimi: universitetet; shëndeti publik: spitalet; kultura: muzetë apo teatrot publikë...) janë organe publike. Shërbimet publike (Fr) mund të ofrohen nga njësi private nëpërmjet delegimit me ligj (urdhrrat profesionalë për profesionet e normuara, dhomat e tregtisë, federatat e sporteve...).

- Këto njësi ligjore respektojnë dispozitat e KPA (Neni 2).
- Vendimet dhe veprimtaritë e organeve publike kontrollohen nga gjykatat administrative.

## Pala (Neni 33)

- Pala është një person fizik apo juridik që bën kërkesë për një procedurë administrative apo është subjekt i një procedure administrative të nisur nga një organ publik. Shembuj: një pronar që kërkon leje ndërtimi; një taksapagues, një përdorues i shërbimeve publike (student, i burgosur, i huaj që aplikon për vizë ose leje qëndrimi, kompani që aplikon për grant...), sindikatë e nëpunësve

civilë që mbron interesat specifike të anëtarëve të saj, një OJF mjedisore që kërkon shfuqizimin e një akti nënligjor që ndikon në mbrojtjen e mjedisit.

- Interesat e një pale të interesuar mund të cenohen nga një vendim i një organi publik. Shembull: një fqinj i një personi që aplikon për leje ndërtimi. Si palë e interesuar, fqinji mund të apelojë kundër lejes së ndërtimit tek autoriteti apo gjykata kompetente;
- KPA saktëson të drejtat (për pjesëmarrje, për tu dëgjuar, për akses në dosje, për tu mbrojtur...) dhe detyrimet (për të zbatuar vendimin administrativ) të palëve në procedura administrative.
- Një palë në një procedurë administrative mund të jetë edhe një organ publik tjetër: një njësi vendore apo urdhër profesional që bën kërkesë për një procedim administrativ tek një qeveri qendrore (grant, ndryshim ligji, botim dekreti...).

## Procedura Administrative

- “Procedura administrative »: proces (i parashikuar nga KPA, pjesa IV, Neni 33 e pasardhës). Ajo është veprimtaria e organit publik me qëllim përgatitjen dhe miratimin e veprimeve konkrete administrative, ekzekutimin e tyre, dhe rishikimin tyre me mjetet ligjore administrative.
- Pjesa IV e këtij kodi përshkruan procesin nga fillimi, me kërkesën e palës(ve) të interesuar, ose «proprio motu», me iniciativën e një organi publik, me pjesëmarrjen e një pale dhe të palës së interesuar deri në vendimin përfundimtar.
- Çdo ditë ka mijëra procedura administrative: p.sh.
- Procesi nëpërmjet të cilit një organ publik refuzon/pranon një kërkesë për leje ndërtimi; refuzon/lëshon një leje drejtimi automjeti; jep/refuzon një grant; rekruton një nëpunës civil; firmos një kontratë me një furnizues, etj.
- Procedura administrative për miratimin e një akti individual zakonisht ndryshon nga procedura administrative për miratimin e një akti nënligjor. Shembull: akti administrativ individual i bëhet i ditur palës së interesuar, kurse, si rregull i përgjithshëm, akti nënligjor botohet në një fletore zyrtare.



## Veprime të tjera administrative (Neni 126)

«Veprim tjetër administrativ» çdo formë e njëanshme e veprimtarisë së organit publik në ushtrimin e funksioneve të tij publike, që nuk plotëson kriteret për të qenë akt administrativ apo kontratë administrative, dhe sjell pasoja juridike për të drejtat subjektive dhe interesat legjitime ( Neni 126 KPA)

- Shembuj: rekomandim i dhënë nga një komision këshillimor; dokument i brendshëm që interpreton dhe udhëzon mbi mënyrën e zbatimit të një dekreti administrativ brenda një organi publik të caktuar; qarkore; organizimi i brendshëm i një shërbimi publik; ndryshimi i postit të një nëpunësi civil pa i ndryshuar pagën, përgjegjësinë dhe vendndodhjen gjeografike.
- Tashmë me kodin e ri, veprimet e tjera administrative mund të atakohen nëpërmjet kundërshtimit administrativ, që nuk ka qenë e mundur sipas kodit të mëparshëm. (Neni 128/3/ii)

## Dokumenti 3: Aktet administrative (98-118- fillestar) Nga Z. Yves DOUTRIAUX

### Aktet administrative (98-118)

- Një formular me shkrim; një formular elektronik, sa vjen edhe më shumë (e-administrata), por në rast të një akti administrativ individual, organet publike duhet të kujdesen për ndarjen digjitale që përjashton disa kategori të caktuara të popullsisë që mund të mos kenë akses në internet dhe tek teknologjitë e reja (pakicat, personat dhe grupet e disavantazuara, vulnerabil, dhe të marginalizuara). Administrata duhet të miratojë dhe të zbatojë udhëzimet mbarë botore për aksesueshmërinë e përbajtjes së eeb-it (1999) për personat me aftësi të kufizuara.
- Akti verbal (i rrallë dhe jo i rekomanduar) duhet të konfirmohet në formë të shkruar. Heshtja është një akt verbal (refuzon të veprojë pas kërkesës së një pale pas një periudhe të caktuar të përcaktuar me akt ligjor apo nën-ligjor – neni 97 «miratimi në heshtje»). Franca kohët e fundit ka përmbysur parimin sipas të cilit heshtja administrative 2 muaj pas një kërkesë për të vepruar do të thotë refuzim, në parimin se «heshtja do të thotë pranim për të vepruar», ndërkohë që janë parashikuar shumë përjashtime dhe ky parim i ri nuk është i pranueshëm në rastet e normave nën-ligjore, aktit financiar, papajtueshmërisë me një traktat ndërkombëtar, mbrojtjes së rendit publik, marrëdhënieve ndërmjet administratave dhe punonjësve të tyre.

### Kërkesat formale, arsytimi (99-101)

- Emri i organit publik që nxjerr aktin, palët të cilave ai u drejtohet (nuk ka palë në rastin e akteve nën-ligjore), data, baza ligjore.
- Arsyetimi (neni 100): situata faktike ,rezultati i hetimeve, baza ligjore, përdorimi i diskrecionit sipas rastit. Fr vetëm disa akte individuale të caktuara duhet të arsyetohen: aktet që kufizojnë lirinë e ushtrimit, sanksionet, kufizimet, shfuqizimi i një ish akti që ka dhënë një të drejtë apo avantazh duke kundërshtuar një parashikim, refuzuar një

avantazh, që është një e drejtë për personat që përmbushin kushtet ligjore, që refuzon një autorizim, që refuzon një ankim administrativ kur një ankim i tillë është i detyrueshëm, përpara kërkesës në një gjykatë. Përfshirjet shqiptare: me ligj, kur akti është një pranim i plotë, miratimi i bordeve, jurive, komisioneve, shpalljes së një aktit kolektiv administrativ.

- Pjesa urdhëruese, koha e hyrjes në fuqi, e drejta e ankimit administrativ dhe në gjykatë, afati, mënyra e llogaritjes së tij.
- Nënshkrimi, emri dhe mbiemri i zyrtarit

### **Kushte shtesë 102**

Një akt administrativ mund të shoqërohet me kushtet: ngjarje e pasigurt që do të sjellë një të drejtë, përfitim apo barrë, një datë apo një afat (mundësi gjatë së cilës është i mundur një autorizim: (Fr) kërkesë për të hapur krevate shtesë në një spital publik apo privat), një kusht ligjor shtesë.

### **Akt i garancisë**

- Akti i garancisë (neni 103): një akt nëpërmjet të cilit një organ publik mund të ofrojë siguri se ai do të nxjerrë një akt apo nuk do të nxjerrë një akt administrativ në një fazë të mëvonshme. Një mundësi e tillë, që ofron siguri ligjore për subjektet e së drejtës, duhet të parashikohet me ligj të vecantë. Një akt garancie angazhon përgjegjësinë e administratës.
- Për shembull (Fr) një qeveri vendore «certifikatë ndërtimi» me kërkesë të një pronari të një pasurie të paluajtshme është një garanci që rregulloret që kufizojnë të drejtat e pronësisë dhe tatimet e ndërtimeve nuk do të ndryshojnë gjatë 18 muajve që ndjekin nxjerrjen e kësaj certifikate në mënyrë që ky pronar të mund të planifikojë në mënyrë të sigurt kërkesën e tij për një leje ndërtimi.
- Pa një ligj specifik, akti i garancisë nuk mund të angazhojë administratën pasi nuk mund të ketë një të drejtë qytetare kundër ndryshimit të ligjit që është gjithmonë e mundur (diskreacionin i organit publik) dhe mund të jetë e nevojshme në disa raste ( ndryshojnë rrethanat, vullneti i personave, zgjedhjet ...).

### **Fillimi dhe mbarimi, efektet prapavepruese 104,105**

- Njoftimi i një akti individual tek pala e interesuar është një kusht për të sjellë efekte ligjore për këtë palë. (Fr) aktet nën-ligjore publikohen në një revistë zyrtare (Shqipëri Neni 106); disa akte kolektive (ngritja në detyrë e së njëjtës gradë, nëpunës civilë të trupave) publikohen; një leje ndërtimi duhet të shpallet për 2 muaj.
- Në rast të miratimit në heshtje (97) akti administrativ në heshtje sjell pasoja ligjore në ditën e skadimit të afatit të përcaktuar nga norma ligjore/ nën-ligjore. Fr: kërkesa e palës duhet të publikohet nga administrata përfshirë datën e akteve administrative potenciale të kërkuara që hyjnë në fuqi në rastin kur administrata nuk do të vendoste për kërkesën brenda afatit; një publikim i tillë do të jepte efekte ligjore për palët.
- Një hyrje e mëvonshme në fuqi mund të vendoset me kusht që të jetë pjesë e aktit të njoftuar.
- Fundi i aktit administrativ: anulim, shfuqizim.
- Në parim një akt nuk ka efekt prapavepruese. Përfshirje :
  - një vendim gjykate që prish një akt ka efekte prapavepruese; një shfuqizim nga administrata konsiderohet sikur ai nuk ka ekzistuar asnjëherë. Por një akt që ka sjellë të drejta për palët nuk mund të shfuqizohet pas një kohe të caktuar.
  - nëse efekti prapaveprues jepet nga ligji.

### **Ligjshmëria, pavlefshmëria 107-112**

- 107: parimi i ligjshmërisë së aktit administrativ -cf neni 4- në një shtet të së drejtës (kompetenca, kërkesat ligjore)
- Pavlefshmëria:
  - kundërshtim flagrante me KPA apo legjislacionin në fuqi, (kompetenca, procedura, forma),
  - të nxjerra nëpërmjet mashtrimit, kanosjes, mitëmarrjes, konflikt interesi, falsifikimit apo një veprimi tjetër që përbën veprë penale;
  - ekzekutimi i tij mund të shkaktojë një veprim të dënueshëm;
  - Çdo rast tjetër të parashikuar shprehimisht në ligj.

- (Fr) për një të metë në formë dhe procedurë (pjesëmarrja, konsultimi ...): akti është i paligjshëm vetëm nëse ky defekt ka cenuar të drejtat e palëve apo ka efekte në përmbajtjen e tij. Por, një akt është i paligjshëm nëse:
  - vendoset nga një organ publik pa kompetencë;
  - është në kundërshtim me një normë më të lartë në hierarkinë e normave;
  - ka një gabim vlerësimi të fakteve të dukshëm në rastin e diskrecionit administrativ;
  - kur kontrolli i gjykatës është një «kontroll i plotë», akti administrativ /sanksioni nuk është proporcional;
  - motivet e tij reale janë të ndryshme nga kompetenca qëllimi (détournement de pouvoir).

### **Efektet e pavlefshmërisë 110**

- Një akt absolutisht i pavlefshëm konsiderohet se nuk ka ekzistuar dhe mund të shpallet i pavlefshëm ex officio ose me kërkesë, në çdo kohë, dhe nuk mund të krijohet të drejta; (Fr) (raste të rralla):akt i nxjerrë në mungesë të qartë kompetence, emërimi në shërbimin civil në një pozicion pa marrë parasysh interesat e shërbimit publik vetëm për të siguruar një avantazh.

### **Pasojat e anulimit dhe shfuqizimit 113-114**

- Administrata (organin që ka nxjerrë aktin apo organi më i lartë, apo një organ tjetër i parashikuar shprehimisht me ligj) mund të anulohet (efekti prapaveprues) apo shfuqizohet (për të ardhmen) aktin e vet ex officio .
- (Fr):
- anulimi me efekt prapaveprues apo shfuqizimi i një akti individual që ka krijuar të drejta për palët është i mundur vetëm brenda një afati 4 muor dhe nëse është i paligjshëm; përjashtim në rast të një ndihme shtetërore tek një kompani që është në kundërshtim me të drejtën e BE.
- një anulim /shfuqizim i një akti që është realizuar me anë të

mashttrimit mund të kryhet në çdo kohë (114.3);  
 • nuk ka afat për anulimin apo shfuqizim nëse kushtet nuk plotësohen më nga përfituesi apo nuk janë respektuar (115,102.1 ç).

### **Anulimi dhe shfuqizimi i një akti administrativ të ligjshëm 116-117**

- Në çdo kohë (117), vetëm nëse është e nevojshme për të parandaluar një dëm serioz për jetën/shëndetin e njerëzve/ sigurinë publike dhe kjo nuk mund të bëhet me mjete të tjera që do të cenonin më pak të drejtat e fituara të një pale; kjo palë do të dëmshpërblehet (përveç fitimit të munguar).
- Në çdo rast tjetër jo më vonë se 5 vjet nga njoftimi.
- (Fr): Nuk ka dispozita ekuivalente, duke pasur parasysh parimin e paprekshmërisë së një vendimi administrativ individual të ligjshëm që ka krijuar të drejta për palën.

## Shtojca 2:

### Tema të veçanta Parimet e procedurës administrative

#### Dokumenti 1: Parimet e procedurës administrative (nivei fillestar/i thelluar) Nga Z. Mladen Mladenov

##### Rreth parimeve ligjore

1. Në përgjithësi, parimet janë **themelore (bazë)** e çdo sistemi (tërësia e elementëve përbërës ndërveprues apo të ndërvarur nga njëri tjetri, të cilët formojnë një të tërë komplekse).
2. Ligji është një **sistem normativ i sjelljes njerëzore** (po ashtu i institucioneve/organizatave).
3. Brenda Ligjit ka **sisteme të ndryshme ligjore**, dhe brenda tyre- **degë të ndryshme ligjore**.
4. Në çdo sistem ligjor modern, e drejta administrative dhe Procedura Administrative përdorin pothuajse të njëjtat parime.
5. **"Efekti Domino"**- Nëse një domino bie, bien të gjitha

##### Neni 4: Parimi i ligjshmërisë

1. Koncepti i ligjshmërisë (i quajtur edhe Ligjshmëria, Sundimi i Ligjit, etj.)
2. Sundimi i Ligjit në Republikën e Shqipërisë- Preambula dhe Neni 4.
3. Traktati i Lisbonës, i cili ka amenduar Traktatin e Bashkimit Evropian dhe Traktatin themelues të Komunitetit Evropian dhe të Sundimit të Ligjit.
4. Rezoluta e Parlamentit Evropian e janarit 2013, me rekomandimet për Komisionin, për Ligjin e Procedurave Administrative të Bashkimit Evropian (2012/2024(INL) – më poshtë referuar si "EPR" dhe parimet e Ligjshmërisë

##### Neni 5: Parimi i transparencës

1. Njohur me emrat: transparent, administrim i mirë, qeverisje e mire, e-qeverisje, akses i publikut tek informacioni, të dhëna të hapura, etj.
2. Çështjet gjyqësore C-39/05 P dhe C-52/05 P, Mbretëria e Suedisë dhe Maurizio Turco kundër Këshillit të Bashkimit Evropian, Vendimi i Gjykatës të Bashkimit Evropian, Luksenburg (Dhoma e Lartë), 1 korrik 2008- "dyshimet në mendjet e qytetarëve jo vetëm në lidhje me ligjshmërinë e një akti të izoluar, por edhe në lidhje me ligjshmërinë e procesit vendim-marrës në tërësi".
3. EPR dhe "Parimi i transparencës" – çon në dokumentimin e procedurave administrative dhe hedhjen e të dhënave të përshtatshme të postës marrëse dhe dërguese, dokumenteve, vendimeve dhe masave të mara.

##### Neni 6: Parimi i informimit

1. "I lidhur ngushtë" me parimin e transparencës. Transparenca është një detyrim për administratën ndërsa informimi është e drejta dhe mundësia e qytetarëve.
2. Rregullojta Nr. 1049/2001 (EC) e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 30 maj 2001, për aksesin e publikut në dokumentacionet e Parlamentit Evropian, Këshillit dhe Komisionit- Më poshtë referuar si "R 1049" – "e drejta e aksesit tek dokumentet e institucioneve".

##### Neni 7: Parimi i mbrojtjes së sekretëve shtetërore

1. Disa informacione që kanë lidhje me sekretet shtetërore, rendin publik ndërkombëtar dhe Evropian duhet të trajtohen me kujdes.
2. R 1049 – Dokumente sensitive që burojnë nga institucionet apo agjencitë e krijuara nga to, vendet e treta apo organizatat ndërkombëtare, të klasifikuara si "Shumë sekret", "Sekret", apo "Konfidencial" në përputhje me rregullat e institucionit, të cilat mbrojnë interesat themelore të Bashkimit Evropian ose të një ose më shumë vendeve anëtare të tij në fushën e sigurisë publike, mbrojtjes dhe çështjeve ushtarake.

## Neni 8: Parimi i mbrojtjes së konfidencialitetit

Direktiva 95/46/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 24 tetor 1995, për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe lëvizjen e lirë:

- Të dhëna mbledhur për një qëllim specifik, të qartë, dhe të ligjshëm, e që nuk do të përdoren më tej për asnjë tjetër qëllim;
- Të përshtatshme dhe jo të tepruara për sa i përket qëllimit për të cilat janë mbledhur;
- Të sakta; hapa të arsyeshëm duhen marrë për të siguruar që të dhëna të pasakta ose të paplota të fshihen ose saktësohen.

## Neni 9: Parimi i mbrojtjes së të dhënave

1. Organi publik ka detyrimin të marrë masa për mbrojtjen, garantimin, mos publikimin dhe konfidencialitetin e tyre në tre dimensione: të dhëna të lidhura me aktivitetin tregtar dhe të dhuna të lidhura me veprimtarinë profesionale.
2. Mbrojtja, garancia, mos bërja publike dhe detyrime konfidenciale, janë të zbatueshme në mënyrë të ngjashme për nëpunësit civilë, gjatë dhe pas punes publike.

## Neni 10 Parimi i ofrimit të ndihmës aktive

1. Detyra procedurale e autoriteteve publike.
2. Kushti procedural "gjithmonë vigjilent".
3. Thelbi i parimit është të siguroje gjithë palët apo personat e tjerët të përfshirë në procedurë janë të aftë të ndjekin dhe mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre legjitimë në mënyrën më efektive dhe të thjeshtë të mundur, si dhe informimi i të gjitha palëve për të drejtat dhe detyrimet, përfshirë gjithë informacionin mbi procedurën dhe t'i paralajmërojë ata mbi efektet ligjore të veprimeve apo mosveprimeve të tyre.

## Neni 11: Parimi i ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit

1. "Diskrecioni administrativ" kundrejt "administratës së kufizuar nga ligji".
2. Vendimi i Gjykatës së Bashkimit Evropian (Dhoma e Lartë) 19 Maj 2009, Komisioni i Komuniteteve Evropiane *kundër* Republikës Italiane, Çështja C-531/06) - Gjatë vlerësimit nëse ky detyrim është përmbushur, duhet të merret parasysh fakti që shëndeti dhe jeta e njerëzve renditen të parët ndër pasuritë dhe interesat e mbrojtura nga Traktati, dhe kjo vlen për Shtetet Anëtare për të përcaktuar nivelin e mbrojtjes që ata dëshirojnë t'i ofrojnë shëndetit publik, dhe mënyrën se si duhet të arrihet ky nivel. Duke qene se niveli mund të ndryshojë nga njëri shtet anëtar tek tjetri, Shteteve Anëtare **duhet tu jepet diskrecion.**

## Neni 12: Parimi i proporcionalitetit

1. Neni 6 i Kodit Evropian për Sjellje të mirë Administrative (**ECGAB**), i miratuar nga Avokati Evropian i Popullit dhe i miratuar nga Parlamenti Evropian më datë 6 Shtator 2001 – zyrtari duhet të sigurojë që **masat e marra janë proporcionale me qëllimin e synuar**, edhe për të shmangur kufizimin e të drejtave të qytetarëve apo vendosjen e tarifave për ta, kur ato nuk janë në një raport të drejtë me qëllimin, si dhe të respektojnë **balancën e drejtë ndërmjet interesave të personave privatë dhe interesit të përgjithshëm publik.**
2. Rezoluta e Parlamentit Evropian (EPR) – nuk duhet të vendosen barra administrative apo ekonomike, që janë të tepruara në lidhje me përfitimet e pritshme.

## Neni 13: Parimi i drejtësisë dhe pa anshmërisë

1. Parimi dy-në-1- paanshmëria dhe drejtësia. EPR mban këtë qëndrim:
  - 2.1. paanshmëria:
    - abstenimi nga çdo veprim arbitrar që ndikon negativisht tek personat, dhe nga çdo trajtim preferencial për çfarëdolloj arsye.

- pavarësia nga çdo interes personal (përfshirë atë financiar), familjar apo kombëtar apo nga presioni politik.
- garanci për një balancë të drejtë ndërmjet llojeve të ndryshme të interesave të qytetarëve (biznesi, konsumatorët dhe të tjerë).

## 2.2. Drejtësia:

- klimë e besimit dhe
- parashikueshmëria në marrëdhëniet ndërmjet individëve dhe administratës.

### Neni 14: Parimi i objektivitetit

1. GjEDNJ, Strasburg, Çështja e Nuutinen *kundër* Finlandës, Aplikimi Nr. 32842/96, Vendimi, 26 Qershor 2000 - "...fakte relevante janë humbur në mënyrë të pakthyeshme në të kaluarën dhe për pasojë nuk janë të detyruara të ndryshojnë. Zgjedhja e normave ligjore të zbatueshme varet në këtë mënyrë nga ngjarje të pandryshueshme të së kaluarës... Një paracaktim i tillë bazuar në ngjarjet e kaluara ... është një **tjetër gur themeli i ligjit të ri.**"
2. Ky parim quhet në legjislacionet vendase si "Parimi i objektivitetit dhe paanshmërisë" apo "Parimi i pavarësisë dhe paanshmërisë" dhe "**ndërvaret me drejtësinë dhe paanshmërinë.**"
3. EPR - administrata abstenson nga çdo veprim arbitrar.

### Neni 15: Parimi i përgjegjesisë

1. I njohur zakonisht si "parimi i llogaridhënies" dhe i manifestuar në përgjegjësinë për dëmin e shkaktuar palëve private gjatë veprimtarive zyrtare
2. Neni 13 nga **Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut** (KEDNJ) parashikon se kushdo të cilin i shkelen të drejtat dhe liritë e parashikuara në këtë Konventë, duhet të kenë një mjet ligjor efektiv përpara një autoriteti kombëtar, pavarësisht faktit që shkelja është kryer nga persona që veprojnë në një kapacitet zyrtar.
3. Neni 41 - "shpërblimi i drejtë" parashikon që nëse gjykata konstaton

se ka pasur një shkelje të Konventës dhe të Protokolleve të saj, dhe nëse ligji i brendshëm i Palës së Lartë Kontraktore përkatëse lejon vetëm kryerjen e një zhdëmtimi të pjesshëm, Gjykata, nëse është e nevojshme, duhet ti japë një shpërblim të drejtë palës së dëmtuar.

### Neni 16: Parimi i vendim-marrjes

1. Baza e krijimit fillestar të administratës publike. Në legjislacionin e Shteteve Anëtare të BE-së ky parim njihet edhe si "Fillimi ex officio" apo "Parimi Ex officio".
2. Për shembull, Kodi Administrativ (i Bullgarisë) në nenin e tij 9 apo "Parimin Ex officio" parashikon që sipas termave të specifikuara në ligj, autoriteti administrativ është i detyruar të iniciojë, zhvillojë dhe përmbyllë procedurën administrative, përveç rasteve kur autoritetit në fjalë i është dhënë kompetenca diskrecionale për të nxjerrë ose jo aktin. Autoriteti administrativ mbledh provat e nevojshme edhe kur palët e interesuara nuk e kanë bërë një kërkesë të tillë. Gjykata udhëzon palët që ato të mos sjellin prova të rrethanave të tilla që kanë lidhje me gjykimin e çështjes. Autoriteti administrativ dhe gjykata bashkëpunojnë proceduralisht me palët për një zgjidhje ligjore konfirmuese dhe të drejtë të çështjes e cila është objekt e procedurës, përfshirë një zgjidhjen me marrëveshje.

### Neni 17: Parimi i barazisë dhe mos diskriminimit

1. Ky parim ka dy dimensione - **substancial (material) dhe procedural**. I pari- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në nenin e saj 18 deklaron se **të gjithë janë të barabartë përpara ligjit**. Preambula e Traktatit të Lisbonës- "vlerat universale... **barazia dhe sundimi i ligjit**". Neni 1 nga Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut nga Kombet e Bashkuara- "të gjitha qeniet njerëzore lindin të lira dhe **të barabarta në dinjitet dhe të drejta**". Neni 5 "Mos diskriminimi" nga ECGAB - **barazia në trajnim**. EPR - "persona që janë në situata të ngjashme do të trajtohen në të njëjtën mënyrë."
2. Dimensionin i dytë (procedural) - Çështja e Krcmar dhe të tjerë kundër Republikës Ceke, GjEDNJ, Vendimi, 3 Mars 2000 - "Parimi i

**barazisë së armëve**, që është një nga elementët e konceptit më të gjerë të një gjykimi të drejtë, kërkon që çdo pale t'i jepet mundësi e arsyeshme për të paraqitur çështjen e saj në bazë të kushteve që nuk e vënë atë në një disavantazh thelbësor në raport me kundërshtarin e saj.

### Neni 18: Parimi i de-burokratizimit dhe efikasitetit

ECGAB parashikon parimin e "Respektit për të tjerët", kur nëpunësit civil duhet :

- Të veprojnë me respekt me njeri tjetrin dhe me qytetarët,
- Të jenë të sjellshëm,
- Të jenë ndihmues,
- Të jenë në kohë,
- Të jenë bashkëpunues,
- Të bëjnë përpjekje reale të kuptojnë se çfarë po thonë të tjerët,
- Të shprehen në mënyrë të qartë,
- Të përdorin gjuhë të thjeshtë.

### Neni 19: Parimi i mospagimit në procedurat administrative

1. Si rregull, të gjitha procedurat administrative në të gjitha institucionet janë pa pagesë. Shpjegimi për personat privatë (qytetarët dhe personat juridikë) që ato kanë paguar tashmë ekzistencën dhe veprimtarinë e administratave qeveritare nëpërmjet taksave të tyre. Shpjegimi për entitetet publike është që buxheti i tyre është i njëjtë me buxhetin e institucionit, që drejton procedurën në disa raste.
2. Si pjesë e politikës sociale të shtetit, nëse palët nuk janë në gjendje të paguajnë, ato duhet të mos kenë pagesa për çështje konkrete. Kushtet për një trajtim të tillë janë në Vendimin e Këshillit të Ministrave, i cili tregon kategoritë që plotësojnë kushtet e pamundësisë për të pagur tarifat për procedurën administrative.

### Neni 20: Gjuha dhe përkthimi në procedurën administrative

1. Neni 14, Pika 1 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë: Gjuha zyrtare në Republikën e Shqipërisë është shqipja.
2. Ideja e "një gjuhe të thjeshtë/ të kuptueshme /të aksesueshme".
3. Udhëzues i përbashkët praktik për personat e përfshirë në hartimin e legjislacionit të Bashkimit Evropian (miratuar nga Kuvendi Evropian, Këshilli dhe Komisioni, 22 Dhjetor 1998). Edhe pse ka të bëjë me procedurat legjislativë, dispozita e saj është një shembull i mirë për sjelljen e autoriteteve publike ndaj qytetarëve: terma të thjeshta, koncepte të thjeshta, gjuha e përditshme. Nëse një fjalë ka një kuptim në gjuhën e përditshme apo në gjuhën teknike por një kuptim të ndryshëm në gjuhën ligjore, fraza duhet të riformulohet në mënyrë të tillë që të shmanget çdo dykuptimësi.
4. Konkluzioni duhet të jetë- gjuha në procedurën administrative duhet të jetë një gjuhë kushtetuese (administrative), e përditshme dhe me më pak zhargon.

### Neni 21 Parimi i kontrollit

1. Neni 6, pika 1 nga Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut - në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tija civile apo te ndonjë akuze penale kundër tij, të gjithë kanë të drejtë për të pasur një **dëgjim të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme** e krijuar me ligj.
2. Rekomandimi 5 (për rishikimin dhe korrigjimin e vendimeve të veta) nga EPR - mundësia për administratën **për të korrigjuar gabimet në çdo kohë** me iniciativën e vetë apo me kërkesë.
3. Pjesa III "Tipare të veçanta të çdo mjeti alternativ", Seksion 1 nga Rekomandimi Rec (2001)9 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për Shtetet Anëtare për alternativat për zgjidhjen e mosmarrëveshjet ndërmjet autoriteteve administrative dhe palëve private - **rishikimet e brendshme** duhet të shqyrtohen dhe të vendosen nga autoritetet kompetente.

## Delegimi i kompetencës/ Njësia përgjegjëse

**Dokumenti 1: udhëzuesi i delegimit të kompetencave për organet publike**  
**Emri i ekspertit: Z. Timothee Paris, Z. Pierre Calzat dhe Z. Giancarlo DeFazio**



Kontrata e Projektit të Binjakëzimit  
"Mbështetje për Reformën e Shërbimit Civil në Shqipëri"

### Udhëzuesi i ministrive dhe organeve publike për zbatimin e delegimit të kompetencave

#### Shënim paraprak

Këto udhëzime janë hartuar për të ndihmuar ministrinë dhe organet publike në zbatimin praktik të dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative mbi delegimin e kompetencave.

Nenet 28 dhe 29 të Kodit të ri të Procedurës Administrative (delegimi i kompetencave) si dhe neni 43 i po këtij kodi (njësia përgjegjëse dhe zyrtari përgjegjës) në parim i bëjnë të mundur çdo organi publik dhe çdo Ministri të delegojë kompetencat, me disa kushte, tek organe të tjera ose organe vartëse.

Nenet 3 dhe 11 të Ligjit nr. 90/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", ku thuhet se administrata shtetërore do të organizohet dhe funksionon sipas parimeve të unitetit, hierarkisë dhe dekoncentrimit dhe se Ministri mund të delegojë autoritetin e tyre tek funksionarët politikë dhe nëpunësit civilë të nivelit të lartë për të kryer

detyrat funksionale, janë plotësisht në përputhje me këtë parim. Përveç kësaj, duhet të respektoni edhe ligjet e posaçme që rregullojnë ministrinë tuaja, kur ligje të tilla ekzistojnë.

#### Fusha e zbatimit

##### **Administrata qendrore shtetërore, organet e dekoncentruara**

Këto udhëzime zbatohen për administratën qendrore shtetërore dhe administratën e dekoncentruar shtetërore, siç përcaktohet në ligjin nr. 90/2012. Institucionet e varësisë të përcaktuara në nenin 6 të Ligjit nr. 90/2012 bashkë me degët e tyre në territor si dhe prefektët konsiderohen si organe të administratës shtetërore qendrore ose administrata të dekoncentruara.

Agjencitë e pavarura, të përcaktuara në Ligjin nr. 90/2012 seksioni 4, mund t'i referohen këtyre udhëzimeve.

##### **Përkufizimet: "Delegimi i kompetencave", "zëvendësimi i kompetencave" dhe shpërndarje e kompetencave**

Në Kodin e Procedurës Administrative dy nene të ndryshme i referohen procedurave që çojnë në përcaktimin e një personi tjetër, nga autoriteti përgjegjës, për të kryer kompetencat që i janë caktuar atij.

- Neni 28, nën titullin "*Delegimi i kompetencave dhe zëvendësimi i tyre*" ku thuhet se "1. *Organet publike kompetente mund të delegojnë kompetencat e tyre ligjore te një organ tjetër publik. (...)*" Neni 29 përcakton procedurën për të kryer këtë delegim.
- Neni 43, nën titullin "Parashikime të përgjithshme mbi procedurën administrative", ku thuhet "1. *Në një procedurë administrative, të filluar sipas parashikimeve të nenit 41, të këtij Kodi, organi publik vepron nëpërmjet nëpunësit përgjegjës, të përcaktuar sipas rregullave të këtij neni (...)* 3. (...) *Nëpunësi përgjegjës zhvillon procedurën administrative dhe në përfundim propozon me shkrim*



*vendimin përfundimtar, ndërsa vendimi merret dhe nënshkruhet nga personi i përcaktuar nga ligji ose aktet nënligjore. (...) 4. N ë rastet e parashikuara nga ligji nëpunësi përgjegjës, pasi zhvillon procedurën administrative, vendos për çështjen me vendim përfundimtar dhe e nënshkruan atë (...).“.*

Bazuar në formulimin e këtyre neneve, në titujt e krerëve nën të cilët ata vendosen, në përmbajtjen e neneve para ose pas tyre dhe në parimet e Ligjit për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore, identifikohen tre lloje të ndryshme transferimi kompetencash.

## 1. Delegimi i kompetencave

Neni 28 i KPA-së u lejon organeve publike të delegojnë kompetencat e tyre. Nocioni i “organeve publike” duhet të kuptohet i mbuluar si nga organet publike ashtu edhe nga personat që kryejnë një autoritet publik p.sh Ministri. Kjo do të thotë se sipas nenit 28, kompetencat mund të delegohen ose tek nëpunësit / institucionet publike të varësisë ose tek një institucion tjetër publik (jo i varësisë). Me fjalë të tjera, **neni 28 lidhet me delegimin ndërmjet organeve publike dhe brenda vetë organeve publike.**

Në këtë rast, ndarja e kompetencave ndryshohet (delegimi i kompetencave mund të krahasohet me atë që në Francë quhet “delegimi i pushtetit”): kompetencat e përmendura në delegim transferohen plotësisht tek organi ose personi tjetër publik, për kohëzgjatjen specifike të përmendur në delegim. Përgjegjësia kalon nga autoriteti delegues, i cili nuk mund ta ushtrojë më atë, tek autoriteti i deleguar. Për shembull, Ministri mund të delegojë kompetencën e tij mbi burimet njerëzore tek drejtori i departamentit të burimeve. Vetëm drejtori pastaj mund të ushtrojë kompetencat e deleguara, të tilla si të emërojë nëpunës publikë ose të vendosë sanksione mbi ta.

Delegime të tilla duhet të parashikohen me ligj. Nëse ligji nuk i parashikon, delegimi nuk lejohet: vetëm personi i caktuar me ligj ose akt nënligjor si personi zakonisht përgjegjës për të ushtruar kompetencat, do të jetë

ligjërisht në gjendje të nënshkruajë vendimet dhe të marrë vendimin përfundimtar. Vini re se kjo nuk pengon mundësinë e atij personi për të shpërndarë tek personat e tjerë të gjithë procesin e përgatitjes së vendimit, duke përfshirë masat përgatitore (procedurën, të drejtën për t'u dëgjuar ...).

Përveç kësaj, sipas nenit 28 të Kodit, kompetencat e mbajtura sipas ligjeve ose akteve nënligjore mund t'u transferohen organeve të varësisë. *Vini re se vetëm kompetencat e dhëna nga ligjet - por jo nga aktet nënligjore - mund të delegohen tek një organ tjetër publik (jo i varësisë).*

## 2. Zëvendësimi i kompetencave

Zëvendësimi i kompetencave i referohet rastit kur një organ publik (organi publik ose personi i cili kryen një autoritet publik) delegon tek një organ tjetër (zakonisht një person vartës) mundësinë për të nënshkruar një vendim në emrin e tij kur ai nuk është në gjendje të nënshkruajë (për shkak mungese të përkohshme për shembull). Në këtë rast, kompetenca i mbetet autoritetit delegues. Ai shkarkon veten nga një detyrë e caktuar, pa hequr dorë nga kompetencat e tij. Përgjegjësia mbetet në nivelin e tij. Ky autoritet mund të ushtrojë nënshkrimin në çdo kohë. Zyrtari i cili merr kompetencën e deleguar nënshkruan për autoritetin delegues, i cili mund të ushtrojë vetë kompetencën e deleguar, pavarësisht nga vendimi i delegimit. Në vende të tjera zëvendësimi i kompetencave nganjëherë quhet “delegim i nënshkrimit”.

Një titull kreu në KPA e përmend nocionin e “zëvendësimit të kompetencave”, **por KPA nuk përmban asnjë dispozitë për “zëvendësimin e kompetencave”.**

**Kini parasysh se për rrjedhojë, zëvendësimi i kompetencave nuk ndalohet shprehimisht.** Në fakt, këto zëvendësime janë në disa raste të përmendura nga ligje të posaçme. Kur ka delegim të tillë, respektohen parimet e përgjithshme mbi delegimet / zëvendësimet (të jenë të sakta, për një kohëzgjatje të caktuar, të publikohen ...).

### 3. Shpërndarja e kompetencave

Nocioni i "shpërndarjes së kompetencave" nuk përmendet në mënyrë të qartë në KPA, pasi nuk ka nevojë për dispozita specifike ligjore. Ai i referohet mundësisë që ka drejtuesi i një njësie për të shpërndarë përgjegjësitë gjatë përgatitjes së veprimeve administrative (akte administrative ose kontakte për shembull) tek vartësit e tij. Kjo fuqi rrjedh nga parimet e përgjithshme të hierarkisë dhe dekoncentrimit.

**Shpërndarja e kompetencave gjithmonë është e lejuar** dhe në parim nuk ka nevojë për akt të veçantë, përveç rasteve të përmendura në KPA ose në ligjet e posaçme. Nëse shpërndarja e kompetencave nuk shoqërohet me delegim ose zëvendësim të kompetencës, autoriteti i përmendur nga ligjet ose aktet nënligjore do të jetë i vetmi ligjërishit i aftë të nënshkruajë ose të marrë vendimin përfundimtar. Por, i gjithë procesi i përgatitjes mund të kryhet nga nëpunës / shërbime vartëse.

Vini re se kur nga procesi lind një veprim administrativ në kuptim të KPA-së (akt administrativ, kontratë administrative ose ndonjë veprim administrativ i njëanshëm që ka efekt mbi të drejtat subjektive), neni 43 i KPA-së kërkon që njësia përgjegjëse për ushtrimin e kompetencës duhet të përmendet shprehimisht dhe zyrtarisht. Prandaj, duhet të merret një akt formal. Neni 43 gjithashtu i lejon drejtuesit të njësive përgjegjëse të shpërndajë ushtrimin e procedurës tek nëpunësit vartës.

Neni 43 gjithashtu i lejon personit normalisht përgjegjës të përmendur në ligje ose në aktet nënligjore t'ia delegojë fuqinë për të nënshkruar vendimin përfundimtar personit përgjegjës për kryerjen e procedurës. Në këtë rast, kemi të bëjmë me një delegim të kompetencave siç përmendet në nenin 28. Do të respektohen të gjitha kushtet e përmendura në nenet 28 dhe 29.

#### **Pasojat për mosrespektimin e dispozitave të kodit:**

Nëse një veprim administrativ (vendim ose kontratë) nënshkruhet nga

një organ i varur ose një organ i ndryshëm nga ai i përmendur në ligjet ose aktet nënligjore si organi me kompetencat normale, pa pasur një delegim të rregullt të nënshkrimit (ose zëvendësim), kjo ndikon në kompetencën e autorit të vendimit.

Për pasojë, akti administrativ ose kontrata konsiderohen si të paligjshme në kuptim të nenit 109 të KPA-së. Prandaj, akti mund të anulohet nga organi i apelit ose nga gjyqtari administrativ

#### **Kushtet për zbatimin e delegimit**

##### **a) Me ose pa ligj të posaçëm**

Mos harroni t'i kushtoni vëmendje të veçantë ligjeve të posaçme që kanë të bëjnë me ministrinë dhe organet publike, të cilat vendosin kufij dhe saktësime në lidhje me kompetencat që mund të delegohen në çdo nivel.

**Mungesa e ligjeve të posaçme ose, në ligje të tilla, i dispozitave specifike në lidhje me delegimin e kompetencave, nuk e pengon procesin e delegimit, me kusht që të respektohen kushtet e parashikuara në nenet 28, 29 dhe 43 (nëse është rasti)..**

Në një situatë të tillë, mund të zbatohet drejtpërsëdrejti parimi i parashikuar në Kodin e Procedurës Administrative. Çdo ministër ose kryetar i organit publik do të përcaktojë fushën e delegimeve të marra sipas parimeve të nenëve 22, 28 dhe 29 të KPA-së..

##### **b) Fusha e delegimit**

Në aktin e delegimit të kompetencave (ose i zëvendësimit kur autorizohet nga ligjet e posaçme) duhet të përmenden shprehimisht:

- a) kompetencat e deleguara;
- b) financimi i detyrave të deleguara;
- c) institucioni i ngarkuar me mbikëqyrjen, si dhe objekti e instrumentet e mbikëqyrjes;
- ç) kriteret e ndërprerjes dhe mekanizmat për kryerjen e detyrave të

deleguara, në rast të ndërprerjes së delegimit;  
d) datën e fillimit të ushtrimit kompetencave të deleguara

Cilido qoftë pozicioni juaj në administratën shtetërore, jeni caktuar të ushtroni detyrat e përcaktuara në misionin tuaj. Procedura e delegimit do të konsiderohet si një mjet efikasiteti administrativ. Mund të delegoni vetëm një pjesë të kompetencave tuaja, të përcaktuara me ligje dhe rregullore dhe, në çdo rast, duhet të mbikëqyrni ushtrimin e kompetencave të deleguara në parim, sipas parimit të hierarkisë.

Për një zbatim të mirë të delegimit të kompetencave, si autoritet delegues do të nxirri udhëzime për ekzekutimin e kompetencave të deleguara, që janë detyruese për organet e deleguara.

Kur është rasti, në rast kompetencash që duhet të delegohen në mënyrë të përsëritur, autoriteti delegues miraton aktin e delegimit për të gjithë kategorinë e kompetencave, në vend që të miratojë aktet rast pas rasti. Kategoria duhet të përcaktohet me saktësi të mjaftueshme.

Për më tepër, akti i delegimit përmban një detyrim specifik të autoritetit të deleguar për të raportuar në mënyrë periodike tek autoriteti delegues për ushtrimin konkret të kompetencave të deleguara.

### **c) Publikimi**

Duket se shumë delegime nuk janë publikuar.

Por, sipas neneve 98 dhe 99 të KPA-së, delegimet duhet të publikohen në Fletoren Zyrtare. Kjo procedurë është e detyrueshme edhe për organet e dekoncentruara dhe njësitë e qeverisjes vendore, në fletoret zyrtare vendore përkatëse.

Asnjë akt nuk duhet marrë nga autoriteti marrës para publikimit në Fletoren Zyrtare.

Përveç detyrimit për publikimin e akteve të delegimit në fletoret

zyrtare, dhe me qëllim përforcimin e transparencës dhe efikasitetit të veprimtarisë administrative, mund të parashikohet të përgjithësohet publikimi i akteve të delegimit në faqen institucionale të internetit të administratës së interesuar.

### **d) Arsytimi dhe miratimi**

Për të qenë të harmonizuar, vendimet e delegimeve të kompetencave duhet të miratohen në formë të shkruar dhe me kushte të ngjashme.

Vendimet duhet të përmendin:

Nenet 28, 29 dhe/ose 43 të KPA-së;

Ligjet dhe aktet nënligjore të cilat rregullojnë ministrinë;

emrat e saktë të organeve administrative, të autoritetit delegues, të autoritetit të deleguar. Mund të jetë emri i institucionit në rastin e delegimit të kompetencave; në rastin e delegimit të nënshkrimit do të jetë emri i nëpunësit civil.

Në bazë të nenit 22 të Kodit, delegimi mund të bëhet vetëm nëse parashikohet shprehimisht me ligj dhe vetëm nëse ligji ka specifikuar organin ose zyrtarin të cilit i bëhet delegimi. Prandaj duhet të verifikoni në ligjin e posaçëm që organizon administratën e institucionit suaj, se cilit organ mund t'i delegoni kompetencat (kur ekziston një ligj i tillë).

Në ushtrimin e kompetencave të marra nga delegimi, organi i deleguar duhet të përmendë organin delegues dhe burimin ligjor sipas të cilit është miratuar akti i delegimit, sipas parimit të arsytimit të akteve administrative.

Përveç rasteve të emergjencës, nuk mund të vendosni delegimin e kompetencave pa u mbështetur në një bazë të saktë ligjore ose rregullatore.

Në respekt të dispozitave të nenit 22 të Kodit, dhe për të siguruar një siguri juridike të rreptë në aktet që do të ndërmerri, duhet të verifikoni në ligjet që rregullojnë drejtpërdrejt ministrinë tuaj, në ligjet që përmbajnë dispozita për organizimin e administratës së ministrisë ose në ligjet e përgjithshme që përcaktojnë kompetencën e ushtruar nga

ministra, në të cilat përcaktohet kuadri dhe fushëveprimi i delegimit. Nëse ligjet nuk përmbajnë dispozita të tilla, ose nëse një dispozitë ligjore dukshëm e ndalon delegimin, ky vendim do të jetë i paligjshëm. Nevoja urgjente për autorizim me ligj përsëritet në dy nenet 22, 29 dhe 43 të KPA-së. Megjithatë, siç është thënë më lart në rast se nuk ka ligj të posaçëm, mund të aplikoni drejtpërdrejt parimin e delegimit.

Për çdo person të deleguar duhet të jepen titulli, emri, mbiemri, statusi dhe funksioni sipas të cilit i është dhënë delegimi.

#### **e) Formular shtesë**

Ligji nr. 90/2012 për organizimin e administratës shtetërore përcakton parimin e hierarkisë. Në përputhje me këtë parim, delegimi nuk mund të refuzohet nga autoriteti i propozuar si i deleguar pasi delegimi është detyrë e nëpunësve civilë. Megjithatë, për të përforcuar njohjen e plotë të përgjegjësisë, mund të bashkëngjitet një formular për njohjen e përgjegjësisë i cili të bashkë firmoset nga autoriteti i deleguar.

#### **f) Revokimi**

Edhe nëse nuk ka ndonjë dispozitë në Kodi për revokimin e vendimeve të delegimit, prapë mund të bëjmë saktësim.

Delegimi i kompetencës, p.sh teorikisht delegimi i dhënë një autoriteti administrativ të përcaktuar me ligj ose rregullore, ka efekt të përhershëm në kuadrin e qëndrueshmërisë juridike, në qëndrueshmërinë e institucioneve dhe atë të ligjit. Delegimi është thelbësor për funksionin e ushtruar nga i deleguari. Delegimi nuk mund të merret mbrapsht, thjesht revokohet i deleguari.

Delegimi i nënshkrimit i jepet një autoriteti të identifikuar dhe të emërtuar. Për këtë arsye, në këtë situatë, delegimi mund të ndërpritet nga autoriteti delegues me revokim të aktit të delegimit ose me përfundimin apo kryerjen e detyrave, si dhe me shuarjen e organit delegues ose të organit të deleguar.

#### **g) Nëndelegimi**

Ligji në fuqi, veçanërisht neni 28 i KPA-së i ndalon rreptësisht një organi vartës, i cili merr nga ana juaj një delegim kompetence, ta delegojë këtë kompetencë tek një autoritet i tretë.

#### **Shtojca 1: 3 shembuj delegimi kompetencash**

##### **Shënim: shembujt janë marrë nga administrata franceze dhe ajo italiane**

##### **Shembulli 1: delegimi i kompetencave në nivel ministrie**

Ministria e .....

(Drejtoria e .....) )

Vendim DD/MM/VVVV..... për delegimin e nënshkrimit

Drejtori (apo autoritet tjetër i veshur me kompetencë ....., Duke marrë parasysh Vendimin numër ..... DD/MM/VVVV për organizimin e brendshëm të administratës qendrorë të Ministrisë së .....

Duke pasur parasysh rregulloren për organizimin e brendshëm të zyrës në të cilën është i punësuar i deleguari ... ,

Vendosa :

Neni 1

Delegimi i jepet Z. X, për të ushtruar të gjitha veprimet administrative, duke përfshirë nënshkrimin e vendimeve administrative dhe kontratave në fushat e përmendura në nenin 2.....

Neni 2

Delegimi i jepet Znj. Y, për të ushtruar kompetencat e Ministrit të .....  
përmendet këtu ..... : përmbledhja e titujve dhe dokumenteve që lidhen me .....

Neni 3

Ky Vendim do të botohet në Gazetën Zyrtare të Republikës.

Më DD/MM/VVVV

Ministri i....

### **Shembulli 2: delegimi i nënshkrimit nga Prefekti**

DD/MM/VVVV

Qyteti

Vendim i DD/MM/VVVV.....për delegimin e nënshkrimit nga  
Prefekti i ... tek Z. X

TPrefekti i .....

Duke pasur parasysh Kodin e Mbrojtjes

Duke pasur parasysh Kodin e Punëve të Brendshme

Duke pasur parasysh Kodin e Punës,

Duke pasur parasysh Kodin e qeverisjes vendore,

Duke pasur parasysh Ligjin për sigurinë e brendshme

Duke pasur parasysh Ligjin për zjarret dhe shërbimet e shpëtimit

Duke pasur parasysh Ligjin...

Duke pasur parasysh VKM për kompetencat e prefektit

Duke pasur parasysh VKM për...

Duke pasur parasysh VKM për emërimin e Z. Y , Prefekt i

Duke pasur parasysh Vendimin për emërimin e Z. X si....

Vendosa :

Neni 1

Delegimi i jepet Z. X, për të ushtruar të gjitha veprimet administrative,  
duke përfshirë nënshkrimin e vendimeve dhe kontratave administrative,  
në çështjet me interes për menaxhimin dhe kontrollin e shërbimeve  
policore.

Neni 2

Z. X është i autorizuar të nënshkruajë të gjitha aktet dhe vendimet në  
fushat e mëposhtme:

Mirëmbajtja e rendit,

Ndalimi i demonstratave,

Përdorimi i zbatimit të ligjit

Drejtimi i personelit

...

Neni 3

Ky vendim do të publikohet në buletinin e akteve publike të  
Departamentit të ...

Z. X

Prefekt i...

### **Shembull 3: delegimi i kompetencave tek një organ publik tjetër**

DD/MM/VVVV

Qyteti

Vendim i DD/MM/VVVV..... për delegimin e kompetencave nga Kryetari i Bashkisë së..... tek Z. X, Zv/Kryetari i Bashkisë së...

Në mbështetje të neneve 28, 29 dhe 43 të Kodit të Procedurave Administrative

Në mbështetje të ligjit për Qeverisjen vendore, posaçërisht nenet XXX

Në mbështetje të Ligjit nr. XXX, posaçërisht nenet XXX që u lejojnë kryetarëve të bashkive të delegojnë kompetenca, përfshirë kompetencat për të kryer veprime administrative tek zëvendës/kryetarët e bashkive ...

Në mbështetje të neneve XX të statutit të Bashkisë

Duke patur parasysh rezultatin e zgjedhjeve të XXX

Vendosa:

Neni 1: Kompetencat për ushtrimin e veprimeve administrative në fushën e punëve publike, trafikut, lëvizshmërisë dhe parkimit, i delegohen Znj. X, Zv/kryetare e Bashkisë deri më.....DD/MM/VVVV.

## Dokumenti 2: Materiale shpjeguese për nenin 43 Të Kodit të Procedurave Administrative Nga Zj. Urszula Kulisiewicz

### I. Hyrje

Si Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian miratuar në dhjetor 2000, ashtu dhe Kodi Evropian i Sjelljes së Mirë Administrative (këtu e më poshtë KESMA) njohin si një nga parimet të drejtën për administrim të mirë. Kjo nënkupton se çdo qytetar ka të drejtën që çështja e tij të shqyrtohet në mënyrë të drejtë nga organi ose institucioni para të cilit është paraqitur, sipas ligjit dhe pa vonesa të panevojshme. Megjithëse ligji i Bashkimit Evropian nuk rregullon organizimin e administratave publike të Shteteve Anëtare, sot vërehet se fenomeni i konvergencës po sjell zgjidhje të përbashkëta ose të ngjashme administrative (Dr. Barbara Kowalczyk, *"Evropianizimi i administratës dhe e drejta evropiane"*, SPAP, 2015/2016). Për pasojë, nuk ekziston një model unik ose universal procedure administrative. Thënë kjo, një grup profesorësh nga universitete të ndryshme evropiane (ReNEUAL - Rrjeti Hulumtues për të Drejtën Administrative të BE-së) ka krijuar një model të Kodit të Procedurave Administrative për administratën e BE-së, ku gjejmë një dispozitë të ngjashme me nenin 43 për "Nëpunësin Përgjegjës".

### II. Parimet e përgjithshme

Baza ligjore për vendimet administrative vjen nga e drejta e përgjithshme materiale. Përgjegjësia e organit të administratës publike qëndron në dhënie të vendimit, sa herë që kjo administratë ka vendosur arbitrarisht për të drejtat ose detyrimet e personit në bazë të dispozitave të së drejtës materiale. Vendimi - që të ketë efekte në të gjitha veprimet ligjore - duhet të përputhet me kërkesat formale të rregullave të institucionit. Në momentin e lëshimit, ky akt i nënshtrohet kërkesave të ligjit administrativ. Parimi i autoritetit kërkon që rastet t'i nënshtrohen autoritetit kompetent në përputhje me ligjin.

Elementët e detyrueshëm të vendimit janë, ndër të tjera, përcaktimi i autoritetit që lëshon vendimin dhe nënshkrimi i një personi të autorizuar për të përfaqësuar organin (emri dhe mbiemri) dhe pozicioni i tij i punës. Kur vendimi lëshohet nga organi kolektiv, të gjithë anëtarët e tij duhet të nënshkruajnë. Forma e delegimit të kompetencës si dëshmi dhe garanci për verifikimin e delegimit të duhur për të nxjerrë një vendim administrativ. Delegimi kërkon formë të shkruar ku të përmenden data e përfundimit, fusha e delegimit dhe periudha e caktuar kohore. Parimet më të rëndësishme janë vazhdimësia e procedurës administrative dhe stabiliteti i organeve publike. Kjo do të thotë që edhe pse një person që përmbush detyrat në një pozitë të caktuar mund të ndryshojë, vetë organi mbetet i njëjtë, i pandryshuar.

Ligji evropian sugjeron që standardet e përgjithshme të kësaj procedure, p.sh. neni 14 paragrafi 2 i KESMA për përgjigjen ose konfirmimin e marrjes (së një letre apo ankese), duhet të tregojnë emrin, pozicionin dhe numrin e telefonit të zyrtarit i cili është përgjegjës për rastin. Neni i analizuar 43 i Kodit të Procedurave Administrative bazohet në parimin e lartpërmendur të administrimit të mirë dhe është pjesë e kapitullit II "Dispozitat e përgjithshme për procedimin administrativ".

### III. Neni 43

Njësia dhe nëpunësi përgjegjës

1. Në një procedurë administrative, të nisur sipas dispozitave të nenit 41 të këtij Kodi (kryesisht apo me kërkesë), organi publik vepron nëpërmjet nëpunësit përgjegjës të caktuar sipas rregullave të këtij neni.
2. Përveç rastit ku ka dispozita kundërshtuese ligjore ose nënligjore, kreu i organit publik përcakton paraprakisht njësinë përgjegjëse për çdo lloj procedure administrative në kompetencë të organit, në përputhje me rregullat e brendshme të veprimtarisë së tij. Ky vendim do të bëhet publik me çdo mjet të përshtatshëm.
3. Kreu i njësisë përgjegjëse, duhet të marrë vetë përsipër ose të caktojë me akt të shkruar, nëpunësin përgjegjës për zhvillimin e procedurës administrative. Nëpunësi përgjegjës kryen procedurën

administrative dhe në fund propozon me shkrim vendimin përfundimtar, ndërsa vendimi miratohet dhe nënshkruhet nga personi i caktuar me ligj ose akt nënligjor. Nëse vendimi është i ndryshëm nga ai i propozuari, arsytet duhet të bëhen shprehimisht të qarta.

4. Në rastet e parashikuara me ligj, pas zbatimit të procedurës administrative, nëpunësi përgjegjës jep vendimin përfundimtar dhe e nënshkruan, me përjashtim të rasteve kur ligji e parashikon ndryshe.
5. Organi kolegjal mund të caktojë një nga anëtarët e tij për të kryer veprimet procedurale administrative. Në këtë rast, anëtari i caktuar do ta informojë organin për rezultatet e procedurës administrative. Organi do të marrë vendim mbi këtë rezultat.

#### **IV. Interpretimi i nenit 43**

Detyrimi i përgjithshëm i autoritetit publik është që çdo organ publik të veprojë përmes punonjësve të identifikuar nga njësitë e caktuara kur fillohet procedura administrative. Kjo do të thotë që çdo organ publik duhet të caktojë një nëpunës përgjegjës për t'u marrë me secilin rast. Mund të jetë kreu i njësisë përgjegjëse ose një punonjësi tjetër i caktuar me shkrim. Ky punonjës kryen procedurën sipas të gjitha dispozitave ligjore dhe mban të gjitha të dhënat e lidhura me të. Një delegim i tillë bën të mundur kryerjen e procedurës dhe propozimin e vendimit përfundimtar, i cili mund të miratohet dhe të nënshkruhet nga një person tjetër i autorizuar. Në disa raste (të parashikuara nga ligji), nëpunësi përgjegjës mund të vendosë dhe të nënshkruajë vendimin përfundimtar.

Së pari, njësia përgjegjëse caktohet për rastet që lidhen me të sipas kompetencës të secilit organ publik. Emërimi duhet të shpallet publikisht me legjislacion të veçantë ose të caktohet nga autoriteti publik në përputhje me kompetencat e tij (rregullat e brendshme të veprimtarisë së tij), p.sh. në aktet nënligjore të tij të botuara në buletin ligjor ose në faqen zyrtare të institucionit. Ideja kryesore është që caktimi i njësisë përgjegjëse duhet të bëhet paraprakisht, përpara se të përpunohen rastet administrative. Ky mund të jetë një departament, një sektor, një zyrë e specializuar e autoritetit. Ky detyrim garanton stabilitet në ndarjen

e kompetencave dhe kundërveprimeve, e kundërta e vlerësimit rast pas rasti. Secili qytetar ka të drejtë të marrë dijeni sa më shpejt të jetë e mundur për njësinë përgjegjëse që do trajtojë rastin e tij..

Hapi tjetër është emërimi i nëpunësit përgjegjës për udhëheqjen e procedurës administrative. Ky nëpunës mund të jetë kreu i njësisë ose i një punonjës tjetër i caktuar me akt të shkruar. Kjo do të thotë që kreu i njësisë duhet të vendosë nëse do ta mbajë kompetencën e zyrarit përgjegjës për vete apo do ta delegojë tek një punonjës vartës i përzgjedhur.

Kjo dispozitë e bën procesin e administrimit më të lehtë dhe lejon përfshirjen e të gjithë nëpunësve në çështjet administrative. Ky delegim duhet të bëhet në formë të shkruar veçmas për çdo rast, qoftë edhe me shënim dore në ballinën e një dokumenti që e fillon procedurën. Delegimi mbron ndarjen e funksioneve, siguron vijueshmërinë dhe parashikueshmërinë e procedurës administrative.

Detyra kryesore e nëpunësit përgjegjës (sipas nenit. 43 paragrafi 3 ) është të kryejë procedurën administrative dhe të propozojë me shkrim vendimin përfundimtar. Vendimi mund të miratohet dhe të nënshkruhet nga një person tjetër i caktuar me ligj ose akt nënligjor. Kjo do të thotë që nëpunësi përgjegjës është përgjegjës vetëm për ato faza të procedurës administrative që çojnë në vendimin përfundimtar, por ai / ajo nuk është kompetent për të marrë vendimin. Kjo dispozitë ndan qartë dy role në procesin e vendimmarrjes. Personi i autorizuar (i autorizuar nga legjislacioni parësor ose dytësor) duhet të marrë vendimin përfundimtar pas marrjes së një propozimi me shkrim të nëpunësit përgjegjës, por ai nuk kufizohet nga ky projekt-vendim. Nëse vendimi është i ndryshëm nga projekti i propozuar, personi i autorizuar duhet të shpjegojë arsytet. Neni 43 dallon edhe llojin tjetër të nëpunësit përgjegjës, i cili është përgjegjës për të gjithë procedurën administrative, përfshirë edhe miratimin e vendimit përfundimtar, por vetëm në rastet e parashikuara me ligj (paragrafi 4).

Në rastin e organit kolegjal administrativ, i tërë organi duhet të marrë vendim për rastin. Ky është një vendim i përbashkët dhe duhet të



zbatohen rregullat e sistemit të votimit me shumicë p.sh. një anëtar i organit kolegjal është kundër vendimit, ndërsa shumica e anëtarëve janë pro dhe vendimi miratohet. Ky anëtar duhet të ketë të drejtën të përgatisë një opinion të kundërt. Një qasje e tillë është e rëndësishme nën dritën e përgjegjësisë për vendimet administrative. Ligji lejon që një nga anëtarët e organit kolegjal të caktohet për të kryer veprimet procedurale administrative. Në këtë rast, anëtari i caktuar duhet të informojë organin kolegjal mbi rezultatet e procedurës administrative, por vendimi nënshkruhet nga të gjithë anëtarët.

## Përgatitja e akteve administrative

### Dokumenti 1: Të drejtat e palëve gjatë procedurës administrative (nivel fillestar/ i avancuar) Emri i ekspertit: Z. Mladen Mladenov

#### Neni 45 E drejta e palëve për tu njohur me dosjen - I

1. E drejta për tu njohur me dokumentet e dosjes të një procedure të tillë dhe marrja e një kopje të tyre është një e drejtë procedurale bazë për çdo pjesëmarrës në çdo proces ligjor formal, përfshirë procedurën administrative.
1. Organi publik siguron në mjediset e tij të punës kushte për ruajtjen e të dhënave, kushte për njohjen me dhe marrjen e kopjeve të dokumenteve. Ky është detyrimi i tij me ligj dhe logjik gjithashtu.
1. Në shekullin e internetit, autoriteti publik duhet ti sigurojë palës **mjetet teknike të nevojshme** për akses elektronik, për tu njohur me dosjen e çështjes. Organi publik mund ti bëjë dokumentet elektronikë të aksesueshme nëpërmjet internetit, nëse kjo nuk cenon sigurinë e të dhënave të mbrojtura sipas ligjit. Në të gjithë botën moderne ka një debat ligjor për prioritetin e aksesit në dosje mbi sigurinë e të dhënave të mbrojtura, dhe anasjelltas.
1. Vetëm për kopjet, dhe jo për origjinalët, është e mundur të vendosen tarifa të cilat përcaktohen me vendim të organit publik.

Ka një lidhje funksionale këtu - në çdo rast **nuk duhet të tejkalohë koston** e riprodhimit të tyre. Kjo do të thotë se tarifa duhet të jetë nga lloji i të ashtuquajturave "tarifa proporcionale".

#### Neni 45 E drejta e palëve për tu njohur me dosjen- I- II

Një krahasim-  
në **Kodin e Procedurës Administrative në Poloni**, rregulli korrespondues thotë, që **në çdo fazë të procedurës** një organ i administratës publike duhet ti lejojë palëve të shohin dosjet dhe të mbajnë shënime apo kopje të tyre. Një palë mund të kërkojë që shënime apo kopje që përbëjnë dosjen e çështjes të autentifikohet, nëse një gjë e tillë justifikohet nga interesat e palës (73/1,2).

#### Neni 45 E drejta e palëve për tu njohur me dosjen - III

dhe anasjelltas,  
në **Ligjin e Procedurës Administrative në Gjermani**, rregulli parashikon se autoriteti i lejon pjesëmarrësve të njihen me dokumentet e lidhura me procedurën **në rastet kur njohja e përmbajtjes së tyre është e nevojshme** për të vërtetuar apo mbrojtur interesat e tyre të ligjshme (29/1). Megjithatë, autoriteti **nuk është i detyruar të lejojë njohjen me dokumentet** kur kjo gjë do të interferonte me kryerjen siç duhet të detyrave të autoritetit, kur dijenia mbi përmbajtjen e dokumenteve do të ishte në disfavor të vendit të tërësi apo të një prej Landeve, apo ku procedurat duhet të mbahen sekret nga ligji apo për shkak të vetë natyrës së tyre, d.m.th në interesat e ligjshme të pjesëmarrësve apo të palëve të treta (29/2). Për më tepër, njohja me dokumentet do të kryhet në zyrat e autoritetit që bën regjistrimet. Në raste individuale, dokumentet mundet gjithashtu të inspektohen në zyrat e një autoriteti tjetër apo të përfaqësuesve diplomatikë apo konsullorë të Republikës Federale të Gjermanisë jashtë vendit. Autoriteti që mban regjistrat mund të bëjë përjashtime të tjera (29/3).

## Neni 46

### Kufizimi i së drejtës së palës për tu njohur me dosjen

Vetëm ligji i posaçëm mund të kufizojë të drejtën e palës, të parashikuar më lart në Kodin e ri të Procedurave Administrative në Shqipëri.

## Neni 47 E drejta për të paraqitur opinione dhe shpjegime

1. Në çdo fazë të procedurës administrative, të gjithë pjesëmarrësit në të kanë mundësinë të **jenë proceduralisht aktivë** me opinione, shpjegime, propozime apo çdo veprimtari tjetër ligjore. Nuk ka kufizime për këtë veprimtari, nëse ajo synon zgjidhjen ligjore dhe të duhur të çështjes.
2. Për shembull si krahasim, Ligji i Procedurës Administrative në Gjermani parashikon, që në procedura formale administrative pjesëmarrësve u jepet **mundësia që të bëjnë një deklaratë përpara se të merret një vendim**. Pjesëmarrësve u jepet mundësia që të marrin pjesë në seanca dëgjimore të dëshmitarëve dhe ekspertëve dhe të bëjnë pyetjet përkatëse. Atyre u jepet një kopje e një opinioni që ekziston në formë të shkruar apo elektronike (66/1,2).

## Neni 48 Detyrimi i vlerësimit

1. Ky është një "detyrim për vlerësim" për organin publik.
2. Organi publik nuk mund të **neglizhojë komentet, mendimet dhe shpjegimet e palëve të paraqitura gjatë procedurës**. Detyrimi për të vlerësuar të gjithë ato në formë të shkruar mund të realizohet në aktin ligjor të ndërmjetëm, por zakonisht - në aktin përfundimtar administrativ, si një pjesë e argumentimit të tij.
3. Për të folur në ngjashmëri me **Kodin e Procedurës Administrative në Bullgari**, ka një dispozitë, e cila kërkon në mënyrë kategorike që akti administrativ individual të lëshohet, pasi të jenë sqaruar faktet dhe rrethanat e rëndësishme për çështjen, dhe **pas marrjes në konsideratë të shpjegimeve dhe kundërshtimeve të qytetarëve dhe organizatave të interesuara, në qoftë se këto janë kryer (35)**.

## Dokumenti 2: Parimi i pjesëmarrjes Emri i ekspertit: Z. Yves DOUTRIAUX

Parimi i pjesëmarrjes (nenet 33-44)

- OSBE: E drejta për të marrë pjesë në kryerjen e punëve publike ka qenë e njohur globalisht dhe në mjedise të brendshme dhe standardet rajonale dhe modelet janë zhvilluar për të mbështetur pjesëmarrjen e publikut, duke përfshirë edhe atë të shoqatave, në proceset vendim-marrëse. Duke riafirmuar rolin jetik që shoqatat, OJQ-të, grupet dhe individët kanë luajtur në promovimin e demokracisë, të drejtave të njeriut dhe sundimin e ligjit, siç përcaktohet në një numër angazhimesh të OSBE-së, Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së kanë kryer me qëllim "forcimin e modaliteteve për kontakt dhe shkëmbime ndërmjet OJQ-ve dhe autoriteteve përkatëse kombëtare dhe institucioneve shtetërore "(Moskë 1991 para. 4.3.1). Për këtë qëllim, shtetet pjesëmarrëse të OSBE duhet të sigurojë që mekanizmat e duhura dhe procedurat për pjesëmarrjen e individëve dhe shoqatave, si përfaqësues të shoqërisë civile, në çështjet publike duke siguruar dialog të hapur të rregullt, të vazhdueshëm dhe institucionalizuar për të lehtësuar pjesëmarrjen e tyre efektive ( Vjenë 15-16 prill 2015).
- Konventa e Aarhusit: Në fushën e **zhvillimit të qëndrueshëm dhe mjedisit** (neni 8 i Konventës së Aarhusit, 25 qershor 1998):
- Secila palë do të përploqet të promovojë pjesëmarrjen efektive të publikut në një fazë të duhur, dhe kur janë ende mundësitë, gjatë përgatitjes nga ana e autoriteteve publike të rregulloreve ekzekutive dhe rregulla të tjera ligjore të përgjithshme e detyruese që mund të ketë një efekt të rëndësishëm në mjedis. Për këtë qëllim, duhet të merren hapat e mëposhtëm: (a) Afatet të mjaftueshme për pjesëmarrje efektive duhet të jenë fikse; / (b) projekt rregulloret duhet të publikohet apo vihen në dispozicion të publikut; dhe / (c) Publiku duhet t'i jepet mundësia për të komentuar, drejtpërdrejt ose nëpërmjet organeve përfaqësuese këshillimore. Rezultati i pjesëmarrjes së publikut, do të merren parasysh sa më shumë të jetë e mundur

## Pjesëmarrja

- E drejta për një administratë të mirë (Neni 41 karta evropiane për të drejtat themelore ( që duhet respektuar nga vendet anëtare kur ato zbatojnë ligje dhe rregullore të BE-së) :
- 1. Çdo person ka të drejtë që çështjet e tij të trajtohen në mënyrë të paanshme, të drejtë dhe brenda një kohe të arsyeshme nga institucionet, organet, zyrat dhe agjencitë e Unonit.
- 2. Kjo e drejtë përfshin:
  - (a) e drejta e çdo personi që të dëgjohet, përpara se të merret çfarëdo lloj mase individuale që do të cenonte atë negativisht;
  - (b) e drejta e çdo personi që të ketë akses tek dosja e tij apo e saj, duke respektuar konfidencialitetin apo sekretin profesional apo tregtar të ligjshëm;
  - (c) detyrimi i administratës për të dhënë arsye për vendimet e saj.
- 3. Çdo person ka të drejtë kundrejt Unionit që ky i fundit ti dëmshtëpërblejë çdo dëm të shkaktuar atij nga institucionet e tij apo nga nëpunësit e tij në kryerjen e detyrave të tyre, në përputhje me parimet e përgjithshme të përbashkëta me ligjet e Vendeve Anëtare (...).
- GjED Transparencë dhe pjesëmarrje janë parime që duhen respektuar nga institucionet Europian nën kontrollin e GjED (C-92/09 9 Nëntor 2010). Sipas Gjykatës "parimi i transparencës i parashikuar në Nenet 1 dhe 10 të Traktatit të Bashkimit Europian dhe Nenin 15 të Traktatit të Themelimit të Bashkimit Europian, i jep mundësi qytetarëve të marrin pjesë ngushtësisht në procesin e vendim-marrjes dhe të garantojë që administrata të gëzojë legjitimitet më të madh dhe të jetë më e efektshme dhe përgjegjëse ndaj qytetarëve në një sistem demokratik. ).

## Palë në procedurën administrative neni 33)

- Çdo person fizik apo juridik që kërkon një akt individual (leje ndërtimi) apo një akt nën-ligjor (anulim apo modifikim të një planifikimi urban të një qyteti apo projekti infrastrukture), ndaj të cilit ka filluar një procedurë administrative (sanksion administrativ, shfuqizim i një autorizimi të mëparshëm, pezullim kontrate, tërheqje e një leje qëndrimi ...) ka filluar apo të cilit synohet ti drejtohen një vendim.
- Mbajtësit e një interesi kolektiv mund të jenë palë: sipas ligjit francez, komiteti këshillimor që përfaqëson interesat e konsumatorëve apo një mbrojtje patrimoniale arkitekti publik duhet të konsultohet nga organi publik kompetent përpara nxjerrjes së një dekreti për mbrojtjen e konsumatorit apo një leje ndërtimi individuale. Interesat kolektive mund të përfaqësohen nga një OJF në mbrojtje të mjedisit, një sindikatë (kur statuti i një nëpunësi cili është në lojë), urdhër profesional (kur ka lidhje me veprimtaritë e profesionit të rregulluar ...)
- Persona të tjerë interesit i të cilëve mund të preket: përpara paraqitjes se lejes së veçantë të ndërtimit ( ex ëindmill), një hetim publik i hapur për të gjithë palët e interesuara duhet të organizohet.

## Zotësia për të vepruar (neni 34), përfaqësimi

- Një komitet këshillimor, një ministri e cila nuk është një person juridik nuk mund të kualifikohet si palë por mundet / ose duhet-nëse kërkohet me ligj / aktin nën-ligjor të konsultohet në procedurën administrative.
- Palët person juridik duhet të përfaqësohen nga përfaqësues ligjorë; fëmija i mitur nga prindërit e tij , personat e sëmurë mendërisht nga përfaqësuesit e tyre ligjorë.
- Neni 36 parashikon se në disa raste, organi publik mund të emërojë një përfaqësues të përkohshëm apo një palë përfaqësuese (konflikti i interesit, palë e panjohur, pa rezidence në Shqipëri?)
- Përfaqësues i përbashkët (neni 37- mund të jetë një lloj «padie kolektive» në një procedurë administrative?), përfaqësues i

emëruar (neni 38- si një avokat apo një këshill, një përfaqësues i një punonjësit publik), asistent (Neni 39)

### **Inicimi i procedurës administrative neni 41)**

- Inicimi: ex officio apo me paraqitjen e një kërkesë (kërkesë për një leje ndërtimi, patentë, vizë, leje qëndrimi, për miratimin / shfuqizimin e një norme nën-ligjore ...).
- Nëse është një iniciim ex officio, është në diskrecionin e organit publik: deportimi i një punonjësi të paligjshëm, dëgjese publike për një projekt të infrastrukturës publike; nëse nuk ka projekt nuk është e nevojshme të ketë një dëgjese publike; (Fr) sipas ligjit, nëse është një projekt i vogël dëgjese publike nuk është një detyrim por vetëm një mundësi. Por në shumë raste një procedurë administrative ex officio është e detyrueshme. Për shembull për disa projekte të caktuara të infrastrukturës ( Fr më shumë se 3000 euros një autoritet i pavarur administrativ duhet të organizojë një debat publik); ose (Fr) prefekti duhet të njoftojë një kompani të ndalë operacionet e saj nëse cenohet mjedisi apo shëndeti publik një urdhër mjekësor profesional pezullon veprimtarinë e një mjeku nëse ai është i sëmurë mendërisht; një krye bashkiak urdhëron riparime në një shtëpi private nëse kjo kërcënon sigurinë publike në rrugë. Nëse këto organe publike nuk do të vepronin përgjegjësia e tyre mund të lindë në rast dëmsh.

### **Komunikimi me palët (neni 42)**

- Në rastet kur një organ publik fillon një procedurë administrative ai njofton të gjitha palët me shkrim apo me takim me të dhënat e mëposhtme: adresën e organit publik, kompetencën e tij, qëllimin e procedurës administrative, palët, të drejtën për të inspektuar dosjen (informacionin e mbajtur nga organet publike -që publiku të jetë plotësisht i informuar për projektin në fjalë dhe pasojat e tij me të njëjtin informacion si organi publik, anikimi kundër një personi kur vlerësohet një sanksion), e drejta e palës për tu dëgjuar dhe afatet për këtë (mundësia verbale me një avokat apo

me shkrim Fr: e detyrueshme në rast të sanksioneve apo kur një akt që mund të shkaktojë ankimum - shfuqizim i një autorizimi të mëparshëm, kufizimi i lirisë - merret në konsideratë), koha e fillimit të procedurës, nëse është e përshtatshme, përfundimi i saj me një vendim përfundimtar (koha e arsyeshme).

- Përrjashtime: sekreti shtetëror (Fr: një autoritet i pavarur, me kërkesë të palës mund të monitorojë nëse është një sekret ligjor real), gjendja e jashtëzakonshme (ex Fr kontroll banese pa paralajmërim)

### **Njësia/zyrtari përgjegjës (neni 43)**

- Sipas rregullave të kompetencës (nenet 22-29), një zyrtar përgjegjës është caktuar nga organi publik kompetent drejtues për zhvillimin e një procedure administrative dhe nënshkrimin e vendimit përfundimtar; ky emërim bëhet publik me mjete të përshtatshme (Fr: në parim në revistën zyrtare).
- Në bazë të nenit § 3 një vendim i propozuar që mund të ishte i ndryshëm nga vendimi përfundimtar mund të komunikohet palëve (y).
- Neni 5 : rasti i një organi kolegjal (për shembull një këshill bashkiak, një komitet kolegjal sanksionesh) mund t'ia delegojë procedurën administrative njërit prej anëtarëve të tij.

## **Dokumenti 3: Ekzekutimi i akteve administrative (niveli i thelluar)**

### **Emri i ekspertit: Z. Mladen Mladenov**

#### **Neni 164 Aktet e ekzekutueshme - I**

Kushti ligjor i detyrueshëm (*condition sine qua non*) për ekzekutimin është hyrja në fuqi e aktit administrativ. Pa këtë nuk ka një vendim të vlefshëm të organit publik, për shkak të disa pengesave ligjore. Më e njohura ndër to është mundësia për ta ankimuar aktin (afati për ankimumin e vendimit).

Çdo ligjvënës pret ekzekutimin vullnetar (më shumë- më poshtë në

tekst). Arsyet për këto pritshmëri janë të ndryshme, por më kryesoret janë:

- Ekzekutimi bazuar në pranimin e kuptuar të aktit administrativ;
- Ekzekutim i shpejtë;
- Ekzekutimi me kosto të ulët;
- Ekzekutimi më cilësor;
- Ruajtja e respektit dhe "marrëdhënieve shoqërore" me organin publik.

### **Neni 164 Aktet e ekzekutueshme - II**

Ka disa hipoteza ligjore që akti administrativ të marrë cilësinë e "titullit ekzekutiv", që janë si më poshtë:

- Kalimi i afatit për ankimin administrativ, pa kryerjen e një ankimi;
- Pas njoftimit, nëse ankimi administrativ nuk lejohet;
- Pas njoftimit, në rast se ankimi administrativ nga ka efekt pezullues (akti administrativ që synon të mbledhë taksa, tatime dhe të ardhura të tjera buxhetore apo akti administrativ që ka lidhje me masat policore);
- Pas njoftimit të vendimit për të shfuqizuar efektin pezullues të ankimit (kur organi publik që shqyrton ankimin vlerëson se zbatimi i menjëhershëm është në interesin publik të përbashkët);
- Pas njoftimit të vendimit që zgjidh ankimin, duke e refuzuar apo mos pranuar atë.

Normalisht, çdo vendim që ndryshon aktet e ankimuar do të bëhet i ekzekutueshëm vetëm dhe vetëm pas njoftimit të palëve të interesuara në çdo rast.

### **Neni 165 Parimi i ekzekutimit të detyrueshëm**

1. Procesi i ekzekutimit është pjesë e Procesit Administrativ. Në këtë mënyrë, të gjitha parimet e KPA janë të zbatueshme plotësisht edhe këtu.

2. Parimi, i cili është specifik për Procesin Ekzekutiv është se "mënyra dhe mjetet e ekzekutimit, duhet të shkaktojnë dëme sa më minimale tek të drejtat dhe interesat ligjore të subjektit të ekzekutimit". Ky është një manifestim i veçantë i Parimit të Proporcionalitetit (Parimi i proporcionalitetit) në Procesin e Ekzekutimit.
3. Gjykimi i organit publik këtu ka një rëndësi thelbësore. Administrata duhet të kërkojë të gjitha mënyrat dhe mjetet e mundshme të ekzekutimit dhe të zgjedhë ndër to këtë, ato që janë më të lehta për subjektin e ekzekutimit. I detyrueshëm, dimensionet e kohës, sendet personale, paratë duhet të gjykohen nga autoriteti publik, përpara fillimit të ekzekutimit të detyrueshëm të aktit administrativ.

### **Neni 166 Aktet që nuk mund të ekzekutohen**

Ka situata të tilla, kur aktet administrative të ekzekutueshme nuk duhet të ekzekutohen.

E para është kur pasojat e aktit administrativ janë pezulluar (për shembull-zbatohet amnistia financiare apo shuarja e detyrimeve financiare).

E dyta është kur kundër aktit administrativ të ekzekutueshëm është paraqitur ankimi me efekt pezullues (për shembull- mjete të jashtëzakonshme të ankimit apo legjisacioni i ri, që e parashikon atë).

E treta është, kur dispozita ligjore parashkruese është e zbatueshme- kur kanë kaluar 5 (pesë) vite nga data kur akti është bërë i ekzekutueshëm. Shpjegimi është që ekzekutimi nuk mund të jetë "Shpata e Demokleut" mbi debitorin.

### **Neni 167 Organi kompetent për ekzekutimin e detyrueshëm - I**

Në Procesin e Ekzekutimit çështja e kompetencës së organit ngrihet përsëri. Logjika normale administrative tregon se duhet të jetë organi publik që ka nxjerrë aktin fillestar. Në këtë mënyrë nga fillimi deri në fund të të gjitha fazave të mundshme të procedurës, roli drejtues do të jetë I të njëjtit institucioni publik.

E njëjta formulë procedurale zbatohet edhe nëse akti administrativ është ndryshuar apo zëvendësuar nga organi epror, për shkak të ankimit

administrativ ose nga gjykata.

### Neni 167 Organi kompetent për ekzekutimin e detyrueshëm - II

Për krahasim, kjo çështje procedurale ligjore në **Bullgari** është shumë e komplikuar. **Kodi i Procedurave Administrative** të vendit parashikon se, procedura e ekzekutimit do të trajtohet sipas këtij Kodi, pavarësisht procedurave të ekzekutimit në vazhdim sipas Kodit të Procedurës Civile dhe Kodit të procedurave Tatimore-Sigurimeve kundër të njëjtit debitor (270). Për më tepër, organi i ekzekutimit është: për në ekzekutimin kundër qytetarëve dhe organizatave- organi administrativ, që ka nxjerrë apo ka qenë i detyruar të nxjerrë aktin administrativ, përveç rasteve kur një organ tjetër është përcaktuar për shkak të ekzekutimit apo nga ligji; për një ekzekutim kundër një organi administrativ- ekzekutuesi i gjykatës, në rajonin e të cilës është vendi i ekzekutimit të detyrimit (271/1). Kjo çështje ligjore përshkruhet në Kapitullin XI "Ekzekutuesi", nga MLADENOV, Mladen, "Jurisprudenca përshkuese " (në bullgarisht), botimi i parë, Botues "Nova Zvezda", [www.nowavezda.com](http://www.nowavezda.com), ISBN 978-619-198-008-6, Sofje, 2015, XV-374.

### Neni 168 Subjekti i ekzekutimit të detyrueshëm - I

1. Debitori në marrëdhënien juridike ligjore do të jetë subjekti i ekzekutimit të detyrueshëm. Ky është rezultat i një detyrimi tashmë të përcaktuar në marrëdhënien ligjore administrative. Në rast të zhdukjes së debitorit nga bota ligjore, do të jenë trashëgimtarët e tij ligjorë, nëse detyrimi nuk ka një karakter ngushtësisht personal (*intuitu personae*).
2. Modeli i fundit duhet të shqyrtohen nga prizmi the i Teorisë së Detyrimeve.
3. Shembulli i pastër i detyrimit të një karakteri ngushtësisht personal është ai i llojit *facere* (të bësh diçka). Për shkak se debitori është zgjedhur me aftësitë e tij /saj personale, askush tjetër nuk mund ta bëjë të njëjtën gjë.

### Neni 168 Subjekt i ekzekutimit të detyrueshëm - II

1. Në rast të detyrimit për të *dare* (dhënë diçka), trashëgimtarët janë në gjendje ta bëjnë një gjë të tillë.
2. Në situatën e *non facere* (të mos bësh diçka), trashëgimtarët gjithashtu janë në gjendje të respektojnë këtë detyrim për të mos kryer në veprim.
3. Kur detyrimi është nga lloji i pati (të durojë diçka, të rezistojë të ketë durim), trashëgimtarët mund të durojnë të gjitha veprimet ligjore nga pjesëmarrësit e tjerë në procedurën administrative, por vetëm mund të pranojnë rezultatet nga kjo situatë. Kjo është sjellje e përgjithshme, në rastin e "*non facere*" për shkak të sjelljes procedurale është vetëm për veprim ligjor korrekt, për shembull- të mos pengojë mbledhjen e provave nga palë të tjera të interesuara

### Neni 169 Njoftimi për ekzekutimin vullnetar- I

1. Institucioni ligjor i "Njoftimit për ekzekutimin vullnetar" ("paralajmërimi") është thelbësor për Procesin e Ekzekutimit. Ai përfaqëson pritsmërinë e ekzekutimit vullnetar. Por është edhe personifikim i Parimit të ndërgjegjes, që është parimi i përbashkët në jetë dhe në ligj.
2. Ka disa kërkesa këtu.
  - Së pari të shpjegohet shumë qartazi tek subjekti i ekzekutimit që ai/ ajo duhet (dhe mundet) të ekzekutojë vullnetarisht detyrimin sipas aktit administrativ. Praktikë shumë e mirë këtu do të jetë nëse administrata e lehtëson subjektin me propozimet e qasjet e mundshme për instrumente të tilla të ekzekutimit.
  - Së dyti, në paralajmërim duhet të tregohen qartazi afatet për ekzekutimin.

### Neni 169 Njoftimi për ekzekutimin vullnetar- II

1. Dhe së fundmi, njoftimi për ekzekutimin vullnetar bëhet me shkrim dhe i njoftohet formalisht subjektit të ekzekutimit. Këto janë vetëm rregulla formale për paralajmërimin. Janë vetëm për

këndvështrimin e provës, njoftimi real sjell pasojat substanciale të ekzekutimit vullnetar (nëse ai ekziston në çdo rast).

2. Mungesa e dërgimit të një njoftimi do të jetë një argument për të ankmuar të gjithë procedurën e ekzekutimit, për shkak të mos respektimit të dispozitës nga administrata dhe është një praktike e keqe administrative e rëndë.

### **Neni 170 Përmbajtja e njoftimit vullnetar**

Specifikim i qartë i shkaqeve ligjore të ekzekutimit duhet të jepet këtu. Ky njoftim duhet të përmbajë a) një përmbledhje të aktit administrativ që do të ekzekutohet. Kërkesa tjetër nga këndvështrimi formal është që të japë një informacion për mënyrën e ekzekutimi si dhe të dhëna të tjera të nevojshme për ekzekutimin. Është shumë e rëndësishme të bëhen regjistrime të paralajmërimeve të subjektit të ekzekutimit që në rast të mos kryerjes së ekzekutimit vullnetar, brenda një afati kohor të specifikuar në njoftim, do të fillojë ekzekutimi i detyrueshëm. Ky i fundit do të luajë rol stimulues për subjektin që të kryejë ekzekutimin vullnetar.

### **Neni 171 Koha e ekzekutimit të detyrueshëm**

1. Ka një "kalendar të ndaluar" të ekzekutimit të detyrueshëm- gjatë pushimeve dhe festave zyrtare. Ky është mishërim i parimit të proporcionalitetit në Procesin e Ekzekutimit.
2. I njëjti manifestim ligjor është ndalimi i ekzekutimit të detyrueshëm ndërmjet orës 19:00 - 7:00- "pjesë e ndaluar e ditës".
3. Megjithatë, këtu ka përjashtime - vetëm në raste urgjente ekzekutimi i detyrueshëm lejohet edhe në periudhën kohore të lartpërmendur. Por në një rast të tillë duhet të ketë një urdhër me shkrim të arsyetuar të organit kompetent për ekzekutimin. Ai duhet të parashikojë në mënyrë të qartë arsyet për pasojat eventuale në interesin publik si rezultat i mosekzekutimit.

### **Neni 172 Njoftimi për ekzekutimin e detyrueshëm**

1. Nëse detyrimi nuk zbatohet vullnetarisht, organi kompetent publik

informon subjektin e ekzekutimit për ekzekutimin e detyrueshëm. I vetmi përjashtim është ekzekutimi i menjëhershëm sipas Nenit 179 - në rastet urgjente dhe mungesës së subjektit të ekzekutimit.

2. Përsëri, njoftimi për ekzekutimin vullnetar bëhet me shkrim dhe i njoftohet formalisht subjektit të ekzekutimit dhe përbën një akt administrativ.
3. "Pjesë e aktit administrativ që ekzekutohet" - Në rastet kur paraqitja e një ankimi nuk ka pasojë pezullimi sipas ligjit të veçantë, apo nëse është e qartë që gjatë procedurës administrative që pala nuk e përmbush detyrimin vullnetarisht, vetë njoftimi do të jetë pjesë e aktit administrativ që ekzekutohet.

### **Neni 173 Përmbajtja e njoftimit për ekzekutimin e detyrueshëm**

1. Në mënyrë të ngjashme si ekzekutimi vullnetar, paralajmërimi për ekzekutimin e detyrueshëm duhet të përmbajë një përmbledhje të aktit administrativ që do të ekzekutohet; datën dhe orën e planifikuar për kryerjen e ekzekutimit; dhe informacionin për mënyrën e ekzekutimit dhe të dhëna të tjera të nevojshme për ekzekutimin.
2. Në rastet kur ekzekutimi i detyrueshëm bëhet në përputhje me nenin 176 të KPA (Ekzekutimi i detyrimeve jo financiare me anë të personave të tretë), njoftimi, nëse është e mundur përmban edhe sasinë e kostove të ekzekutimit.

### **Neni 174 Ekzekutimi i detyrueshëm i detyrimeve monetare**

Një qasje e mirë legjislative është zbatuar këtu - referencë në dispozitat e ligjit që rregullojnë procedurat tatimore. Kjo është e arsyeshme, sepse ligji për procedurat tatimore parashikon procedurat në sferën publike me përmbajtje monetare.

### **Neni 175 Ekzekutimi i detyrimeve jo financiare**

Sa i takon detyrimeve jo financiare, ato janë përtej pagesës me kesh. Tre llojet e këtyre detyrimeve, janë të lidhura me

- kryerjen e një veprimi;
- lejen për kryerjen e një veprimi;
- ndalimin e kryerjes së një veprimi.

Rregullat e zbatueshme janë nenet 176 deri në 178.

### **Neni 176 Ekzekutimi i detyrimeve jo financiare me anë të personave të tretë - I**

1. Ka një detyrim procedural për organin publik që të ndihmojë personat e tretë që të përmbushin detyrimet jo financiare. Folja "mundet" këtu duhet të kuptohet si "duhet", sepse organi publik drejton të gjithë procesin dhe është e arsyeshme të ndihmojë personat e tretë, në vend të vetëm procedurës.
2. Ka dy kushte për këtë sjellje. Kushti i parë është – detyrimi duhet të jetë jo financiar dhe të jetë një veprim i një natyre të tillë që mund të përmbushet nga një person i tretë.

### **Neni 176 Ekzekutimi i detyrimeve jo financiare nëpërmjet personave të tretë- II**

1. Kushti i dytë për të ndihmuar personin e tretë – subjekti i ekzekutimit të mos e ketë përmbushur apo ta ketë përmbushur vetëm pjesërisht detyrimin jo financiar.
2. Këtu ekziston një qasje legjislative shumë e zgjuar- përmbushja e detyrimit nga personi i tretë bëhet me shpenzimet e subjektit të ekzekutimit. Arsyja është që askush nuk është në borxh për ekzekutimet e detyrimeve të debitorit.
3. Një pasojë teknike për situatën e mësipërme – organi publik kompetent për ekzekutimin llogarit shpenzimet dhe urdhëron subjektin e ekzekutimit të depozitojë paraprakisht shumën e nevojshme për ti mbuluar ato. Këtu janë të zbatueshme rregullat për ekzekutimin e detyrimeve financiare gjithashtu.

### **Neni 177 Detyrimi për të bashkëpunuar**

1. Në rast mos ekzekutimi për arsye të ndryshme, policia e shtetit ndihmon organin publik për ekzekutimin e detyrimeve jo financiare. Nga ky detyrim për bashkëpunim janë përjashtuar të gjitha institucionet e tjera të armatosura, sipas dispozitave të mësipërme të formuluarat qartazi.
2. Bashkëpunimi mund të ketë forma të ndryshme, por ajo e pritshme nga ligjvënësi është- Policia e shtetit duhet të garantojë sigurinë e zyrtarëve të organit publik kompetent të detyrueshëm në përmbushjen e detyrimeve ligjore të tyre.

### **Neni 178 Ekzekutimi i vendimeve të ndërmjetme**

1. Edhe përpara se akti të bëhet i ekzekutueshëm, vendimet e ndërmjetme mund të ekzekutohen në përputhje me rregullat për detyrimet jo -financiare në KPA.
2. Detyrimi procedural ekziston këtu – paralajmërimi për ekzekutimin në rastin e parashikuar në pikën 1 të këtij neni është pjesë e aktit që urdhëron të merret masa respektive.
3. Në vijim të natyrës së vendimeve të ndërmjetme (për të siguruar procedurën), ligjvënësi shqiptar ka vendosur që detyrimet sipas vendimit të ndërmjetëm do të ekzekutohen brenda 3 ditëve nga nxjerrja e aktit. Nëse në këto 3 ditë nuk është bërë kjo gjë rezultati i synuar i aktit administrativ është i rrezikuar.

### **Neni 179 Ekzekutimi i menjëhershëm - I**

1. Institucioni ligjor i "Ekzekutimit paraprak" quhet ligjvënësi shqiptar si "Ekzekutimi i menjëhershëm" dhe aludon për çështje të ekzekutimit edhe pa nxjerrë një akt administrativ përpara. Ka 3 kushte ligjore strikte për një metodë të tillë të procedurës.
2. E para është kur të drejta serioze dhe interesa ligjore vihen në rrezik – rendi publik dhe siguria për shëndetin, jetën, apo pasurinë e njerëzve. Kjo është arsyeja pse është e nevojshme të marrin një masë urgjente për ti siguruar ato, apo për të shmangur kërcënime



të menjëhershme për to.

3. E dyta është kur për shkak të urgjencës ekstreme për të marrë masën, një akt administrativ që urdhëron përmbushjen e një detyrimi jo-financiar nuk mund të nxirret në kohën e duhur. Ky rast është një mundësi procedurale për një organ administrativ për të vepruar në një radhë të tillë, që është më e përshtatshme për vetë procedurën.

### Neni 179 Ekzekutimi i menjëhershëm - II

1. I treti është pasi debitori i pakujdesshëm (subjekti i ekzekutimit) – pala, apo përfaqësuesi tek i cili akti që urdhëron përmbushjen e një detyrimi jo financiar, duhet të adresohet, nuk mund të gjendet. Kur pala mungon, shkelja e tij procedurale transformohet në mundësi procedurale të organit administrativ.
2. Pala e cenuar nga ekzekutimi i masës urgjente mund të bëjë një kërkesë për të nxjerrë një akt me shkrim, që konfirmon veprimin e kryer. Kjo, për shkak se është ligjërish e pa tolerueshme në sferën publike të ekzistojë një veprim, pa aktin e tij administrativ themelues. Detyrimi i organit publik pas një kërkesë të tillë është brenda 8 (tetë) ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës.
3. Edhe këtu ekziston një afat – në çdo rast, kërkesa e palës nuk mund të paraqitet më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga data e ekzekutimit. Nëse pas këtij afati nuk ka kërkesë, subjekti pranon në heshtje veprimin e ekzekutimit; nëse ka- kërkesa e tij është proceduralisht e papranueshme.

### Neni 180 Pezullimi i ekzekutimit - I

Ka dy mënyra të mundshme procedurale për pezullimin e një ekzekutimit të detyrueshëm - *ex officio* or apo me kërkesë të subjekteve të ekzekutimit . Ligjvënësi shqiptar në mënyrë shumë strikte ka shqyrtuar të gjitha rastet në shumë klauzola.

1. Së pari, kur provohet se ka një risk për të shkaktuar një rrezik serioz dhe të pa zëvendësueshëm tek subjekti i ekzekutimit, dhe pezullimi në një rast të tillë nuk cenon interesin publik. Provat këtu duhet të

jenë reale dhe jo deklarata.

2. Së dyti, gjykata kompetente për çështjet administrative ka vendosur të pezullojë zbatimin e aktit, sipas dispozitave për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative. ADR zëvendëson procedurën formale administrative në tërësi, kjo është arsyeja pse në një rast të tillë pezullimi është thelbësor.
3. Së treti, ekzekutimi është kryer apo është duke u kryer kundër një subjekti që nuk ka qenë subjekt i një detyrimi. Opsioni është në kundërshtim me synimin e ekzekutimit, pasi i është bërë subjektit të gabuar.

### Neni 180 Pezullimi i ekzekutimit - II

1. Së katërti, nëse dispozita ligjore e posaçme e ndalimit të ekzekutimit ekziston (i.e. - ekzekutimi i detyrueshëm kundër shtetit).
2. Së fundmi, në raste të tjera, të parashikuara nga ligji- kjo dispozitë është krijuar në lidhje me legjislaclonin e ardhshëm (*lege ferenda*).
3. Pas pezullimit veprimet e ekzekutimit janë të paligjshme. Për këto arsye, të gjithë veprimet e kryera deri në momentin e pezullimit të ekzekutimit të detyrueshëm do të anulohen.
4. Për shkak të detyrimit të Sigurisë Ligjore, në të gjitha rastet, organi publik justifikon vendimin e tij për të pezulluar ekzekutimin e detyrueshëm. Argumentet faktike dhe ligjore janë të nevojshme në të gjithë punë e organit administrativ.

### Neni 181 Përfundimi i ekzekutimit

Fundi i të gjithë procedurës së ekzekutimit mund të ndjekë kushte të ndryshme.

I pari është kur subjektim i ekzekutimit ka përmbushur detyrimin dhe në këtë mënyrë nuk ka detyrim.

E dyta është kur akti administrativ që shërben si shkak për ekzekutimin është shfuqizuar apo revokua. Kjo do të thotë që nuk ka shkaqe ligjore për tu ekzekutuar.

Dhe së fundmi, ligjvënësi shqiptar ka vendosur që përfundimi i ekzekutimit do të ekzistojë në rastet e tjera si parashikohet nga ligji.

Qartazi, *lege ferenda* këtu vihet në dukje nga ligjvënësi.

### **Neni 182 Shtyrja e ekzekutimit**

Një "shtyrja në kohë" e ekzekutimit për periudha kohore të ardhshme duhet të kufizohet vetëm për disa raste.

I pari është kur organi publik ka vendosur për shtyrje e tij për një afat kohor të caktuar. Ky vendim duhet të jetë I arsyetuar me kujdes të veçantë

Rasti I dytë është kur një akt tjetër, zëvendëson aktin që po ekzekutohet. Shumë qartazi, ligjvënësi ka ndërmend të shmangë përplasjen ndërmjet dy akteve administrative duke ekzekutuar vetëm njërin.

### **Neni 183 Pasojat e ekzekutimit të akteve të shfuqizuara apo të anuluar**

1. Rivendosja në gjendjen e mëparshme apo gjendja që krijohet nga akti i ri është një situatë e mundshme, kur ekzekutimi vullnetar apo i detyrueshëm është kryer, dhe akti administrativ themelor është shfuqizuar apo anuluar. Kushti ligjor për këtë është kërkesa nga subjekti i ekzekutimit. Kështu, rivendosja varet nga veprimi ligjor i subjektit dhe nuk është e mundur të bëhet ex officio.
2. Organi kompetent për rishikimin e një kërkesë është i njëjtë si ky, që drejton të gjithë procesin e ekzekutimit, i.e. - kërkesa shqyrtohet nga organi publik që është kompetent për ekzekutimin. Në të kundërt do të ketë një ndërlirim të procesit që është i panevojshëm nga këndvështrimi legjislativ.

### **Neni 184 Ankimimi kundër veprimeve të ekzekutimit - I**

Që prej fillimit të Procesit të Ekzekutimit, subjekti i ekzekutimit ka të drejtën të mbrohet. Kjo është arsyeja pse mund të bëhet një ankim i tillë kundër paralajmërimit për ekzekutim. Linja e drejtpërdrejtë e tij është organi epror i organit kompetent për ekzekutimin.

Ka një afat këtu - brenda 5 (pesë) ditëve nga paraqitja e ankimit, organi

epror duhet të shqyrtojë apelin.

Gjithashtu, kufijtë janë përcaktuar me akt të ligjvënësit - ankimi mund të ketë lidhje vetëm me mënyrën e ekzekutimit, që do të thotë që kjo nuk është mënyra për të kundërshtuar vetë aktin administrativ.

Një gjë tjetër e rëndësishme këtu është që ankimimi nuk ka efekt pezullues.

### **Neni 184 Ankimi kundër veprimeve të ekzekutimit - II**

Kur veprimet e kryera për ekzekutimin e detyrueshëm kanë kaluar pjesën e detyrueshme të aktit që po ekzekutohet, pala ka argumente për ankim. Sigurisht, kur këto akte janë në kundërshtim me dispozitat e KPA, është e njëjta situatë nga këndvështrimi racional.

Sigurisht, paraitja e ankimit nuk ka efekte pezulluese. Organi publik epror është I detyruar të shqyrtojë ankimin e paraqitur atij brenda 5 (pesë) ditëve nga data e lëshimit të tij. Ky është një afat tjetër, I ndryshëm nga ky më lart.

### **Neni 184 Ankimimi kundër veprimeve të ekzekutimit - III**

Ekzistojnë rregulla për raste përjashtimore këtu - nëse vazhdimi i ekzekutimit mund të paraqiste një rrezik për shëndetin, jetën apo pronën, pala ka "një të drejtë procedurale përjashtimore".

Në po të njëjtin nen 184, pika 3 përmendet "adresimi", jo për "ankim", "kërkesë" apo "nevojë". Kjo nuk është aksidentale. Ky "adresim" mund të kryhet përpara gjykatës kompetente për çështjet administrative, por në raste të tilla gjykata vendos si një "organ administrativ pothuaj -epror". Kjo është për arsye se gjykata duhet të vendosë në bazë të parmit të shpejtësisë më së shumti, jo mi bazën e ligjshmërisë së vetë ekzekutimit.

### **Neni 184 Ankimi kundër veprimeve të ekzekutimit - IV**

Edhe pse në pikën 3 të nenit 184 të KPA nuk ka një **afat** të shprehur, në bazë të parimit *analogia legis* gjykata duhet të vendosë brenda 5 ditëve. Vendimi gjyqësor do të jetë i llojit të "masave mbrojtëse të përkohshme", pasi gjendja e re mund të sjellë në ndryshimin e këtij vendimi më vonë.

## AFATET

### Dokumenti 1: të përballesh me kohën (niveli Bazë/i Avancuar) nga Z. Stephane Dewailly

#### Qëllimi i përgjithshëm :

#### PËRVETËSIMI I AFTËSITËVE TEORIKE DHE PRAKTIKE QË TË TRAJNUARIT TË ORGANIZOJNË VETEN DHE INSTITUCIONIN E TYRE PËRBALLË AFATEVE KOHORE.

- Do të shqyrtojmë tre aspekte ligjore :
  - Afatet kohore në çdo çështje publike ;
  - Miratimi në heshtje ;
  - Anulimi dhe shfuqizimi i akteve administrative.

#### I - Afatet kohore : Neni 53 KPA

- Në përgjithësi: veprimet e autoriteteve publike duhet të jenë të njëpasnjëshme dhe të parashikueshme, duke përfshirë edhe aspektet e afateve kohore. Personat juridikë duhet të jenë në gjendje të planifikojnë aktivitetet e tyre në afate kohore dhe qeveria duhet ta respektojë këtë planifikim.
- Ndoshta qasja e saktë dhe e drejtë legjislative duhet t'i referohet vetëm afateve të përcaktuara me ligj (dhe jo akte nënligjore), sepse administrata ka prirje të krijojë rregulla kryesisht në favor të saj (neni 53 KPA).
- Sipas nenit 6/paragrafi 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Kodi i ri i Procedurave Administrative të Shqipërisë në neni 53/ paragrafi 2 pohon kështu standardin e "afateve së arsyeshme" : përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë Kod, nëse ligji ose aktet nënligjore nuk parashikojnë një afat të caktuar për kryerjen e një veprimi procedural, organi publik që kryen procedurën cakton me vendim të veçantë një afat të arsyeshëm, sipas çështjes konkrete dhe në përputhje me parimin e ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit.

#### A - Afatet kohore të përcaktuara me ligj apo akt nënligjor

- 3. Pas kësaj, ekzistojnë rregulla të veçanta për zgjatjen e këtyre afateve, d.m.th. afati procedural i përcaktuar me ligj ose me akte nënligjore mund të zgjatet vetëm nëse kjo është parashikuar shprehimisht në ligj ose akt nënligjor, ndërsa afatet kohore të përcaktuara nga organi publik mund të zgjatet me kërkesë të justifikuar të palës së interesuar të paraqitur para skadimit të afatit.
- 4. SHEMBULL: Për paralelizëm, Kodi i Procedurës Administrative në Bullgari është shumë i detajuar në këtë çështje ligjore. Ai parashikon që akti administrativ të nxirret brenda 14 ditëve pas datës së fillimit të procedurës.

#### B - Shtyrja e afateve kohore

Informacioni i disponueshëm në letër do t'i sigurohet autoritetit tjetër brenda tri ditëve nga kërkesa e këtij të fundit, me kusht që afati përfundimtar për marrjen e vendimit të fillojë datën e marrjes së informacionit. Njoftimet zyrtare sipas kuptimit të Ligjit për Qeverisjen Elektronike do të bëhen pa vonesë.

#### C - Rivendosja në afat - Neni 54

1. Në bazë nenit 54/paragrafi 3, si një paronomazi ka "afate kohore për të kërkuar rivendosjen në afate kohore": Kërkesa për rivendosjen në afat duhet të bëhet brenda 15 ditëve nga dita kur janë eliminuar pengesat, por jo më vonë se 1 vit nga data e përfundimit të afatit të humbur. Në të njëjtin afat duhet kryer edhe veprimi procedural, për të cilin pala ka humbur afatin për shkaqe të arsyeshme.
2. Në rastin e "Akteve nga dora e Zotit" (vis major) - paragrafi 4 i nenit 54 të KPA-së thotë se: Afati 1-vjeçar, i përcaktuar në pikën 3, të këtij neni, nuk zbatohet në rastin e forcës madhore.

#### D - Pasojat e rivendosjes në afat - Neni 55

1. Kërkesa për rivendosjen në afat paraqitet dhe shqyrtohet nga organi publik kompetent që zhvillon procedurën administrative ose organi kompetent që vendos mbi mjetet ligjore administrative, ose organi që vazhdon ekzekutimin në përputhje me çështjen. Organi

para të cilit është paraqitur kërkesa për rivendosjen në afat merr vendim brenda 15 ditëve. (përsëri kemi paronomazi).

2. Përsa i takon paragrafit të dytë të Neni 55 të KPA-së, ai parashikon se depozitimi i kërkesës shkakton pezullimin e të gjitha veprimeve procedurale të kryera si pasojë e humbjes së afatit. Kundër vendimit të organit publik për mospranimin e kërkesës për rivendosjen në afat, mund të bëhet ankim sipas rregullave të parashikuara nga ky Kod. Pranimi i kërkesës për rivendosjen në afat shkakton anulimin e të gjitha veprimeve procedurale, të kryera si pasojë e humbjes së afatit. Fjalja e fundit është në favor të ankuesit.

### **E - Llogaritja e afateve kohore - Neni 56**

- Rregullat e sakta (të parashikuara me ligj) për llogaritjen e afateve kohore:
  - janë mënyra e vetme e duhur për të shmangur keqkuptimet që mund të lindin midis palëve në procesin administrativ,
  - Kur afatet janë të rëndësishme.
- Ndarja midis grupeve të ndryshme të afateve në bazë të periudhave të ndryshme të kohës.

Në katër paragrafë, neni 56 i KPA-së parashikon se :

1. Përveç kur parashikohet ndryshe nga ligji, afatet caktohen në ditë, muaj ose vite.
2. Skadimi i një afati kohor mund të shënohet edhe si datë e caktuar kalendarike:
  - a- Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve.
  - b- Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj.

Ligjbërësi shqiptar zbaton Konventën Evropiane për Llogaritjen e Afateve Kohore

Dita që fillon çdo procedurë administrative është përcaktuar në nenin 57 të KPA-së "Prezumime për llogaritjen e afateve".

### **F - Presumime për llogaritjen e afateve - Neni 57**

Dita e paraqitjes së kërkesës, për efekt të llogaritjes së afateve procedurale që ecin në dëm të palës, konsiderohet ajo e:

- a. depozitimit të kërkesës në postë, kur kërkesa dërgohet me postë të porositur;
- b. depozitimit të kërkesës në kutinë postare të organit publik;
- c. paraqitjes së kërkesës në degët e institucionit, në prefekturë apo përfaqësitë diplomatike ose zyra konsullore;
- ç. paraqitjes në komandën ose institucionin e ndalimit të personave;
- d. regjistrimit nga pajisja përkatëse për marrjen e mesazheve, nëse dokumenti elektronik dërgohet elektronikisht ose kërkesa në formë të shkruar dërgohet me faks. Ky komunikim nuk passjell humbjen e afateve. Nëse dokumenti i dërguar nuk është i lexueshëm, organi publik njofton pa vonesë dërguesin duke i kërkuar ta ridërgojë në një mënyrë tjetër të përshtatshme.

### **G - Afatet kohore - Përfundime**

Qasja legjislative shqiptare përcakton afatet kohore në procedurat administrative në përgjithësi. Kur afatet kohore nuk përcaktohen me ligj të veçantë, afati për përfundimin e procedimit administrativ është 60 (gjashtëdhjetë) ditë (neni 91, paragrafi 2 i KPA-së). Postulati ligjor latin "Lex specialis derogat legi generali" (Ligji i veçantë shfuqizon ligjet e përgjithshme) zbatohet drejtpërsëdrejti këtu. Periudha gjashtëdhjetë ditore është një kohë e arsyeshme për çdo standard bashkëkohor, megjithatë rregulli i "sa më shpejt që të jetë e mundur" është ende rregulli kryesor.

### **II - HESHTJA E ADMINISTRATËS - MIRATIMI NË HESHTJE**

- Është gjetje ligjore për hyrje në fuqi, kur organi publik nuk njofton vendimin brenda afatit të përcaktuar me ligj apo akt nënligjor për përfundimin e procedurës dhe nuk njofton zgjatjen e afatit ose nuk njofton vendimin brenda afatit të zgjatur, kërkesa konsiderohet si e miratuar.
- Shprehja "do të konsiderohet si e miratuar" jep të njëjtën fuqi ligjore

si "asgjë nuk ka ndodhur". Është njësoj sikur të ketë hyrë në fuqi një akt administrativ i vlefshëm dhe i ligjshëm. Gjetja është pikërisht kjo pjesë e dispozitës: "dhe akti administrativ shkresor i kërkuar si i miratuar në heshtje".

- Duke analizuar çështjen e "heshtjes së administratës" nënkupton së pari të shqyrtojmë çështjen e vendimeve të nënkuptuara administrative.
- Në të vërtetë, në shumicën e rasteve ky vendim që nuk ka pasur përgatitje të veçantë brenda administratës.
- Mund të merret si rezultat i inercisë së administratës dhe rregulli sipas të cilit një heshtje e tillë lind një vendim është mbi të gjitha një rregull i kundërshtueshëm.

#### **A - Heshtja e administratës: Parimet**

Qëllimi i tij nuk është të përmirësojë procesin e vendimeve administrative, por vetëm të lehtësojë ekzekutimin e mjeteve juridike nga palët e interesuara. Shqyrtimi i kësaj çështjeje mbetet ende i dobishëm sepse:

- Vendimet e marra para gjyqtarëve administrativë janë, në përmasa të pranueshme, vendime të nënkuptuara;
- Nëse vendimi i nënkuptuar nuk përfshin ndonjë veprim pozitiv nga administrata, prapë se prapë është rezultat i kërkesës së qytetarit.
- Si pasojë është krijuar kjo "gjetje juridike", sipas të cilës heshtja e administratës në lidhje me një kërkesë të mbajtur gjatë një kohe të caktuar është e barabartë me një vendim. Le të vëmë re këtu se vetëm ligjet ose dokumentet zyrtare mund të specifikojnë se cilën hipotezë zbaton ky rregull. Nuk i takon gjyqtarëve.

Megjithatë ekzistojnë dy masa mbrojtëse.

Në fakt, në mënyrë që të dalë një vendim në heshtje, është e detyrueshme për administratën:

- 1- të ballafaqohet me një «kërkesë»;
- 2- për këtë, të ketë ankim tek "autoriteti kompetent".

Për këto dy pika ka interpretime elastike.

- Sigurisht, kur procedura e paraqitur administratës nuk ka natyrën e një kërkesë (raste vëzhgimesh të bëra në një dosje specifike) ose kur

kjo procedurë është shumë e paqartë për t'u përpunuar (kërkesa drejtuar një ministri që «t'u japë udhëzime vartësve të tij»), prej tyre nuk lind asnjë vendim dhe kundërshtia nuk mund të zgjidhet.

- Por jurisprudenca nuk është aq e repretë / kërkuese. Për shembull, kundrejt një kërkesë për kompensim mund të merret vendim rrëzimi edhe nëse nuk janë specifikuar dëmet për t'u riparuar ose shuma e kompensimit të kërkuar.

#### **B - Heshtja e administratës: përfitimet/dëmet**

- Padyshim u siguron individëve privatë përfitime të konsiderueshme, por edhe disa disavantazhe.
- Përfitimi më i dukshëm është se ai mbron individin nga pasojat e inercisë administrative. Katër muaj pas paraqitjes së kërkesës - ky afat mund të konsiderohet si i arsyeshëm - ai mund t'i drejtohet gjyqtarit për një vendim refuzimi.
- Mekanizmi i vendimit në heshtje mund të ketë një avantazh të dytë, pasi ai mundëson përmbysjen / prapësimin e kushteve në të cilat fillon debati kundërshtues. Në të vërtetë, në raste të tilla objekti i mosmarrëveshjes përcaktohet nga qytetari dhe jo nga administrata. Skadimi i kohës së përgjigjes përcakton kufijtë e debatit, pasi është përmbajtja e kërkesës së qytetarit që përcakton dhe ndikon në përgjigjen e dhënë ndaj vendimit të kundërshtuar.
- Avantazhi i tretë, mjaft i rëndësishëm në një shtet kushtetues, është fusha jashtëzakonisht e larmishme dhe pothuajse e pakufizuar që i hapet kontrollit të juridiksionit administrativ, i cili mund të kryhet jo vetëm për veprimet, por edhe për mosveprimet e autoriteteve publike si dhe për vendimet diskrecionare si për shembull, refuzimi për të filluar procedurat ligjore.
- Por, siç e thamë, mënyra se si funksionon ka edhe të meta.
- Para së gjithash, dhe në rastet kur administrata zgjedh me dashje të japë miratim në heshtje (që mundësinë më të madhe e ka që të kalojë pa u vënë re), në vend që të njoftojë një vendim të qartë, vendimi në heshtje, duke qenë se është krijuar thjesht nga skadimi i afatit kohor, mund të nënkuptojë që kërkesa nuk i është nënshtruar ndonjë shqyrtimi të veçantë.
- Ky afat është e drejtë publike dhe nuk ndërpritet nga pritja e

përgjigjes së administratës.

### **C - Heshtja e administratës - legjislacioni shqiptar**

Le të fillojmë me shembullin e ligjit nr. 119/2014 për të drejtën e informimit që parashikon se qytetarët mund të kenë qasje në informacione të ndryshme digjitale. Këtu do të donim të theksojmë disa pika:

- Nuk përmendet asgjë në lidhje me pikën e fillimit të aplikimit për njohjen me informacionin ... A ka ndonjë konfirmim marrjeje? Ky rast i veçantë parashikohet vetëm në nenin 12 me kushtin e saktë që: «Në rastet kur autoriteti publik, të cilit i drejtohet kërkesa për informim, është i paqartë në lidhje me përmbajtjen dhe natyrën e kërkesës, ai kontakton menjëherë, por gjithnjë jo më vonë se 48 orë nga data e paraqitjes [...]».
- Ky i fundit duhet të përmendë datën e marrjes elektronike së dërgesës nga përdoruesi, emërtimin dhe adresën postare ose adresën e-mail, kur është e përshtatshme si dhe numrin e telefonit të departamentit përgjegjës për këtë çështje. Autoriteti administrativ nuk është i detyruar të dërgojë konfirmim marrjeje për dërgesa abuzive ose të dhëna që mund të rrezikojnë sigurinë e sistemit të tij informativ.
- Por nuk ndalon të parashikojë përjashtime, si p.sh. për autorizimet, policinë, apo edhe për përgjegjësi.

### **D - Heshtja e administratës : mbron të drejtat e qytetarëve**

- Megjithatë, nuk duhet të nënvlerësohet kompleksiteti i këtij sistemi për qytetarët . Është me të vërtetë përgjegjësia e tyre në çdo procedurë administrative për:
  - a) Të përcaktuar autoritetin kompetent e aftë të përpunojë aplikimin e tyre;
  - b) T'ia transmetuar dosjen administratës përkatëse, ta ruajë konfirmimin e pranimit ose ta kërkojë atë nëse administrata nuk e dërgon vetë;
  - c) Të qenë i vetëdijshëm për regjimin e përdorur për aplikimin e tij / saj. Kjo ndodh për disa procedura të ngushta;
  - d) Të kontaktuar administratën për lëshimin e certifikatës që konfirmon vendimin e miratimit në heshtje.

### **III - Anulimi dhe shfuqizimi i aktit administrativ : Nenet 113 dhe vijues të KPA**

Përveç neneve të mëparshme, ekziston një dispozitë specifike në KPA - neni 117 "Afati për anulimin dhe shfuqizimin", i cili në dy paragrafët e tij parashikon sa më poshtë:


- Anulimi sipas nenit 115 dhe shfuqizimi sipas paragrafit të parë të nenit 117 të këtij Kodi, mund të bëhet në çdo kohë (nuk ka afate këtu).
- Sipas paragrafit 2, në çdo rast tjetër, të ndryshëm nga ai i parashikuar në pikën 1, të këtij neni, anulimi ose shfuqizimi mund të bëhet brenda 30 ditëve nga dita kur organi publik është njohur me faktet që çojnë në anulimin ose shfuqizimin, por jo me vonë se 5 vjet nga njoftimi i aktit administrativ. Afati kohor prej 30 ditësh është një kohë e arsyeshme sipas çdo standardi ligjor.

Administrata (autori i aktit ose organi epror) mund të anulojë (efekt prapaveprues) ose të shfuqizojë (për të ardhmen) veprimin e tij kryesisht ose me kërkesë.

Në shumë vende evropiane (Belgjikë, Spanjë, Francë ...):

- anulimi prapaveprues ose shfuqizimi i një akti individual i cili ka krijuar të drejta për palët është i mundur vetëm brenda afatit prej 4 muajsh dhe nëse është i paligjshëm; përjashtim bëhet në rastin e një ndihme publike për një kompani që bie në kundërshtim me ligjin e BE-së.
- anulimi / shfuqizimi i një akti të përfutur me mashtrim është i mundur pa afat (114/3);
- nuk ka afate kohore për anulim ose shfuqizim nëse përfutuesi nuk plotëson kushtet ose ato nuk janë respektuar (115,102/1/ ç).

## Moduli A3 - Përballja me kohën



This project is financed by the European Union

## Moduli A3 - Përballja me kohën



This project is financed by the European Union

Shfuqizimi i një akti të ligjshëm administrativ: nenet 116 dhe 117 të KPA-së

Shfuqizimi mund të bëhet në çdo kohë (neni 117), vetëm nëse shfuqizimi është i domosdoshëm për të parandaluar apo eliminuar një dëmtim serioz të jetës dhe shëndetit të njerëzve apo sigurisë publike dhe kjo nuk mund të bëhet në mënyra tjera që cenojnë më pak të drejtat apo interesat e ligjshëm të fituar të palës; kjo palë do të kompensohet (përveç fitimit të munguar). Në çdo rast tjetër, jo me vonë se 5 vjet nga njoftimi i aktit administrativ. Në Francë, nuk ka dispozitë të barasvlershme, duke pasur parasysh parimin e paprekshmërisë së një vendimi administrativ të ligjshëm, i cili ka krijuar të drejta për një palë.

## Rihapja e procedurave administrative

### PROJEKTI I BINJAKËZIMIT

#### *(Mbështetje për zbatimin e Kodit të Procedurave Administrative)*

**Tema:** *Praktika gjyqësore evropiane për rihapjen e procedurave*

\*\*\* \*\*

#### **Përmbledhje**

Ligji administrativ evropian karakterizohet nga copëzimi i ndjeshëm dhe politika specifike në çdo shtet anëtar për një gamë të gjerë aktorësh të përfshirë. Sistemi ligjor kombëtar evropian paraqet rregulla të ngjashme ose procedura të ngjashme administrative që shpesh janë pa lidhje me njëra-tjetrën. Të dyja këto duhet të krahasohen për nga aftësia e tyre për të siguruar parimet kushtetuese dhe evropiane në bazë të çdo akti ligjor evropian

Parimet dhe kriteret e përgjithshme për zbatimin e tyre zhvillohen nga gjykatat kombëtare ose nga Gjykata Evropiane e Drejtësisë.

**Jurisprudenca** bazohet në përshkrimin e konflikteve specifike që përfshijnë të drejtën administrative evropiane dhe nevojën për të mbrojtur të drejtat subjektive dhe interesin legjitim në atë kontekst. Parimet e përgjithshme të së drejtës mund të mbulojnë teorikisht të drejtat dhe detyrimet që lindin në kontekstin e ligjëbërjes, kontratave, procedurave të planifikimit, sistemeve të shkëmbimit të informacionit, dhe rrjeteve të zbatimit të saj.

Qëllimi i këtij shënimi është të shikojë jurisprudencën evropiane për të identifikuar qasje koherente në çështjet procedurale, veçanërisht në procedurën e rishikimit të akteve administrative (p.sh. rihapja).



## 1. E drejta administrative e Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian

E drejta administrative evropiane u zhvillua gjatë shekullit të njëzetë falë ndikimit të sistemit administrativ francez<sup>1</sup>.

Austria ishte shteti i parë evropian që kodifikoi ligjin e procedurave administrative në vitin 1925.

SHBA-të miratuan Ligjin e Procedurave Administrative (APA) në vitin 1946.

Dukuria e përgjithshme e kodifikimeve kombëtare u rrit në kontekstin e integritetit evropian.

Megjithatë, e drejta evropiane administrative karakterizohet nga copëzimi i fortë dhe nga politikat e veçanta në çdo Shtet Anëtar.

Në disa shtete evropiane ekzistojnë deri ligje të procedurave administrative për nivele të ndryshme të qeverisjes dhe hyrja e tyre në fuqi ka qenë e shkallëzuar.

Në një rast tjetër, disa shtete evropiane kanë qeverisje vendore në nivel rajonesh me pushtet të tyrin legjislativ, p.sh ligji gjerman i procedurës administrative duhet parë në kontekstin e federalizmit kombëtar<sup>2</sup>.

Në Spanjë dhe në Itali, ekziston vetëm një ligj i përgjithshëm kombëtar dhe legjisllacion plotësuar në nivel rajonesh me komunitete autonome (p.sh. Sicilia).

Për më tej, në disa shtete anëtare si Franca dhe Italia, aktet administrative përfshijnë edhe aktet rregullatore (vendime, rregullore ministrore, etj.). Për këto arsye, është logjike që kodifikimi i procedurave administrative aplkohet edhe për këto raste<sup>3</sup>.

### 1.1 ITALIA

Procedurat e rishikimit administrativ janë:

- **Pezullimi administrativ:** Është një masë përmes të cilës, gjatë një procedure auditit/rishikimi për motive mbrojtjeje, zbatueshmëria dhe efektiviteti i një mase efektive pezullohet përkohësisht. Efektiviteti i një akti administrativ pezullohet për arsye serioze dhe për një periudhë të caktuar të nevojshme nga i njëjti organ i cili e ka nxjerrë aktin apo nga një organ tjetër të përcaktuar nga ligji. Afatet

e pezullimit tregohen në aktin e nxjerrë të pezullimit dhe mund të zgjaten apo vonohen për një periudhë kohe apo të shkurtohen në rast të lindjes së nevojës për këtë veprim.

- **Zgjatja administrative:** Është një masë përmes së cilës efektiviteti përfundimtar i afateve të një mase të përhershme, zgjatet më shumë nga sa ishte parashikuar. Zgjatja miratohet përpara së të përfundojë afati i masës së shkallës së dytë.
- **Revokimi administrativ:** Është një masë që do të ndikojë në vlefshmërinë e dokumenteve dhe efektivitetin afatgjatë të tyre, në përfundimin e një procedure për të verifikuar nëse rezultatet e arritura të një mase të mëparshme meritojnë të jenë të ruajtura. Nëse rivendosjen e kërkesës për pjesëmarrje, administrata ka detyrimin të parashikojë kompensimin. Administrata ka detyrimin të parashikojë dwmpshpwrblim nw rast sw revokimi sjell efekte paragjykuese tek palwt e interesuara

Autoritetet publike kërkohen të caktojnë një zyrtar përgjegjës për menaxhimin e procedurës, emri dhe kontaktet e të cilit komunikohen te palët e interesuara në momentin e parë të fillimit të procedurës. Zyrtari mund të jetë personi që miraton vendimin përfundimtar apo një person tjetër. Qëllimi i kësaj dispozite nuk është lejimi i ndarjes midis menaxhimit të procedurës dhe miratimit të vendimit përfundimtar, e rrjedhimisht përforcimit të paanësisë të autoritetit vendimmarrës (Gjykata Evropiane e Drejtësisë ka hedhur poshtë ndarjen midis këtyre dy funksioneve, madje edhe për procedurat e ndëshkimit administrativ- shih shembullin "*Case 100/80 Musique Diffusion Française v. Commission [1983] ECR 1825, paras 6-7*")

Gjatë menaxhimit të procedurës, zyrtari përgjegjës respekton dhe promovon aktivisht të drejtat e palëve të interesuara.

Në Itali aktet e shkallës së dytë karakterizohen duke iu referuar akteve

<sup>1</sup> F. Bignami, *Comparative Administrative Law (E drejta administrative e krahasuar)*, në *The Cambridge Companion to Comparative Law 145-179 (M. Bassani dhe U. Mattei botimi 2012)*.

<sup>2</sup> V. Prof. T. Schmitz, *The administrative procedure in German administrative law (Procedura administrative në ligjin administrativ gjerman)* 2013.

<sup>3</sup> ReNEUAL Rregullat Model në Procedurën Administrative të BE-së 2014.

administrative të mëparshme dhe mund të klasifikohen bazuar në efektin që sjellin si akte me efekte shfuqizuese, si vijon:

- **"annullamento d'ufficio"** (shfuqizim nga organi që nxjerr aktin) ky term konsiston në eliminimin e ish aktit administrativ të pavlefshëm;
- **"revoca"** (revokimi) ky term konsiston në ndërprerjen e efekteve të aktit (të mëparshëm) administrativ të vlefshëm për arsye oportune;
- **"abrogazione"** (shfuqizim) ky term nënkupton ndërprerjen e efekteve të aktit (të mëparshëm) për arsye oportune apo për pajtueshmërinë e përbajtjes;

Në shumicën e rasteve, organi publik mund të vendosë:

- **"sospensione"** pezullim të efekteve të aktit administrative
- **"convalida"**, ky term nënkupton eliminimin e pavlefshmërisë të aktit administrative përmes një deklarate eksplicite të organit që nxjerr aktin apo në raste të tjera organit në nivel hierarkie më të lartë;
- **"conferma"** konfirmim përmes të cilit administrate publike konfirmon vlefshmërinë e një akti të nxjerrë më parë;
- **"ratifica"** (ratifikimi), ky term konsiston në miratimin nga ana e organit kompetente të një akti administrativ;
- **"Conversion"** (konvertim) ky term nënkupton nxjerrjen e një dokumenti administrativ të ndryshëm nga i mëparshmi, me funksion të ngjashëm (apo të njëjtë);
- **"rettifica"** (korrigjim), ky term nënkupton eliminimin në formë retroaktive të parregullive të lidhura me një akt administrativ të vlefshëm.

## 1.2 FRANCA

Ligji francez që rregullon ndërhyrjen e administratës në efektivitetin akteve të nxjerra më parë prej tij, ndërhyrje kjo për shkak të paligjshmërisë apo mundësive të papërdorura të cilat ndikojnë rezultatin përfundimtar të akteve të shkallës së dytë si "anulimi nga ana e zyrës" dhe "revokimi", në thelb përbën dallimin midis akteve që krijojnë ligjin dhe atyre që nuk u atribuohet kjo meritë.

Kjo fushë ka qenë subjekt i vendimeve historike të Këshillit të Shtetit

(*Conseil d'Etat*), nga e cila ka dalë një disiplinë jurisprudence formalisht e dallueshme nga degët e tjera të ligjit kombëtar. Sikur se u përmend më lart, ndryshimi thelbësor i kësaj discipline qëndron tek aktet kundërshtuese të cilat krijojnë të drejta me ato akte të cilat nuk krijojnë të drejta.

Kur flasim për veçantive individual të rastit, mund të vihet re se ky artikulum nuk është një qasje *posteriori operated*, por më tepër është një formë abstrakte klasifikimi që vendos në zbatim gjithmonë jurisprudencën, bazuar në kategori dhe tipologji aktesh.

Për shkak të natyrës së tyre të përgjithshme dhe abstrakte, ato nuk janë "të drejta të krijuesve". Padyshim që në sistemin ligjor francez ekziston mundësia që pushteti ekzekutiv të shfuqizojë- pa kufizim, rregulloret, pavarësisht pritisshmërive si rezultat i vlefshmërisë së tyre. Nëse ka ndryshime në gjendjen faktike të cilat çuan në miratimin e tyre, ose më mirë një ligj i vjetër mbështet parimin e detyrës së administratës, aktet e paligjshme tërheqjen. Procesi i përmendur më sipër mund të zbatohet brenda një periudhe maksimale 4 muajore nga momenti i miratimit të aktit, një afat i cili zbatohet vetëm për ato akte të cilat kanë origjinë në paligjshmëri.

Jurisprudenca franceze thekson parevokueshmërinë e të gjitha akteve të cilat gjenerojnë të drejta.

## 1.3 MBRETËRIA E BASHKUAR

Veprimtaria e Gjykatës Administrative përbëhet nga zbatim i funksioneve të trashëguara prej juridiksionit administrativ të Anglisë dhe Uellsit dhe ushtrimit të kontrollit mbi gjykatat e nivelit më të ulët.

Kontrulli kryesisht ushtrohet nëpërmjet procesit të shqyrtimit gjyqësor dhe lidhet me personat fizikë apo organet që kryejnë funksion publik. Qëllimi i shqyrtimit gjyqësor është të sigurojë që vendimet e organeve ose individëve janë të përshtatshme dhe legjitime; Ata gjithashtu nuk duhet të ushtrojnë kompetencave që Parlamenti nuk u ka dhënë.

Midis të tjerave, Gjykata Administrative mbulon një sërë apelimesh administrative dhe raste të tjera, si vijon:

- Të drejtën që buron nga ligje të caktuara për të apeluar kundër vendimeve të ministrave, qeverive lokale dhe gjykatave;
- Raste që burojnë nga ligji mbi shtetësinë, emigracionin dhe azilin (Akti i Shtetësisë, Emigracionit dhe Azilit), i vitit 2002;
- Apelon kundër vendimeve të caktuara të Gjykatave të Magjistratëve dhe Gjykatës së Krimeve (*Crown Court*);
- Rasteve të *Habeas Corpus*;
- Urdhëron burgim për rastet e shpërfilljes së gjykatës;
- Rastet e lidhura me sjellje të bezdisshme;
- Rastet e lidhura me Aktin *Coroners*, të 1988;
- Organeve të ndryshme që lidhen me parandalimin e terrorizmit, të ardhurat nga krimi, trafiku i drogës dhe çështje të tjera të të drejtës penale

#### 1.4 SPANJA

Spanja miratoi kodifikimin e procedurave administrative në vitin 1889. Në Spanjë proceset e shkallës së dytë zakonisht ndahen në veprime administrative, procese të tërheqjes dhe rishikim i procedurave administrative. Çështja që ka të bëjë me veprimet administrative, e më konkretisht me procedurat e lartpërmendura të shkallës së dytë, trajtohen si rishqyrtim apo rishikim i akteve nga ana e administratës- *ex officio* apo me kërkesë. Shumica e tyre janë shqyrtuar në gjerësisht nga Ligji 4/99.

Edhe pse ka ngjashmëri midis ligjit italian dhe spanjoll, çështja e procedurave për mbrojtjen e të ashtuquajturës vendim në kuadrin e vetë-mbrojtjes në kuptimin strikt dhe të lidhur me Administratën Publike, tregoi një ndryshim të qenësishëm midis dy sistemeve. Dallimi i parë dhe më i rëndësishëm qëndron në faktin se ligji italian nuk ka një kuadër të përgjithshme të lidhur me procesit e rishikimit administrativ, pasi këto institucione janë kryesisht ndërtime doktrinare dhe jurisprudencë, ndërsa ligji spanjoll tradicionalisht ofron një rregullorë ligjore gjithëpërfshirëse. I ashtuquajtur i apel i jashtëzakonshëm i rishikimit është një mjet autonom për mbylljen e masave përfundimtare. Ky mjet mund të përdoret vetëm kur rrethanat që parashikon Ligji i Procedurave Administrative ka sjellë një situatë shteruese. Ky mjet është pasqyrim i një mekanizmi ekzistues

të ngjashëm funksional, i cili mban të njëjtin emër dhe arsyetim të ngjashme në të gjitha zonat juridike spanjolle, e përmes të cilave ju mund të “kërkonti” rihapjen “e një procesi të mëparshëm tashmë të përfunduar dhe kërkonti një analizë të re të gjykatës, që sipas përkufizimit, është i pakundërshtueshëm: gjykimi përfundimtar”. Apeli i rishikuar, i cili nuk duhet ngatërruar me procesin *eponymës* që analizojmë, mund të ngrihet kundër akteve administrative të pakontestueshme, siç janë ato kundër të cilave nuk ka asnjë ankesë të zakonshme administrative.

Rishikimi i ankesës duhet të parashtrohet dhe të vendoset nga organi administrativ që ka nxjerrë aktin, bazuar në një nga arsyet e treguara në nenin. 118.1 të Ligjit të Procedurave Administrative:

- *miratimi i masës ka shkaktuar një gabim faktik, e dukshme në dokumentacionin e procedurës;*
- *paraqitja e dokumente me vlerë thelbësore pas marrjes së vendimit nënvizojnë dështimin e masës së kontestuar;*
- Masat kanë ndikuar mbi dokumentet apo dëshmitë janë deklaruar false me vendim gjyqësor res *judicata*, miratuar para ose pas vendosjes së masës në fjalë
- Masa është ndryshuar pas konstatimit të një rast të abuzimit të pushtetit, korrupsionit, dhunës, skema mashtrues apo tjetër veprim të dënueshme, duke u klasifikuar kështu në praktikën ligjore res *judicata*.

Afatet e aplikimit për rishikim variojnë bazuar në arsyen e palës kërkuese. Nëse ky është aplikimi i parë, afati caktohet katër vite; në raste të tjera afati është 3 muaj nga pranimi i dokumenteve apo kur vendimi i gjykatës ka marrë formë të prerë.

#### 1.5 GJERMANIA

Në Gjermani, revokimi dhe tërheqja e institucionit (procedura të rishikimit të akteve administrative) janë padyshim të ndryshme, edhe pse të dyja këto procedura ndjekin të njëjtat parime të përgjithshme të cilat i japin administratës fuqi rishikuese dhe diskrecion të gjerë.

Masa administrative e tërheqjes (*Rücknahme*) synon ndryshimin e shkeljeve të ligjit të kryera gjatë ushtrimit të funksioneve administrative, ndërsa revokimi ndodh kur vendoset një modifikim i aktit.

Udhëzimet specifike për **procedurat e rishqyrtimit** janë të përfshira në Aktin e Procedurës Administrative, i cili përcakton saktësisht kushtet dhe efektet ligjore të anulimit të zyrës dhe tërheqjes, në varësi të faktit nëse akti në fjalë konsiderohet i favorshëm dhe përfshirja/konfirmimi i një të drejte apo avantazhi domethënës ligjor ose madje edhe të zgjerojë sferën ligjore të aplikantit.

Në këtë kuptim dallojmë dy lloje të masave administrative të favorshme: ato që ofrojnë një përfitim financiar në formën e kapitalit ose ato që janë parakushti i përfitimeve të tilla dhe që përmbahen në formën e masave patrimoniale.

Sistemi ligjor gjerman bazohet mbi supozimin se individi nuk mund mbështesë besimin e tij në efikasitetin e aktit administrativ, në mënyrë më abstrakte mund të themi se:

- (i) Nëse akti administrative është nxjerrë bazuar në mashtrim, dhunë apo korrupsion;
- (ii) Nëse dokumenti është nxjerrë duke u bazuar në deklarata të paplota apo substancialisht të pasakta;
- (iii) Nëse palët e përfshira kanë informacion mbi parregullsi të aktit. Në këto raste akti administrativ do të tërhiqet.

Ndryshe nga praktika e anulimit, revokimi nuk zbatohet për masat ligjore të favorshme pasi ato të jenë bërë të pakundërshtueshme.

Si përfundim, mbështetur mbi doktrinën ligjore mund të themi se "... në mënyrë që tu lejojmë administratës publike një hapësirë më të madhe veprimi për praktikën e tërheqjes së një masë, në rastin kur dalin faktet të reja apo ndryshon kuadri ligjor, rregulli për tërheqjen në realitet është më shumë një disiplinë ndihmuese se sa anulim zyrtar..." (Poteri di autotutela – book by C. Fraenkel Haehlerle).

## **2. Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë.**

Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë u miratua nëpërmjet ligjit nr. 44/2015, datë 30 prill, 2015, në përputhje me nenet 81, paragrafi 2, dhe 83, paragrafi 1 i Kushtetutës. Qëllimi kryesor i kësaj reforme është përkthimi i të drejtave dhe parimeve kushtetuese në rregulla të procedurës administrative që përputhen me *acquis e BE- së*.

Procedura administrative përbëhet nga të gjitha të drejtat dhe detyrimet e subjekteve, palët private dhe publike, të cilat marrin pjesë në procedurën administrative.

Kodi duhet të garantojë të drejtat subjektive dhe interesat legjitime të palëve përmes zbatimit të parimeve të përgjithshme të së drejtës së BE-së, të thjeshtësë së sistemit ligjor dhe të rrisë sigurinë ligjore.

Megjithatë, është e domosdoshme për këtë qëllim të identifikohen praktikatat më të rëndësishme të zbatueshme në vendet anëtare të BE-së përmes analizës së çështjeve evropiane.

Për sa i përket rishikimit të aktit të procedurës administrative ("rishikimi"), në përputhje me nenin 144 të KPA, rishikimi "*është mjeti ligjor administrativ, me anë të të cilit kërkohet anulimi apo ndryshimi i një akti administrativ të nxjerrë apo nxjerrja e një akti administrativ të refuzuar, kundër të cilit ankimi nuk është më i pranueshëm për shkak të kalimit të afatit të parashikuar nga ky Kod*".

Ky mjet administrativ ligjor mund të kërkohet nga palët "*nëse zbulohen rrethana ose prova të reja me shkrësë që kanë rëndësi për çështjen, të cilat nuk dihen dhe mund të dihen prej saj gjatë zhvillimit të procedurës administrative që ka çuar në nxjerrjen e aktit administrativ*" (neni 144, par. 2 i Kodit).

Kërkesa për rishikim duhet të paraqitet brenda 30 ditëve nga dita që pala ka marrë dijeni për shkakun e rishikimit, por në çdo rast jo më vonë se 2 vjet nga dita që ka lindur shkakun e rishikimit. (neni 145 i Kodit). Ky mjet ligjor administrativ zbatohet në përputhje me nenet e KPA- së, më së shumti sipas "Seksionit 4" (Anulimi dhe shfuqizimi i aktit administrativ) të Kodit (nen. 113-118). Kërkesa i dorëzohet organit që ka nxjerrë apo ka refuzuar aktin administrativ, i cili kërkohet që të rishikohet.

## 2.1 Parimi i zbatimit të hapave të ndryshëm në procedurën administrative për rishikimin e procedurës administrative fillestare

- **(1)** Rishikimi është mjeti ligjor administrativ i kërkuar nga njëra palë pranë organit kompetent paraqitet brenda 30 ditëve nga dita që pala ka marrë dënimin për shkakun e rishikimit, por në çdo rast jo më vonë se 2 vjet nga dita që ka lindur shkakun e rishikimit. Në të kundërt, kërkesa për rishikim të procedurës do të refuzohet. Në rastin e ligjit nr. 67/2017, Gjykata Administrative Italiane ka deklaruar se kërkesa e palës nga anulimi i aktit administrativ mund të konsiderohet një kërkesë për organin publik nëse koha dhe mjetet juridike të tjera ligjore janë përdorur (v. TAR Cagliari, n. 67/2017; Consiglio di Stato, Sez. V, n. 5199/2012).
- **(2)** Pala mund të kërkojë rishikim, nëse zbulohen rrethana ose prova të reja me shkrësë që kanë rëndësi për çështjen, të cilat nuk dihenin dhe mund të dihenin prej saj gjatë zhvillimit të procedurës administrative që ka çuar në nxjerrjen e aktit administrativ. Në rastin C-2/06 Kemper, Gjykata e Drejtësisë ka theksuar që neni 10 KE zbaton për një organ administrativ detyrimin për të rishikuar një vendim mbi procedurën administrative përfundimtare, në mënyrë që të marrë parasysh interpretimin përkatës të miratuar nga jurisprudenca komunitare, kur ndodhin një sërë kushtesh. Ky vendim bazohet në parimin e efektivitetit të mbrojtjes gjyqësore e cila, sipas praktikës së përcaktuar (*ex multis*, Case C-222/84 Johnston [1986] ECR 1651, paragrafi 18 to 19, Rasti C 50/00 P, Unión de ECR I-6677, paragrafi 39, rasti C 432/05, Unibet, ECR I-2271, paragrafi 37) përbën një parim të përgjithshëm të së drejtës së Komunitetit për të drejtat themelore të garantuara në Komunitet (Neni 47/1 sipas Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian, shiko gjithashtu Neni 6 dhe 13- Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore).
- **(3)** Pala nuk ka të drejtë të ushtrojë për herë të dytë mjetet juridike administrative për të njëjtin rast ( neni 128 KPA; parimi "*ne bis in idem*"; v. *Van Esbroeck*, C-436/04, 9 marzo 2006, §§ 27 - 36; *Corte*

*di Cassazione italiana*, II sez. Civ, ordinanzainterlocutoria n. 23232, 15 novembre 2016; Cause C-217/15 e C-350/15. Ekzistojnë disa variante të parimit "bis in idem" në ligjin e BE- së, të cilat mund të lexohen në disa punë të ndryshme si *Van Bockel, B., The principle ne bis in idem in EU Law*, Kluëer, 2010. See also *Oliver, P., and Bombois, T., 'Ne bis in idem en droiteuropéen: un principe à plusieurs variantes', Journal de droiteuropéen, 2012, pp. 266 to 272; and Tomkin, J., 'Article 50, Right not to be tried or punished twice in criminal proceedings for the same criminal offence', in Peers, S., Hervey, T., Kenner, J., and Eard, A., The EU Charter of Fundamental Rights: a commentary, Hart Publishing, Oxford, 2014, pp. 1373 to 1412).*

- **(4)** Autoriteti Publik miraton aktin e ri administrativ nëpërmjet "procedurës administrative" sipas neneve të KPA- së, veçanërisht në "Seksionin 4" (Anulimi dhe shfuqizimi i aktit administrativ) të Kodit (neni 113-118).
- **(5)** Në këtë procedurë administrative, krijuar sipas dispozitave të nenit 41 të Kodit, organi publik vepron nëpërmjet zyrtarit përgjegjës të caktuar në përputhje me rregullat e këtij neni (neni 43 KPA).
- **(6)** Zyrtari përgjegjës kryen procedurën administrative dhe në fund propozon me shkrim një vendim përfundimtar. Kjo procedurë e re administrative duhet të garantojë parimet e Kushtetutës dhe parimet e KPA- së. **Parimi përfshin: - parimi i ligjshmërisë; - transparencës dhe informacionit; - parimi i proporcionalitetit; - Parimi i drejtësisë dhe i paanësisë; - Parimi i objektivitetit dhe përgjegjësisë; - e drejta për tu mbrojtur** (Në Itali, një masë që miratohet në kundërshtim me rregullat që rregullojnë procedurën ose formën e instrumenteve, nuk duhet të anulohet nëse, në bazë të natyrës së masës, është e qartë se dispozitat që përmban nuk mund të ishin ndryshe nga ato të miratuara në të vërtetë; *ex multis*, Consiglio di Stato, Sez. II, 29.4.2015, n. 758; Tar Lazio ,se.zlq, 1903/2017; Tar Toscana, Sez. I, 7.5.2016, n. 736) ; - **E drejta për tu dëgjuar; - e drejta për inspektimin e dosjeve (neni 45 KPA); - E drejta për të përfunduar procedurat brenda**

**një periudhe të përshtatshme kohore** [Detyra e autoriteteve të BE-së për të miratuar një vendim përfundimtar brenda një kohe të arsyeshme rrjedh në mënyrë implicite nga neni 265 TFEU (duke i dhënë një zgjidhje për vonesa të panevojshme në vendimarrje) dhe është vërtetuar nga ECJ në shumë raste (Edhe në lidhje me ankesat, shih për shembull rastin C-282/95 P Guérin automobiles v Komisioni [1997] ECR I-1503, para 37). Në nivel kombëtar shih për shembull Ley 30/1992, de 26 de November, de Régimen Jurídico de las Administraciones Públicas y del Procedimiento Administrativo Común (BOE núm. 285, de 27.11.1992), modifica da porúltimavezpor la Ley 27/2013, de 27 de diciembre, de racionalización y sostenibilidad de la Administración Local (BOE núm. 312, de 30.12.2013), Art 42.]; - **Si dhe mbrojtjen e objekteve (private)** (Rastet 46/87 dhe 227/88 Hoechst AG v Komisioni [1989] ECR 2859, para 15, 16); - (Coniglio di Stato 1879/2017; Tar Latina n. 299/2012; Tar Venezia 230/2013).

- **(7)** Për më tepër, bëhet procedura për pjesëmarrjen e publikut dhe të gjitha opsionet dhe zgjidhjet duhet të mbeten të mundshme. Korigjimi në atë fazë duhet ende të lejojë publikun në fjalë që të ndikojë efektivisht në rezultatin e procesit të vendimarrjes (neni 43, 44 dhe 45 CAP; v. fjalja 15.01.2013, Križan, C416/10, EU:C:2013:8, punto 90).
- **(8)** Autoriteti publik mund të korigjojë ose të tërheqë një vendim të paligjshëm administrativ, i cili ndikon negativisht në një palë. Korigjimi ose tërheqja do të ketë efekt prapaveprues (neni 113 dhe 114 i Kodit). Megjithatë, është e rëndësishme që organi publik të marrë parasysh mbrojtjen e pritjeve legjitime dhe gjithashtu parimin e ligjshmërisë, nga njëra anë, dhe parimet e të drejtave të sigurisë dhe mirëbesimit të individëve, nga ana tjetër. Mungesa e sjelljes së pasaktë nga ana e përfituesit të aktit të krijuar për jurisprudencën evropiane përbën vetëm një nga aspektet që duhet të merren parasysh, gjë që në vetvete ishte në të kaluarën e pamjaftueshme për të përjashtuar mundësinë e revokimit të një akti administrativ të paligjshëm (C-14/81, Alpha Steel C-15/85;

C-365/89, Cargill). Sjellja e përfituesit të aktit u bë vendimtare në jurisprudencën e De Compte, pasi konsiderohet e mjaftueshme për të përcaktuar legjitimitetin e mbështetjes së marrësit dhe, në veçanti përputhet me ligjshmërinë e kujdestarisë me mungesën e ndonjë sjelljeje të personit që ka kontribuar në nxjerrjen e aktit të paligjshëm (Gjykata e Drejtësisë, Vendimi i datës 17 prill 1997 për çështjen C-90/95 De Compte; v. Conseil d'Etat case n. 395326, 20.3.2017 Autoriteti publik mund të korigjojë ose të tërheqë një vendim të ligjshëm administrativ që ndikon negativisht në një palë. Korigjimi ose tërheqja do të ketë efekt të ardhshëm.

- **(9)** Ndryshimi, prishja, tërheqja apo lëshimi i një vendimi duhet të kryhet nëpërmjet një akti të ri të shkruar, i cili anulon, shfuqizon, rindryshon, ose plotëson aktin e parë (neni 113, par. 3. dhe neni. 144, par. 1. KPA). Ky vendim miratohet dhe nënshkruhet nga personi i përcaktuar përgjegjës sipas ligjit apo aktit nënligjor (neni 98, KPA).

Akti Administrativ duhet të përmbajë një arsytim. Arsyetimi duhet të përcaktojë hapësirat faktike dhe ato pika në ligj që kanë çuar në marrjen e vendimit nga autoriteti përkatës, pasi ato dalin nga aktivitetet paraprake të gjetjes së fakteve (Italy ligji 241/1990, neni. 3, ex multis Consiglio di Stato, sez. VI, n. 1451/2017 Apelim Administrativ)

## Dokumenti 1: Ankimet administrative dhe forma të tjera të ADR (nivei i thelluar)

### Emri i ekspertit: Z. Dacian Dragos

#### Mjetet ADR në të drejtën administrative

- Ankimet administrative
- Avokati i Popullit
- Ndërmjetësimi
- Arbitrazhi
- Efektshmëria?

#### Ankimi administrativ

- Ankimi administrativ *kundrejt* rishikimit gjyqësor
- Ankimi administrativ
- Atakimi, kundërshtimi, ri-vlerësimi, kritikë
- Ankimi hierarkik, rekursi
- Ankimi kuazi-hierarkik, kontrolli administrativ (*tutella*)
- Ankimet e detyrueshme *kundrejt* atyre fakultative

#### Logjika e ankimit administrativ

- E drejta për t'i bërë kërkesë qeverisë
- Parimi i revokimit
- Ri-vlerësimi i akteve të paligjshme
- Zgjidhja e mosmarrëveshjes pa kosto, e shpejtë, dhe nga ekspertë
- Test për procedurën në gjykatë
- Lehtësimi i ngarkesës së gjykatës
- Heshjtja administrative?
- Objekt i gjerë- ligjshmëria + mundësia
- *Subjektivizëm kundrejt autoritet më i informuar për çështjen*

#### Ankimet e detyrueshme *kundrejt* ankimeve fakultative

- I detyrueshëm në: Danimarkë, Holandë, Hungari, Sllovaki, Slloveni, Poloni, Serbi, Ceki, Rumani, BE
- Fakultativ: Francë, BE, Itali
- Austri: reforma të mëdha, i detyrueshëm

- Spanjë: i detyrueshëm për vendime jo- përfundimtare, fakultativ për vendime përfundimtare

#### Kodi shqiptar i Procedurave Administrative

- **Neni 128** mjetet ligjore administrative
  - E drejta për të ushtruar mjetet ligjore
  - Veprim /mosveprim
  - Të drejta/ interesa
  - Paligjshmëria
  - Ankimi /kundërshtimi /rishikimi
- **Neni 129** Shterimi i mjeteve ligjore administrative
  - Jo organ më i lartë
  - Veprim i drejtpërdrejtë në gjykatë
  - Organi më i lartë – ankimi administrativ i dëmshëm

#### Kodi shqiptar i Procedurave Administrative

- Ankimet administrative kundër akteve apo mos nxjerrjes së akteve (Neni 130 KPA)
- Futja e konceptit të “veprimeve të tjera administrative” përveç aktit administrativ dhe kontratës administrative
- Mundësia për të kundërshtuar veprimet administrative nëpërmjet kundërshtimit administrativ – kemi një mjet të ri ligjor administrativ (Neni 128 i KPA)
- Dhe mjeti administrativ i “i rishikimit”
- Parimi “*no bis in idem*”
- **Neni 130** ankimi administrativ kundër aktit administrativ dhe qëllimi i tij
- Akti administrativ / mos-veprimi
  - Veprimet procedurale- të parashikuara shprehimisht nga ligji
- **Neni 131** përmbajtja e ankimit administrativ kundër aktit administrativ
  - Objekti
  - Organi rishikues
  - Akti administrativ /nuk është nxjerrë?
  - Shkaqet për të gjitha është bërë apeli
    - Interpretimi nga organi rishikues

## Logjika e ankimit administrativ

- E drejta për të paditur qeverinë
- Parimi i revokimit
- Rishikimi i akteve të paligjshëm
- Zgjidhjet jashtë gjykatë pa kosto dhe të shpejta
- Testim i procedurave ligjore
- Ulja e ngarkesës së gjykatave
- Heshjtja administrative?
- Fusha e gjerë e veprimit-ligjshëri + mundësi
- *Subjektivizmi kundër autoriteti më të mirë dhe informuar*

## Afatet

Afatet e arsyeshme

Autoritetet publike kundrejt ankuesve

Itali: 30 – 90 ditë, 120 ditë – pa kufi

Hungari: 15, 30 ditë kundrejt 60 ditë

Slovenia: 15 ditë kundrejt 2 muaj

Holanda: 6 javë kundrejt 6-12-18 javë

Belgjika- i përcaktuar pot indikativ; maksimumi 4 muaj

Polonia- 14 ditë dhe 7 ditë

Rumania – njësoj

Franca: 2 muaj për gjykatën

## Kodi shqiptar i Procedurave Administrative

- **Neni 132** Afati kohor
  - Akti administrativ 30 ditë; Pala e tretë?
  - Mungesë- 7-45 ditë
- **Neni 133** Pasojat e një ankimi administrativ
  - Pezullimi *de jure*
  - Për të gjithë pjesëmarrësit – Paligjshmëria e pjeshme?
  - Përgjashtime :
    - Masat tatimore, policore
    - Interesi- shëndeti, rendi publik dhe të tjera
      - Padi e drejtpërdrejtë në gjykatë 5 ditë
- Ankimi administrativ kundër aktit administrativ brenda 30 ditëve nga marrja dijeni për nxjerrjen e aktit apo refuzimin e tij (Neni 132/1)

- Në rastin e mosveprimit jo më herët se 7 ditë dhe jo më vonë se 45 nga përfundimi i afatit për përfundimin e procedurës administrative (neni 132/2)

## Objekti i rishikimit

- Revokimi- ndryshimi- nxjerrja e një vendimi të ri
- Kompetencat e organeve më të larta hierarkike
- Efekti i kalimit të kompetencave në nivelet më ulëta?
  - Holandë, Gjermani
- *Parimi “non reformation in pejus”?*
  - Jo: Gjermani, Francë, Rumania, Belgjikë, Itali
  - Po: Holanda, Polonia (përveç, tatimeve), Hungaria, Serbia
- Mosmarrëveshja e zgjidhur? Padi për dëmshpërbim?
- Përcaktimi i objektit të rishikimit nga gjykata?
  - Franca, Italia

## Efekti pezullues

- De jure
  - Gjermania, Polonia, Hungaria, Serbia, Çekia
- Me vendim gjyqësor
  - Franca, Holanda, Rumania
- Me vendim të autoritetit publik
  - Italia, Belgjika, Danimarka, Spanja

## Kodi shqiptar i Procedurave Administrative

KPA shqiptar

- Paraqitja e ankimit administrativ ka efekt pezullues mbi ekzekutimin e aktit deri një njoftimin e vendimit mbi ankimin (Neni 133/1 KPA)
- Përgjashtime (në fushën e tatimeve, në lidhje me masat policore, për mbrojtjen e rendit publik, shëndeti publik dhe interesave të tjera publike) (Neni 133/3).

## Ankimi administrativ kundrejt rishikimit gjyqësor

- Fakultativ- ndërprerje e veprimeve të gjykatës
- I detyrueshëm – parakusht për veprim gjyqësor
- Sisteme të përziera



- Austria, Franca, Italia
- Zgjidhja përfundimtare e mosmarrëveshjeve
  - Holanda
- Neni 6 pika 1 KEDNJ – gjykatë e pavarur dhe e paanshme
  - Afate strikt, ankime të detyrueshme
- - KEDNJ – Mbretëria e Bashkuar- Rumania

### Tribunalet administrative

- Organet administrative
- Kuasi-gjyqësore
- MB, Holanda, Danimarka, Franca
- Bordet apeluese të qeverisjes vendore polake
- Tribunalet e prokurimit publik të Gjermanisë dhe Rumanisë

### Efektshmëria

- Holanda : 3% e vendimeve të kundërshtuara përfundojnë në gjykatë; natyrë kuazi- gjyqësore; informaliteti si një politikë reformuese
- Gjermania: më pak se 10% e kundërshtimeve përfundojnë në gjykatë; kundërshtimet ofrojnë mbroje ligjore, pra ato janë të efektshme.
- Franca : Ankimet e detyrueshme janë të efektshme; Përgjithësim?
- Danimarka: 2-3% çështjeve shkojnë në gjykatë, shumë anulime nga organet e apelimit
- Italia: jo efektive, kultura administrative
- MB : procedura common sense
- Serbia: 50-100% efektive; centralizmi i organeve të apelimit
- BE: 70% të ankimeve të mbyllura përpara letrës së njoftimit zyrtar, 80% përpara opinionit të argumentuar, 90% përpara një vendimi gjykatë

### Kodi shqiptar i Procedurave Administrative

- **Neni 134** Organi ku drejtohet ankimi
  - Akti Administrativ :
  - Organi nxjerrës


- Organi më i lartë /tjetër -nxjerrës
- Mosveprime:
- Organi më lartë/ tjetër, raporti nga organi nxjerrës

- **Neni 135** Kushtet për pranueshmërinë e ankimit
  - E pa përjashtuar shprehimisht nga ligji;
  - *locus standi (legjitimi)*
  - Brenda kohës së përcaktuar
  - Çdo kusht tjetër të shprehur shprehimisht në ligj
- **Neni 136** Procedura e shqyrtimit të ankimit nga organi publik kompetent.
  - Aksesueshmëria
  - Ligjshmëria /përshtatshmëria
  - Hetimet
  - Anulimi /ndryshimi /revokimi /nxjerrja
  - Të drejtat e palëve të treta
  - Refuzimi
    - Dërgim tek organi më i lartë, pa vonesë
- **Neni 137** Procedura e shqyrtimit të ankimit nga organi më i lartë
  - Hetimet shtesë
  - Ligjshmëria /përshtatshmëria
  - Anulimi /modifikimi /revokimi/ nxjerrja
  - Të drejtat e palëve të treta?
  - Refuzimi
    - Pjesa urdhëruese /arsyetimi
    - Parimi “*non reformatio in pejus*”
- **Neni 138** Ankimi kundër mosveprimit administrativ
  - Aksesueshmëria/themeli
  - Hetimet shtesë
  - Raporti nga organi nxjerrës
- **Neni 139** Përmbytja dhe pasojat e zgjidhjes së mosmarrëveshjes
  - Ex tunc

- Arsyetimi
- **Neni 140** Afati për njoftimin e aktit dhe zgjidhjen e ankimit
  - 30 ditë, zgjatja e justifikuar, vdekja e palës- jo zgjatje
- **Neni 141** Objekti u kundërshtimit administrativ
  - Pushimi/shuarja e kryerjes së një veprimi tjetër administrativ (ORGANI KOMPETENT)
  - Kryerja e një veprimi tjetër administrativ për të cilin ka të drejtë pala, nëse një veprim i tillë kërkohet nga pala, por organi publik nuk ka vepruar; ORGANI MË I LARTË (Neni 143)
  - Tërheqja apo ndryshimi i një deklaratë publike (ORGANI KOMPETENT)
  - Deklarimi si i paligjshëm i një veprimi tjetër administrativ dhe ndreqja e pasojave të tij (ORGANI KOMPETENT)
  - Shërbime publike të tërthorta- detyra rregullatore ose mbikëqyrëse
- **Neni 142 afati - 15 ditë**
- **Neni 144 Rishikimi (Rihapja)**
  - Asnjë ankim nuk është më i pranueshëm për shkak të mbarimit të afatit
  - Zbulohen rrethana apo prova të reja shkrese që janë të rëndësishme për çështjen, të cilat nuk janë ditur apo nuk mund të ishin ditur nga ajo gjatë zhvillimit të procedurës administrative që ka çuar në nxjerrjen e aktit administrativ
  - 30 ditë dijenia /2 vjet ngjarja
  - Organi kompetent
  - Not on court administration

Investigation, recommendation, report

## Avokati i Popullit



Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian

### Llojet

- Gjermania dhe Italia - Avokati rajonal apo lokal i popullit
- Shumë avokatë populli- jo hierarki, të pavarur
  - Avokati i popullit i specializuar- për fëmijët, arsimin, pensionet
  - Vendor - kombëtar (primus inter pares) - bashkëpunimi
- (Spanja jugore), Qendrore (Polonia, Hungaria), Evropa Jug-lindore (Rumania, Sllovenia, dhe Kroacia) - mbrojtja e të drejtave të njeriut.
- Austria, Serbia, dhe pjesërisht edhe Danimarka - vlerësimi i kërkesave ligjore procedurale dhe materiale
- Evropa perëndimore - Holanda, Belgjika, MB, ose Danimarka - vlerësimi i sjelljes apo qëndrimit të administratës kundrejt një koncepti të përgjithshëm normativ siç është ai i një administrate të mirë apo të përshtatshme

### Marrëdhënia me gjykatat

- Rishikimet e pavarura
- Afatet kohore të pavarura
- Mos vënia në pikëpyetje e vendimeve gjyqësore (BE)
- Nuk ka hetim nëse ka një mjet ligjor gjyqësor të disponueshëm (MB, Holandë)
- Paralel me procedurat gjyqësore (Çekia, Rumania)
- Gjykatat mund të vlerësojnë ligjshmërinë e vendimeve të Avokatit të Popullit në MB dhe BE (dëshmipërblimin)

### Roli

- **Hartuesit e standardeve normative**
  - Avokati kombëtar i Popullit i Holandës, Avokati parlamentar i Popullit i MB, Avokati parlamentar i Popullit i Danimarkës, Mbrojtësi publik i të drejtave të njeriut në Çek i, apo mbrojtësi i qytetarëve në Serbi merren në praktikën e tyre me standardet e administratës së mirë
  - Të varur nga mbajtësit e pozicionit
- **Institucionet e të drejtave të njeriut**
  - Parimet e Parisit siç janë vendosur në shtojcën e Rezolutës

së Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së 48/134;

- Avokati rumun i Popullit, Avokati sllovak i Popullit, apo Mbrojtësi polak i të drejtave të Njeriut.

- **Mekanizmi i kontrollit të administratës**

- Parimet e Parisit; Avokati i Popullit i Rumanisë, Avokati i Popullit i Sllovenisë, apo Mbrojtësi polak i të Drejtave të Njeriut; i japi mbrojtje individëve kundër administratës (shtetërore) dhe zgjidhje të pavarura dhe të paanshme të mosmarrëveshjeve.

### **Avantazhet**

- Fleksibiliteti
- Informaliteti
- Teknikat e hetimit- ndërmjetësimi, pajtimi
- Qasja pro-aktive- hetimet me iniciativën e vet
- Mënyra inkuizitore (jo kontradiktore si disa gjykata)
- Shterimi paraprak i procedurës së ankimit administrativ
- Probleme strukturore të administratës
- Rekomandim jo i detyrueshëm ligjërish- mund të jetë një pikë e fortë.
- Kosto e ulët, zgjidhje e shpejtë e mosmarrëveshjeve
- Kompetenca shtesë: kushtetutshmëria e ligjeve, propozimeve legjislativë

### **Dobësitë**

- Karakter jo detyrues i rekomandimeve
  - Ndarje perëndimore- Lindore/ Jugore
  - MB- refuzimi i arsytuar siç duhet
- Personalizimi i pozicionit
- Kompetenca dhe kufij të përcaktuar nga ligjvënësi
  - Koncepti i administrimit të mirë
- Hetimet e gjykatës mund të ndalojnë hetimet e Avokatit të Popullit ose mund ti pezullojnë ato
- Më pak çështje se sa në gjykata

### **Arbitrazhi**

- *Arbitrazhi është një teknikë ku palët në mosmarrëveshje e referojnë mosmarrëveshjen e tyre tek një ose më shumë persona (arbitra) vendimet e të cilëve ata bien dakord se do të jenë të detyrueshme për ta;*
  - *Mosmarrëveshjet tregtare, transaksionet ndërkombëtare tregtare, çështjet e konsumatorit dhe të punësimit.*
  - *Arbitrazhi në të drejtën administrative - i rrallë - mosmarrëveshjet që i ngjajnë mosmarrëveshjeve të së drejtës private - kontrata publike-private, koncesionet, dhe prokurimi - Jo mosmarrëveshje klasike të së drejtës administrative*

### **Ndërmjetësimi**

- Zgjidhje e bazuar te interesi, e shpejtë, e lirë, dhe jo formale e llojeve të ndryshme të mosmarrëveshjeve
- Bazuar në pëlqimin e lirë të vazhdueshëm të të gjithë palëve në mosmarrëveshje
- Ndërmjetësi nuk ka autoritet për të imponuar vendime apo masa të tjera tek palët
- Zgjidhje e orientuar nga e ardhmja për mosmarrëveshjen (pajtimin), duke i lejuar palëve kështu që të ecin përpara dhe të vazhdojnë bashkëpunimin e tyre
- Ndërmjetësi - i pavarur, neutral
- Konfidencialiteti, sekreti

### **Influencat Evropiane**

- Nuk ka një Akt Procedural Administrativ Evropian - një mandat për të kodifikuar rregulla të përgjithshme në të drejtën administrative (procedurale) - Neni 298 TFEU - e drejta themelore për një administratë të mirë e parashikuar në Nenin 41 CFREU bazuar në Kodet e Sjelljes së Mirë Administrative të hartuara nga Avokati i Popullit Evropian, Parlamenti dhe Komisioni Evropian
- Parlamenti Evropian "Grupi i Punës për të Drejtën Administrative të BE (ëGAL)" ka publikuar një dokument pune "Gjendja aktuale dhe perspektivat e së drejtës administrative të BE-së" në 19 tetor 2011
- Rek (2001)9 i miratuar nga Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës

më datë 5 Shtator 2001 për alternativat e mosmarrëveshjeve ndërmjet autoriteteve administrative dhe palëve private

- Direktiva e ndërmjetësimit- mosmarrëveshjet ndërkufitare civile dhe tregtare.
  - Gjermania – edhe nëse nuk është ndërkufitare, administrative

### **Ndryshimet ligjore për përdorimin e ndërmjetësimit**

- Marrëdhënia administratë – qytetarë:
  - Asimetrike, autoritare dhe hierarkike
  - Eksperienca, mjetet financiare, ekspertiza ligjore
  - Akti administrativ/ kontrata administrative (Gjermani, Ceki)
- Rregullimet bashkëpunuese?
  - Ekzekutivi nuk është në gjendje të kujdeset për zbatimin e interesit publik pa ndihmën e qytetarëve të tij.
  - Qytetarët nuk janë vetëm objekte të veprimeve të administratës
- Treshja: interesi publik- kompetenca (pushteti publik) -shteti i së drejtës
- Interesi i palëve të treta- përpjekja për të përdorur ADR
- Barazia, Transparenca, Afatet kohore

### **Holanda**

- Teknikat e ndërmjetësimit – pjesë e procedurës së brendshme të rishikimit apo ankimit administrativ.
- Ministria e brendshme holandeze e angazhuar aktivisht.
- Modeli i qasjes informale pro-aktive.
- Një nëpunës publik që siguron kontakt të shpejtë dhe të drejtpërdrejtë me qytetarët e interesuar (telefonatë apo takim formal) dhe përdorimi i aftësive komunikuese si të dëgjuarit, përmbledhjes, dhe marrjes në pyetje me një qasje të hapur, të paanshme dhe disa teknikave të caktuara të menaxhimit të konfliktit.
- Rezultatet – e matura nga përqindja e procedurave të brendshme të rishikimit të iniciuara që janë anuluar pasi ishte zbatuar qasja janë shumë pozitive.

### **Austria, Rumania**

Austria:

- Procedura formale e kundërshtimit pothuajse ishte hequr plotësisht nga sistemi administrativ austriak i gjykimit, procedura të reja administrative të rishikimit gjatë procedurave gjyqësore
- Rëndësia potenciale e mundësisë së autoritetit administrativ për të ndryshuar në mënyrë vullnetare, apo të tërhiqte vendimin e kundërshtuar nën dritën e kundërshtimeve kundër tij

Rumania:

- Kodi i ri i procedurës civile 2012 – sesion para-gjykimit për të informuar palët rreth mundësive të ndërmjetësimit dhe rekomandon përdorimin e tij; procedurat gjyqësore lejohet të vazhdojnë nëse palët kanë refuzuar ndërmjetësimin; jo kushtetuese 2014
- Një akt ligjor i veçantë për ndërmjetësimin 2006

### **Gjermania**

- Shfuqizimi i zgjeruar i procedurës së kundërshtimit nga German Lander
- Një varietet veprimesh jo formale nga autoritetet administrative për të shmangur procedura të panevojshme përpara gjykatave administrative.
- Fton palët e prekura që të përdorin të drejtën për të bërë kërkesë për të hapur komunikime jo formale për vendimet e pa kundërshtuara.
- Direktiva e Ndërmjetësimit e BE – Akti për nxitjen e ndërmjetësimit dhe metodave të tjera të Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve jashtë gjykatës.
- Gjykatave administrative u lejohet që tu propozojnë palëve që ti drejtohen ndërmjetësimit dhe të pezullojnë procedimet për aq kohë sa zgjat ndërmjetësimi
- *Guterichter*, i cili nuk është kompetent të vendosë mbi mosmarrëveshjen ligjore me vendim gjyqësor, por mund ti

drejtohet ndërmjetësimi dhe të gjithë metodave të tjera të mundshme të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve

### **Mbretëria e Bashkuar**

- Politika e "Transformimit të Shërbimeve Publike" – për të zhvilluar një gamë politikash dhe shërbimesh që, sa më shumë të jetë e mundur, do të ndihmojnë njerëzit që të shmangin mosmarrëveshjet ligjore në radhë të parë dhe të ofrojnë zgjidhje të përshtatura kur ato nuk munden
- Protokollit Para-padi për Rishikimin Gjyqësor : palët në konflikt duhet të marrin në konsideratë nëse disa forma të ADR do të ishin më të përshtatshme se konflikti gjyqësor dhe, nëse është rasti, të angazhohen që të bien dakord se çfarë forme duhet të miratojnë. Të dyja palët mund të detyrohen nga gjykata që të ofrojnë prova që mjetet alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjes së tyre janë marrë në konsideratë për këtë arsye konflikti gjyqësor duhet të jetë mjeti i fundit dhe paditë/ pretendimet nuk duhet të nxirren në mënyrë premature kur një zgjidhje është ende duke u eksploruar në mënyrë aktive. Palët paralajmërohen që nëse nuk ndiqet protokollit, gjykata duhet të marrë në konsideratë këtë sjellje kur përcakton shpenzimet.
- Megjithatë, detyrimi që rishikimi gjyqësor duhet të paraqitet në kohë dhe në çdo rast jo më vonë se 3 muaj pasi shkaqet për të bërë këtë padi janë krijuar për herë të parë dhe më tej shprehet se askush nuk duhet të detyrohet të përdorë ADR

### **Kodi shqiptar i Procedurave Administrative**

- Neni 69 -Pajtimi i palëve
  - Gjatë gjithë zhvillimit të një procedure administrative
  - Palët kundërshtare
  - Përpiqen që të pajtojnë palët në procedurë
  - Nëse lejohet nga natyra e çështjes.
  - Në formë të shkruar – e nënshkruar nga palët hyn plotësisht në fuqi.

- I njëjti efekt me atë të aktit administrativ
- Organi publik kompetent nuk pranon pajtimin ndërmjet palëve në procedurë, nëse pajtimi është në dëm të interesave publike apo interesave të ligjshme të personave të tjerë fizike apo juridikë.

### Shtojca 3:

## Materiale ndihmë për të përgatitur shembuj dhe raste studimi

### METODOLOGJIA PËR KRAHASIMIN E KPA

Dokumenti 1: METODOLOGJIA PËR KRAHASIMIN E KPA (niveli avancuar/për menaxherët) Emri i ekspertit: Z. Timothée Paris

Po hartoni një ligj të ri?

### Po ndryshoni dispozitat ligjore ekzistuese?

Mos harroni Kodin e Procedurave Administrative!!!



Katër hapat që nuk mund të anashkaloen për të krahasuar një legjislacion të posaçëm me kodin e procedurave administrative

#### Hapi 1

Identifikoni dispozitat e ligjit të posaçëm që mund të ngrenë pyetje

**Kodi i Procedurës Administrative (KPA) është... kod Procedure ... prandaj, në parim, vetëm dispozitat procedurale të vendosura në ligjet e posaçme duhet të krijojnë rrezik për mbivendosje ose përplasje. Hapi i parë është, pra, të identifikohen dispozitat procedurale në ligjin e posaçëm dhe të përqendrohemi në to në mënyrë specifike.**

**Një zgjidhje e mirë për këtë hap është të shfletoni ligjin e posaçëm, duke patur parasysh kapitujt kryesorë të KPA-së dhe të pyesni veten: a ka ligji im i veçantë ndonjë dispozitë që lidhet me këto aspekte:**

*Dispozitat e përgjithshme, Delegimi dhe zëvendësimi i kompetencave, paanshmëria e administratës publike, pjesëmarrja në procedurat administrative, dispozitat e përgjithshme mbi procedurat administrative (fillimi, komunikimi, procedura me kërkesë), të drejtat e palëve, njësimi dhe vërtetimi i nënshkrimit, afatet, shtyrja dhe rivendosja në afat, kërkesa dhe paraqitja e saj, çështjet paraprake dhe vendimet e ndërmjetme, vendimmarrja e përbashkët dhe ndihma ndërmjet organeve publike, pikat e shërbimit me një ndalesë, hetimi administrativ, përfundimi i procedurës administrative...*

#### Hapi 2

Në parim, duhet të shmangni sa më shumë që të jetë e mundur futjen e dispozitave mbi procedurat administrative në legjislacion e posaçëm.

**KPA është ligji i përgjithshëm mbi procedurat administrative. Ai do të jetë e zbatueshëm përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe nga ligjet e posaçme. Përveç kësaj, KPA përmban të gjitha dispozitat e nevojshme për të organizuar procedurat administrative. Prandaj, në parim, duhet të shmanget sa më shumë të jetë e mundur futja e rregullave mbi procedurat administrative në ligjet e posaçme (përveç situatave në të**

cilat KPA shprehimisht i referohet ligjit të posaçëm - siç janë afatet kohore për shembull).

Thënë ndryshe, **KPA jua bën jetën më të lehtë**

**Mos harroni se ligjet lexohen dhe zbatohen nga jo-juristë: nëse legjislati i posaçëm nuk përmban rregulla procedurale, që lexuesit e ardhshëm të mund të kuptojnë, mund të jetë e dobishme të futet një referencë e përgjithshme që e lidh atë me KPA (për shembull në nenet e para "dispozita të përgjithshme").**

**Për shembull:** "Ky ligj zbatohet në përputhje me kodin e procedurave administrative".

**E thjeshtë, apo jo?**

Kjo mund të bëhet edhe në nene specifike në të cilët ju referoni ose përjashtoni KPA (për shembull: "siç përcaktohet nga neni X i KPA, afati kohor do të jetë 30 ditë").

### Hapi 3

Pesë rekomandime të përgjithshme për të shmangur konfliktet ose mbivendosjet.

**Nëse keni ndërmend të vendosni ose mbani rregulla procedurale në ligje të posaçme**



**Rekomandimi 1: Sigurohuni që përjashtimet nga rregullat e përgjithshme procedurale të lejohen nga KPA**

*Për shembull, KPA lejon që ligjet të përcaktojnë afate kohore, të përcaktojnë forma të tjera procedure nga ato të miratuara nga Kodi, të përjashtojnë parimin që procedurat administrative janë falas, të ndalojnë zgjatjen e afateve kohore ...*

*Por KPA nuk lejon që ligjet e posaçme, për shembull, të vendosin përjashtime të tjera mbi të drejtën për t'u dëgjuar nga ato të parashikuara nga neni 89 i saj.*

**Rekomandimi 2: gjithmonë të mbahet parasysh se rregullat e posaçme procedurale respektojnë parimin e domosdoshmërisë dhe deburokratizimit**

Këto parime janë përcaktuar si parime të përgjithshme të pashmangshme në nenet 11 dhe 18 të KPA. Ato gjithashtu pranohen përgjithësisht si parime themelore në të drejtën ndërkombëtare. Këtu ngrihen pyetjet e mëposhtme:

- A ekziston një domosdoshmëri e vërtetë për të përcaktuar rregulla specifike (pse të mos i përmbahemi rregullave të përgjithshme)?
- A janë ato rregulla të reja të vulltshme?
- A nuk po krijojnë një barrë të veçantë për qytetarët / shoqëritë?
- A mund të justifikoni mbi baza objektive dallimet midis rregullave specifike dhe rregullave të përgjithshme?

**Rekomandimi 3: ligji do të lexohet dhe zbatohet nga jo-juristë, prandaj duhet të jeni sa më të qartë dhe të saktë që të jetë e mundur dhe t'i referoheni KPA-së**

Mos hezitoni të shkruani shprehimisht, kur është e mundur "në përputhje me nenin x / kapitullin Y të KPA"; "Duke përjashtuar nenin x / kapitulli i KPA" ...) në secilin nen...

Kjo gjithashtu do të ndihmojë gjyqtarin administrativ të interpretojë dispozitat në kuptimin e saktë siç i keni menduar.



**Rekomandimi 4: nëse nuk ekzistojnë, mos harroni të përfshini dispozita që specifikojnë cilat organe publike janë kompetente për marrjen e vendimeve administrative dhe për rrjedhojë të zhvillojnë procedurën dhe t'u përgjigjen qytetarëve**

Kujtesë: siç përcaktohet në nenin 23 të KPA çdo organ administrativ ka detyrën të verifikojë kompetencën e tij më parë.

**Rekomandimi 5: mbani parasysh se në kodin e procedurës administrative çdo veprim apo mosveprim (heshtje) i administratës mund të lindë një vendim administrativ ... pra gjithmonë mendoni për pasojat procedurale të çdo dispozite ...**

Sigurohuni që qëllimi juaj të jetë zbatimi i KPA kur përshkruani kompetencat e një organi / personi administrativ pa përcaktuar rregulla të veçanta procedurale.

Specifikoni pasojat e mosnjohimit të një vendimi administrativ, nga ana e administratës, në afatet kohore të përcaktuara në përputhje me nenin 97 të KPA.

## Hapi 4

Çështje specifike ose pyetje që duhen trajtuar:

### Parimet e përgjithshme



1. A e kërkon natyra ose fusha e mbuluar nga legjislacioni specifik që procedurat administrative të kryhen në një gjuhë të ndryshme nga gjuha shqipe? Nëse po, legjislacioni e përmend atë qartazi. Shih KPA neni 20.

2. A garanton plotësisht procedura e parashikuar nga legjislacioni i posaçëm parimin e mbrojtjes së të dhënave? Kini kujdes, sidomos, për kohëzgjatjen e ruajtjes së të dhënave.

### Dispozitat e përgjithshme për procedurat administrative

3. A kërkon natyra ose fusha e mbuluar nga legjislacioni i posaçëm përcaktimin e detyrimit që organi administrativ të fillojë procedurën administrative? Nëse po, legjislacioni duhet ta përmendë këtë qartazi. Shiko nenin 41 të KPA.

4. Sigurohuni se legjislacioni i posaçëm nuk dëmton dispozitat e KPA (nenin 44) i cili kërkon që organet administrative të njoftojnë palët me shkrim për korrigjimin e gabimeve në kërkesat e tyre (dispozitë e pashmangshme e KPA).

### Të drejtat e palëve gjatë procedurës administrative

5. A kërkon natyra ose fusha e mbuluar nga legjislacioni i posaçëm që të kufizohet e drejta e palëve për t'u njohur me dosjet? Nëse po, specifikoni këto kufizime, të cilat duhet të jenë të përshtatshme dhe proporcionale.

6. Jini të vetëdijshëm se KPA nuk autorizon ndonjë kufizim në të drejtën e palëve për të paraqitur mendime apo prova gjatë procedurës.

### Afatet kohore për palët



7. A përcakton ligji i posaçëm ose akti nënligjor afatet kohore që palët të kryejnë veprimet procedurale? Në parim kjo gjë duhet bërë sipas nenit 53 të KPA.

8. Nëse është e nevojshme, ligji i posaçëm ose akti nënligjor përcakton gjithashtu nëse afatet procedurale mund të zgjaten (pa ndonjë specifikim, nuk do të jetë e mundur zgjatja e afatit).

9. Nëse është e nevojshme, ligji i posaçëm gjithashtu specifikon qartë nëse rivendosja në afat është e përjashtuar (pa ndonjë specifikim, rivendosja do të jetë e mundur).

10. Jini të vetëdijshëm se rregullat për llogaritjen e afateve përcaktohen nga KPA (dhe nuk lejohet asnjë përjashtim).

### Kërkesat dhe paraqitja e tyre

11. Does the nature of or the domain covered by the specific legislation require setting out a specific form for the request, (apart from writing or verbally)? If so, specify it. See article 58 of the CAP.

12. Be aware that the procedural rules for the submission of requests, as well as for registration and certification of requests, correction of inaccuracies in requests and for the right to complete or amend a request are set out by the CAP and no derogation is permitted.

13. Be aware that One-stop-shop service points, when they have been created, are fully substituted to the competent administrative body (ies)

towards the interested persons in the administrative procedures.


### Hetimi administrativ dhe barra e provës



14. Jini të vetëdijshëm se KPA nuk autorizon ndonjë përjashtim nga detyrimi i organit kompetent administrativ për të hetuar kryesisht të gjitha faktet dhe rrethanat për zgjidhjen e çështjes.

15. Jini të vetëdijshëm se rregullat për barrën e provës, veçanërisht në rastin e diskriminimit, janë përcaktuar nga KPA. Asnjë përjashtim nuk lejohet. Shiko nenin 82 të KPA.

### E drejta për t'u dëgjuar



16. E drejta për t'u dëgjuar në procedurat administrative është e drejtë pothuajse absolute: ligjet e posaçme mund të krijojnë përjashtim nga kjo e drejtë, siç përmendet në nenin 89 të KPA, por këto përjashtime duhet të jenë plotësisht të arsyetuara, të përshtatshme dhe proporcionale.

17. Ligjet e posaçme ose aktet nënligjore mund të përcaktojnë afatet kohore për ushtrimin e së drejtës për t'u dëgjuar. Shiko nenin 87 të KPA.



## Përfundimi i procedurës

18. A duhet që ligji i veçantë të përcaktojë një afat kohor për të përfunduar procedurën në afat të ndryshëm nga 60 ditë? Nëse po, a janë ato afate kohore të përshtatshme dhe proporcionale? A i mundësojnë administratës të bëjë një vlerësim korrekt të kërkesave? Shih nenet 90 dhe 91 të KPA.

19. A e kërkon natyra ose fusha e ligjit të posaçëm ndalimin e shtyrjes së afateve

kohore? Nëse asgjë nuk specifikohet, një shtyrje është e mundur sipas nenit 92 të KPA.

20. A kërkon natyra ose fusha e ligjit të veçantë zbatimin e rregullave të miratimit të heshtur? Nëse po, duhet ta specifikojë qartazi. Shih nenin 97 të KPA. Nëse asgjë nuk është e specifikuar, heshtja në parim nuk lejohet. Megjithatë, moskthimi i përgjigjes nga administrata do të çojë në mohimin e kërkesës.

## Aktet administrative

21. Duhet të kihet parasysh se ligjet e posaçme nuk mund të ndryshojnë nga KPA përsa i takon kushteve të kërkuara për arsyetimin e aktit dhe, në shumicën e rasteve, për kushtet e kërkuara për formën e aktit. Shih nenin 98 deri 101 të KPA.

22. Vetëm në rrethana të jashtëzakonshme dhe me kusht që përfundimi i jetë i përshtatshëm, proporcional dhe i justifikuar, ligje të veçanta mund të përcaktojnë një formë tjetër nga ajo me shkrim, elektronike apo verbale, ose mund të specifikojnë se akti nuk do të përmbajë nënshkrimin, emrin dhe mbiemrin e zyrtarit përgjegjës, ose kreut dhe sekretarit të organit kolegjial.

## Hyrja në fuqi e një akti administrativ

23. Kushtet dhe mënyrat për hyrjen në fuqi të akteve administrative janë përcaktuar nga KPA. Ligjet e veçanta nuk mund të bëjnë përfundim prej tyre.

24. Nëse është e nevojshme, ligje të veçanta megjithatë do të përcaktojnë mënyrën e publikimit të akteve administrative.

**Ligjshmëria, pavlefshmëria, korigjimi, anulimi dhe shfuqizimi i akteve administrative.**

25. Kushtet për ligjshmërinë, pavlefshmërinë, korigjimin, anulimin dhe shfuqizimin e akteve administrative përcaktohen nga KPA. Prandaj, legjislacionet e veçanta duhet të shmangin përmendjen e këtyre kushteve.

## Kontratat administrative

26. A kërkon natyra ose fusha e ligjit të veçantë që forma kontraktuale të ndalohet? Në këtë rast, duhet përmendur në mënyrë të qartë. Shih nenin 119 të KPA.

## Ankimi administrativ

27. A kërkon natyra apo fusha e ligjit të veçantë që ankimet administrative të përfundohen? Nëse është kështu, ligji i veçantë duhet ta përmendë atë në mënyrë të qartë. Nëse jo, ankimi administrativ do të jetë i mundur, siç parashihet me nenin 130 të KPA.

## Hapi 5

Së bashku jemi më të mirë!



Hartimi i një ligji të ri si dhe ndryshimi i një ligji ekzistues është **punë ekipi**. Të gjitha konsultimet që bëhen, për shembull që nga ministritë e linjës deri në administratën e kryeministrit ose ndërmjet departamenteve të ndryshme ministrore, kanë vetëm një qëllim: të bëjnë ligjin më të mirë të mundshëm për qytetarët. Pra, nëse keni pyetje, dyshime, vështirësi (...) me kodin: **bëjini pyetje departamentit kompetent ministror duke përdorur dispozitat e bashkëpunimit në vendimmarrje të organeve publike!! public administrations!!**

## Formularë tip për komunikimin me administratën

### Emri i ekspertit: Z. Yves Doutriaux

#### Dokumenti 1: Shembuj për formën e vendimit administrativ

**Shënim: Këto formularë tip janë shembuj të cilat duhet të përshtaten në varësi të situatës dhe bazuar në ligjin Nr. 8503/1999 për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare, ligjin Nr. 9880/2008 për nënshkrimin elektronik, ligjin Nr. 9154/2003 për arkivat dhe rregulloret e brendshme të institucioneve.**

Kodi i Procedurës Administrative -nenet 98,99,131, 132

EMRI I ORGANIT PUBLIK KOMPETENT  
EMRI, MBIEMRI I NËPUNËSIT CIVIL PËRGJEGJËS I NGARKUAR ME ÇËSH TJEN (nëse është e përshtatshme, në varësi të politikës së organeve publike për personalizimin e nëpunësve civilë, pasi nuk ka detyrim nga KPA)

ADRESA E ORGANIT PUBLIK (adresa fizike , adresa elektronike, numri i telefonit)

NUMRI I REGJISTRIMIT TË HETIMIT ADMINISTRATIV kryesisht/ose numri i KËRKESËS xxxx

EMRI, ADRESA(T) E PALËVE

DATA DHE NUMRI I VENDIMIT ADMINISTRATIV yyyyy

BAZA LIGJORE (ligji, akti nënligjor, numri (at) dhe data (t), nenet...)

ARSYETIMI:

BAZUAR NË PROVAT E MËPOSHTME FAKTUALE TË VLERËSUARA PAS SHQYRTIMIT ADMINISTRATIV ....

SIPAS DISPOZITAVE TË LIGJIT (eve), AKTIT( eve) NËNLIGJORE numër, datë e ligjit, aktit nënligjor QË ZBATOHEN NË KËTË RAST

DISPOZITIVI:

ORGANI ( emri i organit publik kompetent të përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm i ministrisë/kryetari i organit kolegjal ...) VENDOSI SI MË POSHTË:

-leja e ndërtimit të kërkuar nga Z.y , Zj. x me numër xxxx refuzohet; kundra Z\_\_\_jepet paralajmërim disiplinor....; Z\_\_\_do të paguajë një sanksion administrativ prej 2000 euro....; i tërhiqet leja mjedisore nr...

-ky vendim hyn në fuqi me dita/muaji/viti;

-KENI TË DREJTË TË BËNI ANKIM TEK MINISTRI I .... Drejtoria ( adresa fizike, elektronike...) BRENDA 30 DITËVE NGA DITA QË PALA E INTERESUAR KA MARRË NJOFTIM PËR DHËNIEN E KËTIJ VENDIMI.

NË RAST SE DONI TË BËNI ANKIM KUNDRA KËTIJ VENDIMI, PËRMENDNI NUMRIN E VENDIMIT xxxxxx NË ANKIMIN QË DO T'I DËRGONI MINISTRIT. DUHET TË SHPJEGONI SHKAQET E KËTIJ ANKIMI.

NËNSHKRIMI I NËPUNËSIT PËRGJEGJËS, EMRI, MBIEMRI/ose EMRI, MBIEMRI I KRYETARIT TË ORGANIT KOLEGJIAL DHE SEKRETARIT TË KËTIJ ORGANI

ADRESA(T) E PALË(S)/VE (adresa fizike dhe elektronike, numr(i)/at e telefonit )

## Document 2: njoftimi mbi njohjen me dosjen dhe mbi të drejtën për t'u dëgjuar

Kodi i Procedurës Administrative –nenet 45, 87

EMRI I ORGANIT PUBLIK KOMPETENT, ADRESA FIZIKE DHE ELEKTRONIKE, NUMRI I TELEFONIT, ORARI I PUNËS

EMRI, MBIEMRI I NËPUNËSIT CIVIL KOMPETENT TË NGARKUAR ME ÇËSHTJEN (nëse shihet e përshtatshme, në varësi të politikës së organit publik për personalizimin e nëpunësve civilë pasi KPA nuk krijon detyrim për këtë)

NUMRI I HETIMIT ADMINISTRATIV kryesisht /ose I KËRKESËS numër xxxx  
DATA

ZOTI/ZONJA \_\_\_(emri/mbiemri i palës, individ ose përfaqësues i personit fizik), ORGANI ( emri i organit publik kompetent) PRITET TË MARRË VENDIM, [PËRPARA afatit (60 ditë pas datës së dorëzimit të kërkesës së plotësuar e cila është dorëzuar më dita/muaji/viti)/ në përgjithësi nuk ka afat të detyrueshëm në rast hetimi administrativ kryesisht], MBI NJË HETIM ADMINISTRATIV kryesisht numër xxxx /ose me KËRKESËN TUAJ numër xxxx NË MËNYRËN E MËPOSHTME ( rrëzim i pjesshëm ose i plotë i kërkesës, sanksion kryesisht, tërheqje e lejes ...) BAZUAR NË PROVAT E MËPOSHTME...MOTIVUAR NGA ..... NË PËRPUTHJE ME DISPOZITAT E LIGJIT numër, data e ligjit, nenet ...

SIPAS NENIT 87 TË KODIT TË PROCEDURËS ADMINISTRATIVE KENI TË DREJTËN TË NJIHENI ME DOSJET NË ZYRËN E (emri i organit publik kompetent, adresa fizike, adresa elektronike, numri i telefonit, orari i punës) PËRPARA afatit kohor (vendosni një afat kohor para 60 ditëshit të mësipërm; shih "afatet e arsyeshme" në nenin 53/pika 2) DHE KENI TË DREJTËN PËR T'U DËGJUAR TË CILËN MUND TA USHTRONI DUKE TELEFONUAR NË ZYRËN E emri i organit publik kompetent, adresa

fizike, adresa elektronike, orari i punës ... PËRPARA afatit kohor ( i njëjti afat kohor) . MUND TË PARAQITNI KOMENTET TUAJA ME SHKRIM BRENDA TË NJËJTIT AFAT KOHOR.

LUTEMI PËRMENDNI NUMRIN xxxxxx NË PËRGJIGJEN QË DO I DËRGONI ORGANIT PUBLIK KOMPETENT TË PËRMENDUR MË LART.

NËNSHKRIMI I NËPUNËSIT CIVIL KOMPETENT TË NGARKUAR ME ÇËSHTJEN

ADRESA(t) E PALËVE (adresa(t) fizike , adresa(t) elektronike, numri(at) e telefonit)

## Document 3: forma e njoftimit për dokumentet shitesë

Kodi i Procedurës Administrative –neni 78

EMRI I ORGANIT PUBLIK KOMPETENT  
EMRI, MBIEMRI I NËPUNËSIT CIVIL KOMPETENT TË NGARKUAR ME ÇËSHTJEN (nëse shihet e përshtatshme, në varësi të politikës së organit publik për personalizimin e nëpunësve civilë pasi KPA nuk krijon detyrim për këtë)  
ADRESA E ORGANIT PUBLIK (adresa fizike, adresa elektronike, numri i telefonit)  
NUMRI I KËRKESËS xxxx  
DATA E VËRTETIMIT TË PARAQITJES SË KËRKESËS

ZOTI/ZONJA (emri/mbiemri i kërkuarit, individ ose përfaqësues i personit fizik), NË MËNYRË QË TË KRYHET SHQYRTIMI ADMINISTRATIV I KËRKESËS SUAJ, \_\_\_ ( emri i organit publik kompetent) I NEVOJITEN ELEMENTET/DOKUMENTET E DOMOSDOSHME TË MËPOSHTME :

-  
-  
-

LUTEMI TË PARAQITNI KËTO ELEMENTE PËRPARA data e afatit ligjor DUKE PËRMENDUR NUMRIN E KËRKESËS JUAJ xxxx. KËRKESA JUAJ DO TË SHQYRTOHET BREnda 60 ( në rast se ligji i posaçëm nuk ka përcaktuar asnjë afat kohor) DITËVE NGA DATA E PLOTËSIMIT NË TËRËSI TË KËRKESËS SUAJ (neni 91).

NËNSHKRIMI I NËPUNËSIT CIVIL KOMPETENT TË NGARKUAR ME ÇËSHTJEN

ADRESA E KËRKUESIT (adresa fizike , adresa elektronike, numri i telefonit)



Tani që keni lexuar gjithë materialin, përshëndesni Laman Joe





# **TRAINING CATALOGUE ON THE CODE OF ADMINISTRATIVE PROCEDURES (CAP)**

ASPA TRAINING CATALOGUE

TIRANA, ALBANIA  
June 2017

"This publication has been produced with the assistance of the European Union. The contents of this publication are the sole responsibility of the implementing authorities and can in no way be taken to reflect the views of the European Union."



*The authors of this catalogue are civil servants from the French, Italian, Romanian, Polish and Bulgarian public administrations who participated as experts in the European twinning project Support to Albanian Civil Service Reform, implemented by the French National School of Public Administration (ENA), Italian National School of Public Administration (SNA) and the Albanian Department of Public Administration (DoPA):*

- **Mr Timothée PARIS, master of requests, Council of State, France**

*With the contribution of:*

- *Mr Yve Doutriaux, administrative judge, Council of State, France*
- *Mr Stephane Dewailly, administrative judge, Administrative Court of Paris, France*
- *Mr Dacian Dragos, Babes Bolyai University, Romania*
- *Mr Ugo de Luca, administrative lawyer, Italy*
- *Ms Urszulla Kulisiewicz, Ministry of Interior, Poland*
- *Mr Mladen Mladenov, administrative magistrate, Bulgaria*

*The production of this catalogue is financed by European Union through the twinning project "Support to Albanian Civil Service Reform".*

*For information about European Union, please visit: **<http://ec.europa.eu>**.*

## TABLE OF CONTENTS

<b>CAP Basic modules (B)</b> .....	<b>8</b>
<b>The most important things you should know on the Code of administrative procedures</b> .....	<b>8</b>
B1 Introduction to the code .....	10
B2 Introduction to the main novelties of the code .....	12
B3: Elaborating an administrative act .....	14
<b>CAP Advanced modules (A)</b> .....	<b>15</b>
<b>Strengthen your abilities on the Code of administrative procedures</b> .....	<b>15</b>
A1 Jurisdiction, competence and delegation .....	16
A2 The decision-making process .....	18
A3 Dealing with time .....	20
A4 Administrative contracts .....	21
<b>CAP Confirmed modules (C)</b> .....	<b>23</b>
<b>Master the Code of administrative procedures</b> .....	<b>23</b>
C1 Recent developments and case law on the CAP .....	24
C2 Ensuring impartiality of public administration .....	25
C3 Appeals .....	26
<b>Annex 1: Generalities on the Code of administrative procedures</b> .....	<b>28</b>
<i>Document 1: general presentation of the Code of Administrative Procedures, by Prof. Dr. Eralda (Methasani) Çani</i> .....	28
<i>(Basic level)</i> .....	28
.....	34
<i>Document 2: Definitions (Basic/Advanced), By Mr Yves DOUTRIAUX</i> .....	39
<i>Document 3: Administrative act (Basic) by Mr. Yves DOUTRIAUX</i> .....	43
<b>Annex 2: Specific topics</b> .....	<b>46</b>
Principles of administrative procedures .....	46
<i>Document 1: Principles of administrative procedures (Basic/Advanced), by Mr Mladen Mladenov</i> .....	46
Delegation of competencies/Responsible unit .....	51
<i>Document 1: guidelines to public bodies on delegation of competences – By Mr Timothee Paris, Pierre Calzat and Giancarlo DeFazio</i> .....	51
Annex 1: 3 examples of delegation of competencies .....	57

<i>N.B: examples inspired from the French and Italian administrations</i> .....	57
<i>Example 1: delegation of competencies at the ministerial level</i> .....	57
<i>Example 2: delegation of signature at the level of prefect</i> .....	58
<i>Example 3: delegation of power to another public organ</i> .....	59
<i>Document 2: Explanatory materials on art. 43 of the Code of Administrative Procedures, by Ms URSZULA KULISIEWICZ</i> .....	60
<b>Preparation of administrative acts</b> .....	<b>63</b>
<i>Document 1: rights of the citizens in administrative proceeding (Basic/Advanced) by Mr Mladen Mladenov</i> .....	63
<i>Document 2: participation of citizens in administrative procedures, by Mr Yves DOUTRIAUX</i> .....	65
<i>Document 3: Execution of administrative acts (Advanced), by Mr Mladen Mladenov</i> .....	68
<b>Time limits</b> .....	<b>76</b>
<i>Document 1: dealing with time (Basic/Advanced) by Mr Stephane Dewailly</i> .....	76
<i>Reopening of administrative procedures</i> .....	82
<i>Document 1: general presentation of administrative appeal and other forms of administrative dispute resolution (Advanced), by Mr Dacian Dragos</i> .....	89
<b>Annex 3: Materials to develop examples and case studies</b> .....	<b>99</b>
